

Prill 2020
Numri: 145
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

Sprova si Mëshirë




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Si i trajton Islami sprovat dhe fatkeqësitë që prekin njerëzimin në përgjithësi dhe muslimanët në veçanti?

A janë ato ndëshkim, apo mëshirë hyjnore?

Si duhet t'i kuptojmë ne besimtarët këto lloj fatkeqësish? A janë ato ndëshkime hyjnore, ashtu siç pretendohet? Apo mos vallë janë një lloj mëshire hyjnore, të cilën nuk e njohim? Çfarë thotë Libri i Allahut dhe çfarë na këshillon Profeti ynë (a.s.), për këtë çështje?

Po, sot, e gjithë bota, perëndimi dhe lindja, jugu dhe veriu, kanë hyrë përnjëherësh në një periudhë të re të historisë njerëzore. Mbase këtej e tutje, historia do të shënojë një pikë të re dhe do të ndahet në periudhën "para koronavirusit" dhe "pas koronavirusit".

Të gjithë e dimë pak a shumë historinë e fillimit dhe përhapjes së këtij virusi brenda një kohe të shkurtër. Të gjitha shtetet mbyllën kufijtë, udhëtimet u kufizuan në maksimum, tregtia u ngadalësua, edukimi dhe aktivitetet e përbashkëta fetare u ndërprehen. Madje, edhe vendet më të shenjta si Qabja dhe Xhamia Aksa u mbyllën përkohësisht. I gjithë njerëzimi u mbyll në shtëpi...

Padyshim se kjo nuk është hera e parë që njerëzimi përballet me situata të tilla. Historia njerëzore është e mbushur me këto lloj fatkeqësish, si kolera, murtaja, tifo, influenza, sida, sars dhe shumë sëmundje të tjera epidemike që kanë shkaktuar me miliona vdekje në një kohë të shkurtër. Madje, që në fillimet e historisë Islame, në kohën e Omerit (r.a.), murtaja mori jetën e 25 mijë njerëzve. Po ashtu, edhe në fillim të shekullit që lamë pas, gjatë Luftës së Parë Botërore, kontinenti i Evropës humbi rreth 1/3 e popullsisë si pasojë e këtyre lloj sëmundjeve.

Ku ndryshon e sotmja nga e djeshmja?

Ndryshimi është, se në asnjë periudhë të historisë njerëzore, sëmundje të tilla nuk e kanë marrë përmasa kaq globale sa sot. Të gjithë njerëzimin e ka kapluar frika, paniku dhe shqetësimi për të ardhmen. Aq më tepër që kjo po ndodh në një kohë kur njerëzimi ndihet më i fortë se kurrë. Në një kohë revolucioni teknologjik e shkencor, kur armët biologjike dhe nukleare mund ta shkatërrojnë botën sa hap e mbyll sytë. Në një kohë kur mjekësia dhe industria farmaceutike kanë arritur majat, kur njeriu po përpiqet të arrijë pavdekshmërinë dhe të gjejë jetë në planetë të tjerë. Dhe, ndërkohë që arroganca, lazdrimi dhe teprimi në çdo aspekt është bërë modë, një virus mikroskopik gjunjëzon gjithë njerëzimin...

Prill 2020

VITI: XIV

NUMRI: 145

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



8

Nëse kalbet zemra
Prof. dr. Sulejman Derin



Stolia e të gjitha veprave të mira
Xhafer Durmush

22




14



34

Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

- 5 Prova si mëshirë
Prof. dr. Mehmet Gërmez
- 10 Ngjitja në hënë
dhe ngjitja te fqinji më lart
Ali Riza Temel
- 13 Baza është humanizmi
Nuredin Jëlldëz
- 14 Mirësia është moral i lartë
Shemsedin Kërësh
- 21 Dora e mëshirës që i zgjatet njeriut
Ali Byjyqçapar
- 24 Të jetuarit si mysliman
në vende të ndryshme
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 27 Aty ku filloi gjithçka
Merva Capo
- 28 Edukata
Filiz Konxha



21

Një Ajet 30

Një Hadith 32

Koka e sinqeritetit është
nënshtrimi i plotë ndaj Allahut

Sadik Dana

Heshtja si virtyt 42

Ebu Hamid El-Gazali

Koha për t'u bërë Ensarë 46

M. Ali Eshmeli

Si duhet të reagojmë
ndaj provokimeve? 52

Naim Driçaj

Lakmia dhe Sakrifica 54

Ahmet Zijlan

46



Hipokrizia
Sëmundja e zemrës më e fshehtë
se zëri i hapave të milingonës
Prof. dr. Hasan Kamil Jellmaz

Qie
Edison Çeraj

45

Sprova si Mëshirë

— Prof. dr. Mehmet Gërmez —

VLERËSIMI I FATKEQËSIVE NË PËRPUTHJE ME MENDIMIN ISLAM

E nisim fjalën tonë duke uruar dhe duke i lutur Allahut për një shërim sa më të shpejtë nga kjo sëmundje e rëndë për popullin tonë dhe gjithë njerëzimin. I lutemi Allahut t'i mëshirojë të gjithë ata që kanë ndërruar jetë dhe të na trajtojë si gjithmonë, me cilësinë e Tij hyjnore Shafi/Shëruesi. Allahu i frymëzoftë zemrat e robërve të Tij të ditur në gjetjen e kurës së kësaj epidemie.

Vëllezërit e mi të shtrenjtë!

Duke u nisur nga koha në të cilën po jetojmë, dëshiroj të trajtoj shkurtimisht metodën e mendimit Islam në lidhje me vështirësitë dhe fatkeqësitë që po na godasin në këtë periudhë.

A JANË ATO NDËSHKIM, APO MËSHIRË HYJNORE?

Si duhet t'i kuptojmë ne besimtarët këto lloj fat-

keqësish? A janë ato ndëshkime hyjnore, ashtu siç pretendohet? Apo mos vallë janë një lloj mëshire hyjnore, të cilën nuk e njohim? Çfarë thotë Libri i Allahut dhe çfarë na këshillon Profeti ynë (a.s.), për këtë çështje?

Po, sot, e gjithë bota, perëndimi dhe lindja, jugu dhe veriu, kanë hyrë përnjëherësh në një periudhë të re të historisë njerëzore. Mbase këtej e tutje, historia do të shënojë një pikë të re dhe do të ndahet në periudhën “para koronavirusit” dhe “pas koronavirusit”.

Të gjithë e dimë pak a shumë historinë e fillimit dhe përhapjes së këtij virusi brenda një kohe të shkurtër. Të gjitha shtetet mbyllën kufijtë, udhëtimet u kufizuan në maksimum, tregtia u ngadalësua, edukimi dhe aktivitetet e përbashkëta fetare u ndërpre. Madje, edhe vendet më të shenjta si Qabja dhe Xhamia Aksa u mbyllën përkohësisht. I gjithë njerëzimi u mbyll në shtëpi...

Padyshim se kjo nuk është hera e parë që njerëzimi përballet me situata të tilla. Historia njerëzore është e mbushur me këto lloj fatkeqësish, si kolera, murtaja, tifo, influenza, sida, sars dhe shumë sëmundje të tjera epidemike që kanë shkaktuar me miliona vdekje në një kohë të shkurtër. Madje, që në fillimet e historisë Islame, në kohën e Omerit (r.a.), murtaja mori jetën e 25 mijë njerëzve. Po ashtu, edhe në fillim të shekullit që lamë pas, gjatë Luftës së Parë Botërore, kontinenti i Evropës humbi rreth 1/3 e popullsisë si pasojë e këtyre lloj sëmundjeve.

KU NDRYSHON E SOTMJA NGA E DJESHMJA?

Ndryshimi është, se në asnjë periudhë të historisë njerëzore, sëmundje të tilla nuk e kanë marrë përmasa kaq globale sa sot. Të gjithë njerëzimin e ka kapluar frika, paniku dhe shqetësimi për të ardhmen. Aq më tepër që kjo po ndodh në një kohë kur njerëzimi ndihet më i fortë se kurrë. Në një kohë revolucionari teknologjik e shkencor, kur armët biologjike dhe nukleare mund ta shkatërrojnë botën sa hap e mbyll sytë. Në një kohë kur mjekësia dhe industria farmaceutike kanë arritur majat, kur njeriu po përpiqet të arrijë pavdekshmërinë dhe të gjejë jetë në planetë të tjerë. Dhe, ndërkohë që arroganca, lazdrimi dhe teprimi në çdo aspekt është bërë modë, një virus mikroskopik gjunjëzon gjithë njerëzimin...

Në këtë periudhë, të gjithë shtetet po marrin masa dhe po punojnë me gjithë forcën e tyre duke vënë në dispozicion të gjithë arsenalin mjekësor, institucio-

nal dhe ekonomik. Tashmë, edhe rëndësia që i jepet pastërtisë ka arritur një dimension të paparë...

Por, pavarësisht të gjitha këtyre, një çështje shumë e rëndësishme është duke u neglizhuar së tepërmi... Dimensionin social i kësaj situatë, ende nuk ka filluar të trajtohet siç duhet. Ende nuk kanë filluar të shkruhen artikuj dhe libra mbi dimensionin shpirtëror dhe metafizik që do të nxjerrë në pah gjithë kjo situatë. E në fakt, tashmë, kjo nuk është një çështje që ka të bëjë vetëm me aspektin shëndetësor.

Prandaj, nëse këtë çështje e trajtojmë në tërësi, e jo vetëm nga një aspekt i caktuar, do të arrijmë në përfundime më të sakta. Sa i përket aspektit teknik, shkencën na i shpjegon më së miri detajet dhe shkaqet. Ndërsa filozofia i kalon nëpër filtrin e mendjes dhe na shtyn të mendojmë rreth çështjes. Kurse feja, i jep kuptim. Ajo na fton të mendojmë mbi kuptimin e dukshëm dhe të padukshëm. Por, kur bëhet fjalë për Islamin, kuptimi që jep feja, nuk e anashkalon shpjegimin e shkencës dhe mendimin e filozofisë.

Rrugën e drejtë, na e tregon shpallja hyjnore që mbledh në vete argumentet që shohim në gjithësi dhe argumentet nga shpallja hyjnore. Kjo është metoda më e mirë, që e ka shpëtuar njerëzimin nga besëtytnitë dhe e ka udhëzuar në rrugën e drejtë. Nëse e shqyrtojmë shpalljen hyjnore në tërësi, dhe po ashtu, nëse edhe njeriun e analizojmë nën dritën e argumenteve të shpalljes hyjnore dhe ato që gjejmë në gjithësi, para së gjithash, do të kuptojmë se këto lloj fatkeqësish, nuk janë **“rregull”** por **“ajet/shenjë”** hyjnore. E në fakt, ky është edhe koncepti kyç që na intereson në këtë temë.



Këto ndodhi, nuk janë ndëshkime hyjnore, ashtu siç pretendohet ndonjëherë me zemërim. Ja si urdhëron Zoti ynë në ajetin 45 të sures Fatir: **“Sikur Allahu t’i dënonte njerëzit sipas veprave (të këqija) të tyre, nuk do të linte mbi faqen e dheut asnjë gjallesë...”** Ndërsa në ajetin 46 të sures Fussilet, Ai shprehet qartë se: **“...Zoti yt nuk bën padrejtësi ndaj robërve!”**.

PRA, SI DUHET T’I VLERËSOJMË FATKEQËSITË NË DRITËN E SHPALLJES HYJNORE?

Siç e thamë edhe më sipër, sipas Kuranit Fisnik, kjo fatkeqësi është një shenjë/ajet. Dhe çdo besimtar duhet të nxjerrë një mësim ndryshe nga kjo shenjë. Për këtë na tërheq vëmendjen edhe Allahu i Madhëruar kur thotë: **“... A po merrni mësim o ju të zotët e mendjes!?”** Po ashtu, Kurani, edhe përmbytnjen e madhe në kohën e Nuhut (a.s.), nuk e quan “katastrofë”, por “ajet/she-një”.

Nëse bëjmë një vlerësim të kësaj tillë të këtyre ndodhive, atëherë dikush me të drejtë do t’i lidhë këto me keqpërdorimin e botës nga njeriu, e dikush tjetër do ta lidhë me tragjeditë njerëzore që po përjetohej anekënd globit si në Arakan, Siri, Jemen, etj... Po ashtu do të ketë edhe prej atyre që me të drejtë do ta lidhin me harrimin e Zotit, me neglizhencën ndaj fëmijëve, ndaj të drejtave njerëzore, ndaj fesë, e madje edhe ndaj popullit të vuajtur të Gazës...

LE TË MENDOJMË PAK MBI HARTËN E PASURISË SË KUPTIMEVE!..

Harta e pasurisë së kuptimeve do ta bëjë njeriun të mendojë përsëri rreth vetes dhe do ta shndërrojë në mëshirë gjithë këtë fatkeqësi që po përjetojmë. Nëse këto fatkeqësi i shohim si shenja, çdo njeri do të përballet me veten dhe do ta rivlerësojë marrëdhënien e tij me botën. Njeriu do të rregullojë marrëdhëniet e tij me familjen, miqtë dhe rrethin shoqëror. Por, nëse e anashkalojmë pasurinë e kuptimeve dhe këto fatkeqësi i lidhim vetëm me një person, ndodhi, fenomen dhe shoqëri të caktuar, duke i shpjeguar si ndëshkim hyjnor apo edhe si kiamet, do të thotë se ne nuk arrijmë t’i lexojmë dhe vlerësojmë këto shenja të pafundme hyjnore. Një vlerësim i tillë na shpëton na nxjerrja e mësimave

dhe na burgos në shprehje. Ajo nuk i zgjidh aspak problemet tona, por përkundrazi na e thëllon edhe më tepër krizën.

POR ÇFARË NA PENGON T’I KUPTOJMË SAKTË FATKEQËSITË?

Në fakt, pengesën më të madhe, sapo e kemi shpjeguar. Pra, mos vlerësimi i këtyre ndodhive si ajete/shenja, por si ndëshkim, duke u bërë shkas i shpëputjes nga nxjerrja e mësimave. Një tjetër pengesë, është edhe interpretimi i ngjarjeve në një mënyrë që i eliminon përgjegjësitë e njeriut. Mirëpo, Allahu i Madhëruar na bën të ditur se: **“Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që të tërhiqen (nga të këqijat).”** (Rum, 41.)


Një tjetër gabim i madh që bëhet, është se në emër të shkencës, gjatë interpretimit të këtyre ndodhive anashkalohej komplet Krijuesi i gjithësisë. Një gabim tjetër, është edhe ku njeriu e vë veten në rolin e Zotit dhe flet në emër të Tij. Si ndodh kjo? Pra, kur dikush thotë me bindje; “ky është një ndëshkim që Allahu ia ka dhënë këtij populli për shkak të kësaj ndodhie”, atëherë tregon se këtu, njeriu po i kalon së tepërmi kufijtë. Po ashtu, të shumëzosh me zero edhe shkaqet që ka krijuar Allahu, duke i lënë pas dore masat, është një gabim trashanik. Sidomos në situata të

sëmundjeve të tilla, masat e propozuara nga autoritetet shëndetësore, janë të njëjtat që propozohen edhe nga Islami, i cili mbrojtjen dhe sigurinë e jetës e ka në themel të parimeve të veta.

Këtë e tregojnë qartë edhe parimet e karantinës kundër sëmundjeve epidemike, që i Dërguari i Allahut (a.s.), ka përcaktuar para më shumë se 14 shekujsh duke thënë: **“Mos e fusni njeriun e shëndetshëm tek njeriu i sëmurë!”** dhe **“Nëse diku ka rënë ndonjë sëmundje ngjitëse, mos hyni. E nëse ndodheni aty, mos dilni!”**...

Le ta përfundojmë këtë shkrim me një lutje profetike të Ejubit (a.s.), i cili ka thënë:

“Zoti ynë! Neve na kanë goditur këto halle, por Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve!”



NËSE KALBET ZEMRA

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Njeriu është një qenie që përbëhet nga shpirti, trupi dhe nefsi. Trupi ynë është nga dheu, ndërsa shpirti ynë është nga bota hyjnore. Ndërsa qendra në të cilën gjendet shpirti në trup është zemra. Zemra është një organ i shtrenjtë i yni që nga njëra anë i shërben fizikut tonë, ndërsa nga ana tjetër i drejtohet botës hyjnore. Detyra jonë si robër është që ta ruajmë shëndetin fizik dhe atë shpirtëror dhe t'u japim atyre ushqimet për të cilat kanë nevojë. Në ditët e sotme shkenca e mjekësisë është zhvilluar jashtëzakonisht shumë në çështjen e mbrojtjes së shëndetit fizik. Sikundër kësaj, dija në lidhje me shpirtin dhe zemrën që përbëjnë aspektin tonë shpirtëror, është neglizhuar. Për sa i përket çështjes së mbrojtjes së shpirtit dhe zemrës është shfaqur një dembelizëm i madh.

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik për shpirtin: **“Do të të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni.”** (Isra, 85) Krahas kësaj, shumica e kësaj dijeje të pakët u është dhënë myslimanëve nëpërmjet shpalljes hyjnore. Ndërsa ndërmjet myslimanëve janë sufite ata të cilët janë thelluar në këtë çështje. Sufitë i kanë shtuar edhe më shumë me meditim dhe dhikër këto të dhëna në lidhje me shpirtin që i kanë marrë nga dija e shpalljes hyjnore dhe sunetit të pejgamberit (a.s.). Ata i kanë shndërruar këto të dhëna në një gjendje kënaqësie. Për këtë arsye, në këtë artikull do të përpiqemi të përkufizojmë me syrin e sufive shkaqet e kalbjes së zemrës së njeriut e cila largohet nga përshpirtshmëria. Pra, do të përpiqemi të shtjellojmë se cilat ndjenja e kalbin zemrën dhe e prishin njeriun. Gjithashtu do të përpiqemi të shtjellojmë edhe faktin se nga burojnë këto ndjenja.

Siç shprehet edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, se, nëse sëmuret zemra te njeriu, atëherë sëmuren edhe të gjitha organet e tjera, sepse nëse zemra, domethënë shpirti e humbet fuqinë e tij, trupin e njeriut e sundon nefsi. Imam Rabbani i

shpjegon me detaje cilësitë e nefsit në Mektubatit e tij. Nefsit që ia mbyll veshët thirrjes hyjnore, që e kalb veten duke e ushqyer atë shpirtërisht me ushqime të helmosura dhe që është i privuar nga udhërrëfimi i shpirtit, i thuhet Nefsu'l-Emmare. Nisur nga këto që thamë, sëmundjet që e lëshojnë nefsin në këtë gjendje janë këto:

“Nefsu'l-emma e njeriut ka një pasion të madh për pozitën dhe udhëheqjen. I gjithë qëllimi i saj është që të jetë më lart se moshatarët e vet. Ky nefsi dëshiron që të gjitha krijesat të kenë nevojë për të dhe t'i zbatojnë urdhrat e ndalesat e saj. Ndërsa vetë nuk dëshiron që të ketë nevojë për të tjerët dhe të gjendet nën urdhrat e tyre. Kjo është kauza e nefsit për t'u bërë zot dhe dëshira e tij për t'u bërë ortak me Allahun Teala i Cili nuk ka të ngjashëm. Madje ky nefsi nuk është i kënaqur edhe me të qenët ortak i Zotit. Ky nefsi dëshiron ta sundojë edhe Zotin. Ky nefsi dëshiron që çdo gjë të jetë nën urdhrin e tij. Në hadithin kudsij transmetohet: **“Ji armik i nefsit tënd, sepse ai është armik im.”** (Mektubat, vëll. I, Letra e 52-të.)

Për shkak se nefsi është mendjemadh, është kundër ekzistencës së Allahut, njësimi të Tij dhe fuqisë së Tij. Shkurtimeisht është kundër çdo urdhri hyjnor. Edhe pse nefsi nuk e mbron ekzistencën e Zotit (xh.xh.), nuk heziton aspak për t'i bërë shirk i cili është mëkati më i madh. Ata që nuk i pëlqejnë dispozitat e Kuranit dhe që i kundërshtojnë ato nga mëngjesi deri në mbrëmje veçanërisht në ditët e sotme, pa e kuptuar e vendosin veten në pozitën e Zotit. Të tillët pohojnë se natyrën e njeriut e njohin më mirë sesa vetë Zoti (xh.xh.), që i ka krijuar.

Sipas Imemit, nefsi që nuk heziton për t'i bërë shirk krijesit të vet, kauzën e epërsisë e shfaq me dëshirën për t'i sunduar ata që janë kundër llojit të tij. Dome thënë, nëse zemra është kalbur te një njeri, atëherë ky njeri do të përpiqet për t'i bërë robër të gjithë njerëzit e tjerë dhe për t'i kontrolluar ata me një sundim të plotë. Nisur nga këto që thamë, përgjatë gjithë historisë shu-

më tiranë dhe diktatorë që duan të bëhen si Faraoni, e kanë parë të përshtatshme pozitën e Zotit për veten e tyre. Nefsi që e sheh të përshtatshme për vete pozitën e Zotit, çuditërisht për të tjerët sheh të përshtatshme vetëm pozitën e skllavit. Për këtë arsye, njeriu duhet ta mbajë nën kontroll nefsin dhe nuk duhet t'ia japë asaj mundësitë e kësaj bote që e ndihmojnë dëshirën e saj për t'u bërë zot. Bazuar në këto që thamë, sufitë i kanë këshilluar veçanërisht njerëzit me karakter të dobët që të qëndrojnë larg pozitive në këtë botë. Siç i kalb bimbët uji kur u jepet tepër edhe pse ai është ushqimi më i dobishëm për to, edhe pasuria dhe pozita e kësaj bote i kalb me kalimin e kohës njerëzit që nuk kanë marrë edukim shpirtëror.

Krahas këtyre, sipas sufive pasuria e kësaj bote nuk i dëmton ata njerëz që e kanë pastruar zemrën e tyre. Siç shprehet edhe Imami, pasuria dhe pozita në dorën e atyre që kanë zemër të shëndosh është vetëm shërbim për besimtarët.

Po, sa e bukur është pasuria hallall në dorën e besimtarit të devotshëm, por pasuritë e kësaj bote për ata që nuk e arrijnë këtë gradë shpirtërore janë një provë e madhe. “Bota e poshtër nuk pëlqehet dhe mallkohet nga Allahu Teala për shkak se ndihmon në realizimin e dëshirave të nefsit. Atëherë, kushdo që e ndihmon armikun, e bën hak (e meriton) mallkimin absolut. Varfëria ka qenë arsye krenarie për Muhamedin, (a.s.), sepse në varfëri nuk realizohen dëshirat e nefsit dhe te ajo gjendet formimi i dobësisë.”

Imam Rabbani me këto fjalë nuk i konsideron të këqija në mënyrë absolute pasuritë e kësaj bote. Ai frikësohet vetëm nga uji i kësaj bote që mund ta kalbë pemën e zemrës. Siç është shprehur me këto fjalë të Eshrefogllu Rumi, pasuritë që përdoren siç duhet, nuk e kalbin zemrën. Përkundrazi, i japin asaj lumturinë e përhershme. “Pasuria e kësaj bote u ngjan shkallëve. Njeriu me të mund të zbrësë në pus, por mund të ngjitet edhe te shtëpitë madhështore. Të ndërtosh xhami, të ndërtosh ura dhe t'u paguash borxhet atyre që kanë borxhe, do të thotë të ngjitesh te shtëpitë madhështore të xhenetit në jetën e përtejme.” (fq. 84)

Edhe Imam Gazaliu i shtjellon në katër pika kryesore cilësitë vetjake që e kalbin zemrën e njeriut. Ato janë behimijeti, subuijete, shejtanijete dhe rububijete. Behimijeti do të thotë që nefsi e harxhon të gjithë jetën e saj si kafshët. Pra, u jep rëndësi kënaqësive të stomakut dhe atyre seksuale. Në këtë mënyrë, të gjithë jetën e harxhon duke rendur pas këtyre kënaqësive. Subuijete siç shprehet edhe Imam Rabbani është dëshira për t'i pasur nën kontroll të gjithë. Kur nuk arrihet diçka e tillë, atëherë ajo shndërrohet në ndjenjë armiqësisë dhe torturimit të njerëzve. Ndërsa shejtanijet do të thotë që nefsi guxon t'i mashtrojë të gjithë për interesat e tij. Në këtë mënyrë, ai e konsideron të lejuar gënjeshtrenë dhe mashtrimin. Emri i sëmundjes së katërt që e kalb zemrën është rububijete, domethënë që njeriu të dëshirojë të bëhet zot. Më sipër Imam Rabbani këtë cilësi të nefsit e ka shprehur si shirk ndaj Allahut (xh.xh.).

Si përfundim, të gjithë miqtë e Allahut na ka njof-

tuar se farërat helmuese që e kalbin zemrën e njeriut gjenden te nefsi. Ata na i kanë treguar edhe mënyrat e shërimit të këtyre sëmundjeve. Zgjidhja për behimijetin është ushqimi i pakët, të folurit e pakët dhe gjumi i pakët. Domethënë që nefsi duhet t'ia plotësojmë nevojat pa e tepruar. Zgjidhja për subuijetin është falja dhe modestia. Zgjidhja për shejtanijetin është sinqeriteti dhe ndershmëria. Ndërsa zgjidhja për rububijetin është të kujtuarit e shpeshtë se jemi robër duke rënë në sexhde në audiençën e Zotit (xh. xh.). Imam Rabbani na këshillon që farzet e Islamit t'i kryejmë me kënaqësi dhe të largohemi nga haramet, në mënyrë që të shpëtojmë nga sëmundjet shpirtërore. Çështja tjetër më e rëndësishme më të cilën duhet të merremi pas këtyre është preokupimi me dhikrin e Allahut dhe pastrimi i ndryshkut të zemrës. Imami thotë si më poshtë:

“Shkurtimisht, përderisa nefsi të mos pastrohet nga të këqijat dhe të mos dëliret nga dashuria për madhështi, është e pamundur që ta arrijë shpëtimin. Andaj këto sëmundje detyrimisht duhet të shërohen, në mënyrë që të mos i hapin rrugë vdekjes së përhershme. Kelimetu't-tevhid domethënë fjala “La ilahe il-lall-llah” e cila na është dhënë për t'i shkatërruar zotat e rremë që i kemi brenda dhe jashtë vetes sonë, është gjëja më e dobishme dhe e përshtatshme në lidhje me çështjen e pastrimit dhe dëlirjes së nefsit. Të mëdhenjtë e tarikatit kanë preferuar këtë fjalë për dëlirjen e nefsit.”

Siç është shprehur edhe Erogllu Nuriu, nëse dhikri hyn në një zemër, aty e djeg çdo gjë që gjendet në të përveç dashurisë ndaj Allahut Teala dhe e pastron atë. Në këtë mënyrë, nefsi shpëton nga të qenët emmare dhe arrin gradën mutmainne. Është interesante sepse çdo gjë që e dëmton nefsin emmare pas kësaj faze është e dobishme për sufiun, sepse ai do t'i përdorë lehtësisht të gjitha mundësitë, ushqimet dhe pozitat për të arritur te ajo (nefsi mutmainne). Imami e shpjegon me këto fjalë këtë gjendje:

“Kundërshtimi i nefsit në gjendjen emmare në të vërtetë është i pranueshëm. Ndërsa për nefsin që ka arritur gjendjen mutmainne nuk ka kundërshtim, sepse nefsi në këtë pozitë është e kënaqur nga Zoti i Madhëruar dhe Zoti (xh.xh.), është i kënaqur prej tij.” (Mektubat, vëll. 1, 101.)

Këto fjalë të Imamit janë komentim i ajetit: “**..Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!**” (Rad, 28) Kur zemra e arrin prehjen shpirtërore mbrohet nga çdo lloj rreziku me mburojën e dhikrit. Tashmë një nefsi i tillë u bindet urdhrave të Zotit dhe e frymëzon vetëm për mirësi poseduesin e tij.

Të mos harrojmë se, nëse njeriu i jep rëndësi zemrës dhe e mbron atë nga sëmundjet, bëhet një qenie më e lartë edhe se engjëjt. Sikundër kësaj, nëse nuk e pastron nefsin nga dëshirat vetjake, mund të bjerë në një shkallë edhe më të ulët se kafshët. E lusim Zotin (xh.xh.), që të na e mundësojë të shpëtojmë nga çdo lloj sëmundjeje shpirtërore!

Ngjitja në hënë dhe ngjitja te fqinji më lart

— Ali Riza Temel —

Njëri prej problemeve më të mëdha të shekullit modern është shekullarizimi sa më i madh, zvarritja pa vullnet drejt pasioneve e shpejtësisë dhe rendja me nxitim si kalë gare frymë më frymë për t'i shfrytëzuar shanset (e pa lejuara) që na dalin përpara çdo ditë. Në këtë mënyrë nuk mbarojnë as shanset, as garat. Gjendja është pikërisht siç shprehet në ajetin fisnik: **“Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar (pasurinë, pushtetin) derisa të shkoni në varr.”** (Tekathur, 1-2) Çdo garë bëhet për të fituar diçka. Fundi i një gare që nuk bëhet për të fituar lumturinë e përhershme është humbje e përhershme. Të gjitha fitimet që arrihen në këtë botë marrin fund në varr nëse nuk bëhen për botën e përtejme. Njeriu i mençur nuk e harxhon jetën duke rendur pas gjërave provizore. Përkundrazi, ai garon në mirësi, domethënë, në rrugën për ta kthyer të përkohshmen në të përhershme.

Aktivitetet dhe punët që bëhen vetëm për këtë dynja në botën e ditëve të sotme në të cilën është vendosur një perde hekuri ndërmjet kësaj të fundit dhe botës së përtejme, nuk e sigurojnë dot lumturinë e kësaj bote siç edhe bëhen shkak për humbjen e botës tjetër. Njerëzve vazhdimisht po u shtohen etja, nxehtësia dhe pasionet si njeriut që pi ujë të kripur. Pra, po përjetohet një gjendje e mjeruar si t'i afroresh benzinës me zjarr apo t'i hedhësh

**TË GJITHË PO JETOJNË
SI TË DËNUAR NË BURGUN E
EGOIZMIT. “VETMIA MODERNE”
ËSHTË REALITETI MË I FRIKSHËM
I DITËVE TË SOTME. TË GJITHË PO
JETOJNË TË VETMUAR PARA SYVE TË
TË TJERËVE. NGJITJA NË HËNË NUK ËSHTË
NDONJË MARIFET I MADH, POR NGJITJA TE
FQINJI MË LART DHE NDARJA ME TË E GËZIMEVE
DHE HIDHËRIMEVE ËSHTË MARIFET I VËRTETË.**

zjarrit dru. Pasionet që i nxit dhe i ushqen kapitalizmi i egër po shtohen çdo ditë që kalon. Mundësitë e kufizuara nuk po i plotësojnë dot dëshirat dhe pasionet e pakufizuara.

Këto ambicie të flakta po i japin zjarrin të gjithë vendit. Një jetë që nuk ka falënderim ndaj Zotit dhe mjaftim me atë që ka dhënë Ai, shndërrohet në tragjedi. Në një garë që zhvillohet vetëm për të kënaqur dëshirat fizike, shkelen vlerat humane e etike, egoizmi del në plan të parë dhe kjo garë çnjerëzore lind botëkuptimin se njeriu është ujë për njeriun. Një garë dhe botëkuptimi i tillë po e kthejnë botën në një xhehenem të vërtetë. Të gjithë po jetojnë si të dënuar në burgun e egoizmit. “Vetmia Moderne” është realiteti më i frikshëm i ditëve të sotme. Të gjithë po jetojnë të vetmuar para syve të të tjerëve. Ngjitja në hënë nuk është ndonjë marifet i madh, por ngjitja te fqinji më lart dhe ndarja me të e gëzimeve dhe hidhërimeve është marifet i vërtetë.

Lumturia nuk mund të jetë individuale. Një njeri që ka ndërgjegje dhe arsyeton, nuk mund të jetë i lumtur kundrejt mjerimit, skamjes dhe varfërisë së njerëzve të tjerë. Nëse ndjehet i lumtur, atëherë ai nuk është njeri. Ata që i braktisin kënaqësitë e kësaj jete dhe ia kushtojnë zemrën dashurisë për t’i ndihmuar të tjerët janë njerëz të vërtetë. Për njerëzit e tillë dhënia është më e vlefshme se marrja dhe preokupimi me hallet e të tjerëve është më i vlefshëm se preokupimi vetëm me hallet e veta. Njerëzit e tillë fitim të vërtetë konsiderojnë fitimin e zemrave të të tjerëve dhe marrjen e lutjeve prej tyre. Ata që fitojnë dashurinë e pëlqimin e njerëzve dhe si rrjedhojë edhe atë të Allahut (xh.xh.), janë njerëzit që fitojnë në të vërtetë. Të mos duhesh nga të tjerët është ndëshkimi më i rëndë. Njeriu egoist dhe koprrac nuk duhet nga të tjerët. Shpërblimi i njerëzve bujarë është dashuria. Në fakt, nuk ka shpërblim më të madh se dashuria.

Pasuritë e kësaj bote që fitohen nuk i njohin as poseduesit e tyre. Kur të ndërrojnë jetë ata që kanë rendur si të çmendur për të fituar pasuri, gjërat për të cilat kanë konsumuar jetën nuk do të derdhin qoftë edhe një pikë lot për ta. As vila dhe as makina luksoze nuk ia kanë haberin për vdekjen e pronarit të tyre. Ndërkohë ai pati dhënë përpjekje të mëdha për t’i fituar ato.

Jeta në këtë botë sigurisht që nuk mund të bëhet pa fituar, por kur të fitojmë nuk duhet ta konsiderojmë këtë botë sikur të ishte ajo i vetmi qëllim. Një fitim që nuk bëhet për të arritur kënaqësinë e Allahut dhe dashurinë e lutjen e njerëzve, nuk

është fitim i vërtetë, sepse më në fund ose ai do të na braktisë ne, ose ne do ta braktisim atë. Guri i përherëshëm është më i vlefshëm se floriri i përherëshëm. **“Pasuria dhe djemtë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpresës (për shpëtim).”** (Kehf, 46)

Kur Omer ibn Abdulazizi dëgjoi se biri i tij kishte blerë një unazë me një mijë dërhëmë, i shkroi një letër në të cilën e urdhëronte që ta shiste menjëherë unazën, të ushqente një mijë të varfër me paratë e saj, për vete të blinte një unazë hekuri me dy dërhëmë dhe të shkruante mbi të: “Allahu e mëshiroftë atë që nuk e tepron.” Ushqyerja e një mijë vetave,

PASURITË E KËSAJ BOTE QË FITOHEN NUK I NJOHIN AS POSEDUESIT E TYRE. KUR TË NDËRROJNË JETË ATA QË KANË RENDUR SI TË ÇMENDUR PËR TË FITUAR PASURI, GJËRAT PËR TË CILAT KANË KONSUMUAR JETËN NUK DO TË DERDHIEN QOFTË EDHE NJË PIKË LOT PËR TA. AS VILA DHE AS MAKINA LUKSOZE NUK IA KANË HABERIN PËR VDEKJEN E PRONARIT TË TYRE. NDËRKOHË AI PATI DHËNË PËRPPJEKJE TË MËDHA PËR T’I FITUAR ATO.

fitimi i dashurisë së tyre dhe marrja e lutjeve nga ata janë më të vlefshme se zbulimi me mijëra diamante. E gjithë çështja është që ta dimë se cila gjë është më e vlefshme.

Harxhimet që bëhen për shtirje në përgjithësi nuk vlerësohen, por bëhen shkak për xhelozë dhe armiqësi. Mënyra për t’i bërë të tjerët të na pëlqejnë nuk është veshja e rrobave të shtrenjta, organizimi i dasmave madhështore, organizimi i ceremonive të ekzagjeruara, plasja e fishekzjarrëve apo organizimi i evenimenteve të degraduara, por është afrimi te njerëzit me modesti dhe ndarja me ta e gëzimeve e hidhërimeve. I Dërguari i Allahut (a.s.), të gjithë pejgamberët dhe sahabët e nderuar janë njerëz për t’u marrë shembull në lidhje me këtë çështje.



Tani le të japim një shembull interesant i cili të jetë edhe si një qortim për mbrëmjet e ditëlindjeve në ditët e sotme: Abbas Halim Pasha ishte nipi i Mehmet Ali Pashës (1886-1934) nga Kavalla. Ai ishte një njeri fisnik dhe shembullor. Edhe pse kishte një pasuri të madhe materiale, prapë se prapë dinte të jetonte gjithmonë në formë modeste. Ai ka thënë: “Pasuria i ngjan kalit kokëfortë. Kurdo që e ndjen qoftë edhe shkujdesjen më të vogël të të zotit, menjëherë e rrëzon përtokë.” Princesha zonja Hatixhe, e cila ishte një zonjë fisnike si ai vetë, i organizoi një ceremoni të paharrueshme pashait me rastin e gjashtëdhjetë e tre vjetorit të lindjes së tij. Bashkëshorti i tha asaj: “Asnjëherë në jetën time nuk kam parë gjë më të këndshme se kjo.” Princesha zonja Hatixhe, pa e njoftuar Abbas Halim Pashën, kishte mbledhur gjashtëdhjetë e tre fëmijë nga fshati, i kishte veshur me kostum, i kishte radhitur në bahçe dhe në këtë mënyrë i bëri surprizë pashait. Pashai nuk i mbajti dot lotët kundrejt kësaj panorame. Shembulli i një zonje fisnike dhe i një zotërie fisnik që festuan gjashtëdhjetë e tre vjetorin duke veshur gjashtëdhjetë e tre të varfër... Kjo u dedikohet atyre që pandehin se kanë ardhur pa ndonjë qëllim në këtë botë dhe që jetojnë në mënyrë të çmendur e larg kuptimit të vërtetë të jetës e të vdekjes.

Abbas Halim Pasha u tha atyre që i propozuan për të blerë një jaht luksoz për vete: “Kjo që po më thoni është krejt e lehtë, por nëse një njeri bën çfarëdo që mund të bëjë, atëherë kjo është çmenduri.” Ai në vend të blerjes së jahtit preferoi të bënte operacion një fëmijë shtatëmbëdhjetë vjeçar i cili arriti shëndetin nëpërmjet këtij operacioni. Përgjatë periudhës së luftës së parë botërore ai nuk vendoste gjë tjetër në tryezën e ngrënies përveç bukës së misrit dhe bullgurit, në mënyrë që të mos jetonte ndryshe nga të tjerët. I ndjeri Mehmet Akifi i cili u internua për të jetuar në skamje në Egjipt, falë këtij pashai arriti shumë mirësi dhe rehati. Mirësitë që ka bërë ai nuk mund të numërohen. Fshatrat pa ujë, të varfrit e pastrehë, nevojtarët që mbesnin pa qymyr përgjatë dimrit, vajzat që nuk mund ta blinin dot pajën, peshkatarët që u fundosej varka... Nxënësit ekselentë që shkonin për t’u arsimuar në Evropë dhe Japoni arritën t’ia dilyn mbanë falë atij. Ai i kryente edhe punët që nuk i kryente dot bashkia. Varreza shekullore në ishullin Hejbeli është vepër e atij.

Ne e përmendëm Abbas Halim Pashën, në mënyrë që të jetë shembull për njerëzit e papërgjegjshëm dhe të pasjellshëm të cilët kanë pasuri, por

e harxhojnë atë vetëm për shtirje dhe për gjëra të panevojshme duke mos siguruar asnjë dobi. Në lidhje me këtë çështje ka shumë njerëz që mund të jepen si shembull. Ndërkohë që njerëzit e tillë përkujtohen me mirësi dhe lutje, ata që kanë fituar pasuri të jashtëzakonshme duke shfrytëzuar mundin e të tjerëve dhe djersën e ballit të këtyre të fundit, nuk kujtohen me mëshirë, por me mallkim. Ndëshkimi i atyre nuk është vetëm përkujtimi me mallkim. Ndëshkimi që ata do të marrin në botën e përtejme do të jetë aq i ashpër sa që do t’i kthejë në pishmanllëk dhe pendim të gjitha dëfrimet që i kanë përjetuar në këtë botë. Ata nuk do të shpëtojnë nga ky ndëshkim edhe nëse japin florinj sa e gjithë kjo botë. Andaj njeri i mençur është ai që mendon për vendin e përhershëm dhe që përgatitet për atje.

Jeta është përgjegjësi nga fillimi e deri në fund. Njeriu do të merret në llogari për të gjitha gjërat të cilat i janë dhënë si amanet. **“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për mirësitë** (e kësaj bote!)” (Tekathur, 8) **“Asnjë rob nuk do të lëvizë dot nga vendi ku do të gjendet në ditën e gjykimit pa u pyetur se ku e ka harxhuar jetën, se çfarë veprash ka bërë me dijen, se ku e ka fituar dhe harxhuar pasurinë dhe se ku e ka lodhur trupin.”** (Tirmidhi, Kijamet, 1.) Siç është e rëndësishme se ku dhe si është fituar pasuria, është e rëndësishme edhe se ku dhe si është harxhuar. Edhe fitimi, edhe shpenzimi i pasurinë absolutisht duhet të bëhet në përputhje me rregullat e hallallit.

Israf (shpenzim i tepërt) në një kontekst do të thotë kalim i caktuar. Çdo shpenzim i panevojshëm dhe i padobishëm quhet israf. Israfi është një veprim që lind varfëri dhe që i bën të varfrit edhe më të varfër në shoqëri. Veprimet e tilla janë të ndaluara në fenë tonë. Allahu nuk i do ata që bëjnë israf. **“Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepëruar. Dorëshpuarit me të vërtetë, janë vëllezërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.”** (Isra, 26-27)

Çmenduria e konsumit po nxitet pa reshtur nëpërmjet reklamave të ndryshme, në mënyrë që të mos ndalen, madje të punojnë sa më shumë çarqet e kapitalizmit të egër. Njerëzit me vullnet të dobët po merren nga kjo furtunë artificiale dhe jeta po shndërrohet në një garë fitim-shpenzim të pakuptimtë. Të harxhosh do të thotë të konsumosh. Ndërsa shpenzimi për të mos konsumuar është fitimi i vërtetë. Allahu na bëftë prej atyre që harxhojnë për të fituar jetën e përhershme! Amin!

Baza është HUMANIZMI

Nuredin Jëlldëz

Falënderimi i përket Allahut që jemi myslimanë. Besimin e konsiderojmë si mirësinë më të madhe që na e ka dhuruar Zoti (xh.xh.). Çfarëdo që të jetë e nevojshme për ta bërë, në mënyrë që të jetojmë si myslimanë, atë përpiqemi ta bëjmë.

Këtu duhet të shtjellojmë një pikë e cila nuk duhet të na ikë nga vëmendja. Ajo pikë është: Ne jemi myslimanë për shkak se jemi njerëz. Po të mos ishim njerëz, nuk do të kërkohej prej nesh që të ishim myslimanë. Për shembull, edhe pse engjëjt janë krijesa madhështore dhe kanë vlerë të madhe te Allahu, fjala “mysliman” nuk përdoret për ata. Një emërtim i tillë nuk bëhet për engjëjt. Gjithashtu për ata nuk ka ndonjë emërtim që bie ndesh me të qenët mysliman. Njerëzit dhe xhindët kanë përgjegjësinë për besimin ndaj Allahut (xh.sh.). Për engjëjt dhe krijesat e tjera nuk ka një klasifikim të tillë. Njeriu është ose mysliman, ose jomysliman.

Të gjitha urdhrat që feja jonë na kërkon t'i kalojmë në praktikë, janë plotësisht të mundshme për t'u kryer nga njerëzit. Pra, këtu bëhet fjalë për urdhra/ndalesa të kufizuara me kapacitetin dhe fuqinë e njeriut. Njeriu ia dorëzon veten Krijuesit me strukturën fizike dhe peshën shpirtërore që posedon. Nëse marrim për shembull namazin, i cili është ndër ibadetet më të njohura, do të shohim se ai nuk është urdhëruar të falet sipas engjëjve, por sipas njerëzve që janë të krijuar me mish dhe kocka. Edhe engjëjt bëjnë sexhde e ruku, por rukuja jonë është sipas strukturës sonë. Edhe pse ekzistojnë engjëjt që bëjnë sexhde dhe ruku vazhdimisht që kur janë krijuar, ndoshta që prej miliona vitesh, prej nesh kërkohet që të bëjmë ruku dhe sexhde për aq kohë sa të bëjmë trespah tri-pesë herë. Ne jemi njerëz, për këtë arsye edhe ajo që na urdhërohet duhet të ketë lidhje me të qenët njeri.

Çdo i rritur që e pranon fenë islame dhe që e ka emrin mysliman, para së gjithash e ka kusht që të bëhet njeri. Pa hezituar aspak mund të themi: Ne jemi myslimanë ngaqë jemi njerëz. Elhamdulillah! Sa më shumë që të na bie niveli i të qenët njeri, aq më shumë na bie edhe fetaria jonë pavarësisht nëse e ndjejmë apo jo këtë. Të qenët njeri qëndron pothuajse si një bazë. Kur të rrëshqasë ajo bazë, edhe jeta fetare që gjendet mbi të rrëshqet apo mbetet në zbrazëti për shkak se e ka humbur bazën. Për ta shpjeguar në mënyrë të qartë këtë të vërtetë të madhe mund të shtjellojmë parimin e të drejtës së njeriut që e ka vendosur feja jonë. Ne si myslimanë e dimë se cili do të jetë përfundimi kur të gjitha veprat e mira që i kemi bërë me qëllimin për të

mbledhur sevape si namazet që i kemi falur, agjërimin që e kemi mbajtur dhe Kuranin që e kemi lexuar, të përballen me larjen e hesapeve të të drejtës së dikujt. Pra, veprat që i kemi bërë për ibadete (sevape) do t'i japim, në mënyrë që të pastrohemi nga e drejta e dikujt që mund t'ia kemi dhunuar. Të drejtat njerëzore janë rezultat i marrëdhënieve humane. Problemi që del në pah kur një njeri atakohet me një njeri tjetër quhet dhunim i të drejtës së tjetrit. Nëse mund ta shprehim ndryshe, ky është një problem i njeriut që e dëmton një njeri tjetër. Ndërsa ibadet quhet çdo vepër që njeriu besimtar e bën për hir të Allahut (xh.sh.). Një vepër që bëhet për hir të Allahut sakrifikohet ose jepet si kompensim për të drejtën e dhunuar që qëndron para nesh si një problem. Sevapet e mbledhura që mund të jenë sa malet mund të flijohen për një të drejtë të dikujt e cila mund të jetë një fjali apo disa qindarka për të cilën njerëzit pandehin se është diçka e pakonsiderueshme.

Ne mund të jemi kureshtarë se si mund të krahasohet namazi me dy-tri qindarka të një njeriu. Rregulli i botës së përtejme kështu do të funksionojë. Atë ditë gabimet që janë bërë kundrejt njerëzve do të kompensohen me ibadetet (sevapet). Sigurisht se një namaz i falur për hir të Allahut Teala apo çdo lloj ibadeti tjetër i bërë për hir të Zotit nuk mund të ketë ndonjë vlerë me të cilën të krahasohet, por sidoqoftë edhe gabimet/problemet që ndodhin ndërmjet njerëzve nuk lihen pa u marrë në llogari. Kështu është struktura e fetarisë që na e mëson feja jonë. Ne jemi njerëz. Për këtë arsye jemi kandidatë për t'u bërë myslimanë.

Nëse të qenët njeri përbëhet nga vlerat si mëshira, durimi, mirësjellja, butësia, respekti, trimëria, respektimi i të drejtës, besnikëri ndaj detyrës, etj., të kundërtat e këtyre na bëjnë të kuptojmë se absolutisht do të japim llogari për to në ahiret. Mungesa e vlerave të lartpërmendura përbën humbje për botën e përtejme.

Ne si myslimanë duhet të përjetojmë një fetari duke e pasur parasysh të qenët njeri në shtëpi, punë dhe mjedise sociale. Ndoshta neve na ngushëllon një fetari e formuar mbi të qenët human, edhe pse këtë të fundit e kemi dëmtuar, por me këtë nuk mund të arrihet ajo që kërkohet prej nesh. Ne jemi myslimanë ngaqë jemi njerëz. Kjo nuk ka ndonjë anë e cila mund të jetë elastike.



Mirësia është moral i lartë

— Shemsedin Kërësh —

Kuptimi leksikor i fjalës “birr” është “besnikëri” dhe “bindje”.¹ Besnikëria dhe bindja janë shenja të adhurimit dhe fetarisë. Fetaria e vërtetë nuk realizohet/arrihet duke zbatuar çështjet formale si të drejtuarit e fytyrës në drejtim të lindjes apo perëndimit.² Ndershmëria të shpie në mirësi, ndërsa mirësia të shpie në xhenet.³ Fetaria e vërtetë është të mbrojturit e ndershmërisë dhe sinqeritetit përgjatë të gjitha vështirësive. Fjala el-birr do të thotë fetari e dëlirë dhe e sinqertë. Njeriu nuk duhet ta sforcojë veten me përpjekjen për të arritur një fetari të mirëfilltë, sepse kjo nuk është konsideruar e përshtatshme. Kështu, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Mbajtja e agjërimit përgjatë udhëtimit nuk është el-birr (mirësi).”⁴ Mirësia ka lidhje edhe me moralin dhe sjelljen tonë kundrejt njerëzve, sepse Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Mirësia është moral i lartë.”⁵ Parimi i mirësisë është që të mos nënvlerësohet asnjë sjellje e bukur dhe e drejtë. Resulullahu, (a.s.), e ka konsideruar mirësi edhe vlerësimin e mirësisë. Andaj nuk duhet ta nënçojmë atë që na e jep fqinji edhe nëse është një këmbë deleje.⁶ Edhe buzëqeshjen nuk duhet ta nënçojmë.⁷ Format e fetarisë së dëlirë dhe të sinqertë gjenden në pjesët

“kitabu’l-birr” të literaturës së hadithit.

Pjesët “kitabu’l-birr” në literaturën e hadithit kanë nxjerrë në pah mirësinë, ihsanin dhe ikramin bashkë me aspektet e tyre teorike dhe praktike. Mirësia (el-birr) nuk është gjë tjetër përveçse një manifestim i fetarisë që mbështetet te sinqeriteti. Format që klasifikuesit i kanë emërtuar këto pjesë, e reflektojnë edhe përmbajtjen e tyre. Për shembull, në Sahihu’l-Muslim është emërtuar “kitabu’l-birri ve’s-sileti ve’l-adab”. Mesazhi që jepet me këtë titull është ky: Mbajtja e marrëdhënieve me shoqërinë brenda të cilës gjenden edhe të afërmit tanë dhe zbatimi i rregullave të edukatës në marrëdhëniet me shoqërinë janë manifestim i fetarisë. Në këtë pjesë gjenden 166 hadithe. Imam Tirmidhiu (v. 279/892) në Sunenin e tij ka zgjedhur titullin “kitabu’l-birr ve’s-sile”. Në këtë pjesë të Sunenit të Tirmidhiut gjenden 138 hadithe. Ndërsa Ibn Hibbani ka zgjedhur titullin “kitabu’l-birri ve’l-ihsan”. Në këtë pjesë gjenden 336 hadithe. Sipas zgjedhjes së këtij emërtimi të Ibn Hibbanit (v. 354/465), krahas shtimit të sevapit duke e ngritur cilësinë e ibadetit në marrëdhëniet me Allahun (xh.xh.), edhe veprat e mira që bëhen në shoqëri duhet t’i konsiderojmë

si një pjesë të fetarisë. Ibn Hibbani i cili ka dhënë shumë hadithe në lidhje me faljen, sjelljen e butë, mbajtjen e sekretit, fqinjësinë dhe rregullat e ligjëratës fetare, e ka ndriçuar këtë çështje nga një aspekt i ndryshëm. Veprën më të lartë pas xihadit në rrugë të Allahut ai ka konsideruar largimin nga njerëzit sa të jetë i mundur duke mos i bërë dëm askujt dhe duke ua dhënë hakun e tyre Allahut dhe robërve të Tij.⁸ Për shkak se karakteret dhe botët e brendshme të njerëzve janë të ndryshme nga njëra-tjetra, edhe mënyrat e përparimit në fetari janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Një person që ka natyrë sociale, domethënë, një njeri që ka peshë në shoqëri mund të përparojë në fetari me aktivitetet sociale. Ndërsa dikush që është i mbyllur në vetvete mund të përparojë duke zgjedhur largimin nga njerëzit. E rëndësishme është marrja e rrugës së përparimit në fetari (besim).

Tani le të flasim për disa forma të fetarisë që gjenden në pjesët e “kitabul-birr-it”.

40 MIRËSI

Mirësia në Islam nuk bëhet vetëm për të arritur ndonjë shpërblim. Projektet për mirësi na e rregullojnë edhe vetë jetën tonë. Si rrjedhojë, mënyrat e sjelljes sonë formojnë një kornizë e cila i jep kuptim jetës. Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, është pyetur për mirësinë, ka thënë: “*Mirësia është moral i lartë. Ndërsa e keqja është ajo gjë që ta bren zemrën dhe që nuk dëshiron ta dëgjojë njerëzit.*”⁹ Atëherë mirësi do të thotë që të jetojmë në harmoni me Krijuesin, krijesat, njerëzit, kafshët, bimët dhe çdo gjë tjetër. Pra, mirësi do të thotë të mos shkëputemi nga natyra jonë e pastër.

Në një hadith është folur për dyzet mirësi. T’i falësh një dhi një familjeje në nevojë është konsideruar prej veprave të larta që e shpien njeriun në xhenet.¹⁰ Hasan ibn Atije (v. 130), i cili është njëri prej këtyre transmetuesve, ka thënë: “I numëruam veprat e mira si kthimi i selamit, lutja për atë që teshtin dhe largimi i pengesës nga rruga, por nuk arritëm dot as deri te pesëmbëdhjeta.” Prej shpjeguesve të hadithit ka pasur nga ata që janë përpjekur të numërojnë deri në dyzet mirësi. Kjo radhitje mund të jepet si shembull për këtë:

Ushqyerja e të tjerëve, dhënia e ujit, dhënia e selamit, mësimi i një profesioni, dhënia e lidhëses së këpucës atyre që nuk kanë, buzëqeshja ndaj të tjerëve, ndihma ndaj atij që sapo ka ardhur në qytet, ndarja e fatkeqësisë dhe ndihma në vështirësi ndaj një vëllai në fe, ndihma ndaj të varfërve, mbulimi i gabimeve të myslimanëve, dhënia vend atyre që

vijnë në mexhllis, të gëzuarit e myslimanëve, ndihma ndaj të dhunuarit, ndalimi i zullumqarit nga zullumi, të treguarit e rrugës (metodës) për një punë të mirë, pajtimi i të zemëruarve, pritja me fjalë të ëmbla e lypësit kur nuk ke mundësi për t’i dhënë diçka, të mbrojturit e personit që përgojohet në prezencën tënde, mbjellja e pemëve, ndërmjetësimi për vepra të mira, dhënia e dorës ndërmjet burrave më njëritjetrin dhe grave me njëra-tjetrën, dashuria ndaj vëllait mysliman për hir të Allahut, vizitat e ndërsjella për hir të Allahut, urrejtja për hir të Allahut, harxhimi për hir të Allahut, formimi i mexhllisit dhe qëndrimi në të për hir të Allahut, të qenët i sinqertë, të mëshiruarit e të tjerëve, urdhërimi për mirësi dhe ndalimi nga e keqja, ndihma për të bërë pazarllëk ndaj dikujt që nuk kupton nga tregtia, të folurit me fjalë të mira, etj.¹¹ Ka prej atyre që kanë thënë se Pejgamberi (a.s.), nuk i ka përmendur 40 mirësitë edhe pse i dinte dhe se ka marrë masa kundër atyre që i nënvlerësojnë mirësitë edhe pse nuk gjenden ndërmjet atyre që mund të numërohen.¹² Mirësia është një rrugë që shkon drejt Allahut (xh.xh.).¹³ Një gjë që i pëlqen Allahut Teala është brenda mirësisë. Detyra e cila na takon ta kryejmë është që të përpiqemi dhe t’i pajisim edhe njerëzit e tjerë me pjekurinë e Ihsanit. “40 mirësitë” mund të ndryshojnë edhe sipas ndryshimit të kohës. Në kohët moderne duhet ta dimë se për cilat mirësi ka më shumë nevojë. Familja është vendi ku mirësia dhe Ihsani përjetohej me të gjitha llojet dhe kënaqësitë e tyre. Mirësitë që bëhen brenda familjes kanë më shumë rëndësi në këto kohë moderne.

MIRËSIA NË FAMILJE

Familja është themeli i shoqërisë. Edhe mirësia ndaj prindërve është bazë e fesë.¹⁴ Kënaqësia e Allahut është e lidhur me kënaqësinë e prindërve.¹⁵ Disa hadithe kanë shkaqet e transmetimeve të tyre. Andaj ne duhet ta dimë shkakun e transmetimit të hadithit, për shembull, “Xheneti është nën këmbët e nënave.” I Dërguari i Allahut (a.s.), e kishte pyetur për nënën një sahab që i kishte thënë se dëshironte të shkonte në luftë. Kur ai i tregoi se nëna e tij kishte nevojë për përkujdesje, i tha: “Atëherë mos u ndaj prej saj, sepse xheneti është nën këmbët e nënës.”¹⁶ Edhe në lidhje me “babanë” kanë ardhur lajme (hadithe) të rëndësishme. Për shembull, hadithin: “*Babai është dera e mesme e xhenetit.*”¹⁷, duhet ta vlerësojmë në këtë mënyrë. Për nënën dhe babanë që ka vdekur mund të mbahet agjërimit për kompensimin e agjërimit të tyre nëse kanë pasur agjërimit të pakryer. Gjithashtu mund të kryhet edhe obligimi i

haxhit.¹⁸ Kundrejt nënës dhe babait duhet të sillemi mirë edhe nëse nuk janë myslimanë.¹⁹ Nëse nëna ka ndërruar jetë, atëherë duhet të shfaqim mirësi ndaj tezes, sepse teza është në vendin e nënës.²⁰ Për prindërit që kanë ndërruar jetë mund të bëhen këto: Lutje, istigfar, kryhen amanetet, vizitohen të afërmit e tyre që janë gjallë dhe nderohen miqtë e tyre.²¹ Respektimi dhe nderimi i nënës, babait dhe të afërmeve të qumështit është si respektimi dhe nderimi i nënës, babait dhe të afërmeve të vërtetë.²² Ai që bën haxh për njërin prej prindërve i shkruhet sevap sikur ka bërë haxh edhe për vete. Edhe atij për të cilin ka bërë haxhin i bie borxhi i haxhit.²³ Gruaja të cilës i ka vdekur bashkëshorti në moshë të re dhe ajo e harxhon rininë e saj duke rritur fëmijët jetimë pa u martuar, në jetën tjetër do të jetë bashkë me pejgamberët.²⁴

FETARIA ËSHTË MARRËDHËNIA CILËSORE E NJERIUT ME ALLAHUN (XH.XH.). MIRËSIA E CILA ËSHTË NJË MANIFESTIM I FETARISË, KËRKON QË NJERIU T'I RREGULLOJË NË FORMË TË DREJTË MARRËDHËNIET ME VETEN DHE SHOQËRINË. SINQERITETI I NJERIUT NË FETARI ËSHTË I LIDHUR ME CILËSINË DHE SERIOZITETIN E VEPRAVE TË MIRA QË BËN AI. ANDAJ NUK DUHET T'I NËNÇMOJMË MIRËSITË DHE SHPËRBLIMIN E TYRE DUHET TA PRESIM VETËM NGA ALLAHU (XH.XH.).



Të gjitha mirësitë që prindërit i bëjnë ndaj fëmijëve të tyre kanë vlerë. Për shembull, veçanërisht mirësia e babait ndaj vajzave të tij ka sevap të madh²⁵, sepse vajzat kanë nevojë për interesimin e veçantë të prindërve derisa të arrijnë në moshë madhore. Babai mund ta vizitojë vajzën edhe pasi të martohet dhe ta puthë në faqe.²⁶ Edukimi i fëmijës kërkon një karakter të butë. Në këtë kontekst, edukimi i fëmijës nuk është diçka që merr një kohë të gjatë. Në lidhje me fëmijët është thënë: “Ata janë lulet me aromë të këndshme të Allahut që i bëjnë prindërit koprracë, frikacakë dhe injorantë.”²⁷ Edukimi është diçka që i mësohet fëmijës siç i mësohet shkuarja në tualet. Nisur nga ky kontekst, edukimi është më i lartë se dhënia e lëmshës.²⁸ Mashkulli gjithmonë duhet të mendojë që të sillet mirë ndaj familjes dhe të bëjë punë të mira.²⁹

MIRËSIA NË SHOQËRI

Në hadithe gjenden shumë shembuj në lidhje me mirësitë ndaj shoqërisë. Për shembull, fytyra e qeshur është lëmshë.³⁰ Fjala e mirë është lëmshë.³¹ Ne duhet të mbrohemi nga xhehenemi qoftë edhe me një gjysmë hurme.³² Falja e një deveje dikujt që të përfitojë nga qumështi i saj është sevap i madh.³³ Siç është mirësi mbulimi i gabimeve të myslimanit, edhe mbrojtja e dikujt që përgojohej është mirësi.³⁴ Allahu Teala e ka zbritur mëshirën, në mënyrë që të mos shkëputen lidhjet ndërmjet njerëzve. Allahu (xh.xh.), nuk e shkëput lidhjen me atë që nuk i shkëput lidhjet me të afërmit.³⁵ Ai që përkuajdeset dhe interesohet për jetimin duhet ta dijë se është një njeri i përgëzuar me xhenet që në këtë botë.³⁶ Edhe largimi i ferrës nga rruga është një mirësi.³⁷ Falja e një dhie të shëndetshme është prej këtyre mirësive.³⁸ Siç është mirësi bërja e mirësisë, edhe largimi nga mëkatet dhe ligësitë është mirësi.³⁹ Meqë po flasim për mirësinë në shoqëri, nuk do të ishte e drejtë të kalonim pa përmendur dy shembuj që gjenden në hadithet të cilat flasin për këtë çështje. Tani le të bëjmë një krahasim:

NDRYSHIMI I HAKIM IBN HIZAMIT NË LIDHJE ME MIRËSINË

Mbajtja e lidhjes me Allahun (xh.xh.), është një shenjë e fetarisë. Në hadithet fisnike gjenden dy biografi që na e mundësojnë ta krahasojmë periudhën e xhahilijetit me periudhën e Islamit. Njëri prej këtyre është Hakim ibn Hizami (v. 54/674). Hakimi ishte një sahab që u bë mysliman pas çlirimit të Mekës. Përgjatë të gjitha luftërave që ka bërë derisa i Dërguari i Allahut (a.s.), e çliroi Mekën, ai ka marrë pjesë në anët e politeistëve. Pas çlirimit të Mekës

përjetoj një proces të mirëfilltë të hyrjes në Islam. Ai u përpoq të përfitonte nga Pejgamberi (a.s.).

Hakim ibn Hizam (r.a.), një herë i bëri këtë pyetje të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! A do të kem sevape nga mirësitë që i kam bërë në periudhën e xhahilijetit si lutjet, lirimi i robërve dhe dhënia e lëmshës?” Përgjigja e Pejgamberit për këtë pyetje ishte: “Ti në fakt je bërë mysliman për shkak të këtyre mirësive që ke bërë më parë.”⁴⁰ Hakim ibn Hizami binte në sy si një njeri që i pëlqente të bënte mirësi edhe në periudhën e xhahilijetit. Ai i shpëtoi vajzat nga varrosja në dhe, liroi robër dhe ushqeui njerëz në nevojë. Me shumë mundësi edhe në kohën e xhahilijetit Hakim ibn Hizami ka pasur një ndjenjë “fetarie” në kontekstin e përgjërimit ndaj Allahut Teala. Kjo ndjenjë duket se është bërë shkak për nderimin e tij me Islam.

Ndërkohë gjendet edhe një personalitet tjetër i cili duhet të shtjellohet. Abdullah ibn Xhud’ani (v. ?/600) ishte një person që kishte fituar famë me përpjekjet e tij kundër padrejtësisë në periudhën e xhahilijetit. Ai ishte njëri prej dy personave që e themeluan organizatën Hilfu’l-Fudul te e cila ishte anëtar edhe i Dërguari i Allahut (a.s.). Mirësitë që kishte bërë Abdullah ibn Xhud’ani ndoshta ishin më të shumta se ato të Hakim ibn Hazmit. Aishja (r.anha), e pyeti Pejgamberin (a.s.), për këtë personalitet të rëndësishëm që kishte bërë këto vepra legendare në periudhën e xhahilijetit: “O i Dërguari i Allahut! Ibn Xhud’ani përkujdeset për të afërmit dhe i ushqen të varfrit. A do të kenë dobi prej këtyre që ka bërë?” Resulullahu (a.s.), iu përgjigj: “Nuk do të kenë asnjë dobi, sepse ai asnjëherë nuk ka thënë: O Allah! Më fal në ditën e gjykimit!”⁴¹

Ne duhet t’i krahasojmë këto dy personalitete dhe të nxjerrim mësim prej tyre. Ajo që mirësinë tonë mund ta bëjë të përherëshme është lidhja që formoj-

më me poseduesin dhe krijuesin tonë të pafillimtë dhe të pafund. Nëse nuk e kemi një lidhje të tillë, atëherë edhe mirësitë që mund t’i bëjmë janë të predispozuara për të shkuar dëm. Nëse presim që të na vlerësojë Allahu Teala i cili e di shumë mirë njetin tonë kur e bëjmë një mirësi, atëherë kjo është një shenjë e fetarisë së vërtetë. Atyre që thonë se morali është i pavarur nga feja dhe që i bëjnë veprat e tyre pa pasur ndonjë qëllim fetar, mund t’u thuhet: Islami bazohet te besimi se mirësitë do të kenë një shpërblim të përhershëm nga Allahu (xh. xh.), i cili është një Qenie e pafillimtë dhe e pafund. Mirësitë në këtë botë për dikë që beson se nuk do të bëhet gjë tjetër përveç se dhe, gurë apo rënë pasi të vdesë, mund të bëhen shkak për një lumturi të përkohshme. Por njeriu brenda vetes mbart edhe ndjenjën e dëshirës për t’u vlerësuar. Vlerësimi i njerëzve të përkohshëm është i përkohshëm pikërisht si ata vetë. Mundësia për t’u vlerësuar ato mirësi që nuk janë dërguar në përhershmëri, është e dobët. Domethënë se mirësitë bëhen shkak për udhëzimin e atij që i ka bërë.⁴² Ai që bën vazhdimisht mirësi pa krijuar aspak kontakt me Allahun, nuk do të ketë dobi prej atyre mirësive që ka bërë.⁴³

PËRFUNDIM

Fetaria është marrëdhënia cilësore e njeriut me Allahun (xh.xh.). Mirësia e cila është një manifestim i fetarisë, kërkon që njeriu t’i rregullojë në formë të drejtë marrëdhëniet me veten dhe shoqërinë. Singqeriteti i njeriut në fetari është i lidhur me cilësinë dhe seriozitetin e veprave të mira që bën ai. Andaj nuk duhet t’i nënçojmë mirësitë dhe shpërblimin e tyre duhet ta presim vetëm nga Allahu (xh.xh.). Pjesët “kitabu’l-birr” të librave të hadithit janë të mbushur plot me shembujt e bukur të fetarisë. Ai që dëshiron ta kuptojë fetarinë e singqertë, le të lexojë hadithet në “kitabu’l-birr”.

■ **REFERENCAT:** 1) Ibn Manzur, Muhammed b. Mukerrem, Lisanu’l- arab, I- XV, Bejrut, pa datë , V, 51. 2) Shik. Bekare, 2/177. 3) Buhari, Edeb, 69; Muslim, Birr ve Sile, 29. 4) Buhari, Savm, 35; Muslim, Sijam, 92. 5) Muslim, Birr, 14. 6) Buhari, Hibe, 2; Muslim, Zekat, 90. 7) Ebu Davud, Libas, 25. 8) Ibn Hibban el- Busti, Sahih (saktësoi. Shuajb Arnavuti), I- XVIII, Bejrut 1993/ 1414, II, 363. 9) Muslim, Birr, 14. 10) Buhari, Hibe: 35; Ebu Davud, Zekat: 42, (1683). 11) Azimabadi, Muhammed Eshref (v. 1329/1911) Avnu’l- ma’bud sherhu Suneni Ebi Davud, I- XIV, Bejrut 1415, VI, 68. 12) Saati, Abdurrahman, el- Fet’hu’r- Rabbani li tertubi Musnedi Ahmed, esh- Shejbani, I- XXIV, Bejrut, pa datë. 13) Shik. Nebe’, 78/39. 14) Buhari, Edeb, 2; Muslim, Birr, 1. 15) Tirmidhi, Birr, 3 (1900). 16) Nesai, Xhihad 6, (6, 11). 17) Tirmidhi, Birr, 3, (1901). 18) Muslim, Sijam 157, (1149); Tirmidhi, Zekat 31 (667); Ebu Davud, Vesaja 12, (2877), Zekat 31, (1656). 19) Buhari, Hibe, 28, Edeb, 8; Muslim, Zekat, 50 (1003); Ebu Davud, Zekat, 34, (1668). 20) Tirmidhi, Birr, 6, (1905). 21) Ebu Davud, Edeb, 129, (5142); Ubnu Maxhe, Edeb, 2, (3664). 22) Ebu Davud, Edeb: 129, (5145). 23) Hejthemi, Mexhmeu’z- zevaid, III, 282. 24) Ebu Davud, Edeb: 130, (5149). 25) Buhari, Zekat: 10, Edeb: 19; Muslim, Birr: 147, (2629); Tirmidhi, Birr: 13, (1916). 26) Ebu Davud, Edeb: 158 (5222); Buhari, Menakibu’l-Ensar: 45. 27) Tirmidhi, Birr: 11 (1911); Ibnu Maxhe, Edeb: 3, (3666). 28) Tirmidhi, Birr: 33, (1953). 29) Tirmidhi, Menakib: 85, (3892). 30) Muslim, Birr: 144, (2626). 31) Buhari, Edeb: 33; Muslim, Zekat: 52, (1005); Ebu Davud, Edeb: 68, (4947); Tirmidhi, Birr: 45, (1971). 32) Buhari, Rikak 49, 51, Tevhid 36, 24, Zekat 9, Menakib 25, Edeb 34; Muslim, Zekat 67, (1016); Tirmidhi, Kijamet 1, (2427). 33) Muslim, Zekat: 73, (1019). 34) Muslim, Birr ve sile, 17; Buhari, Edeb, 34. 35) Muslim, Birr ve sile, 23; Tirmidhi, Birr ve sile, 16. 36) Tirmidhi, Birr: 14, (1918). 37) Muslim, Mesaxhid: 58, (553). 38) Buhari, Hibe: 35; Ebu Davud, Zekat: 42, (1683); 39) Buhari, Zekat: 30, Edeb: 33; Muslim, Zekat: 55, (1008). 40) Buhari, Zekat, 24, Buju, 100, 12, Edeb: 16, Muslim, Iman, 194-196, (123). 41) Muslim, Iman, 365. 42) Buhari, Zekat: 24, Buju: 100, 12, Edeb: 16; Muslim, Iman: 194-196, (123). 43) Muslim, Iman, 365.



MIRAXHI NAMAZI NËNSHTRIMI

— Doç. dr. Kerim Bulladë —

Fjala “Miraxh”, e cila vjen nga rrënja “uruxh” që do të thotë të lartësohesh dhe të dalësh lartë, në kuptimin leksikor do të thotë të ngrihesh lart, mjet për të dalë lart, shkallë. Edhe nata e Miraxhit është quajtur “miraxh” ngaqë në të ngrihen lart lutjet.¹ Ndërsa në kuptimin terminologjik Miraxh është quajtur nata kur i Dërguari i Allahut (a.s.), është ngritur lart te Allahu Teala dhe ka dalë në audiencën e Tij.

Mrekullia e Miraxhit përbëhet nga dy pjesë të cilat janë: Israja dhe Miraxhi. E para, Israja/ecja/mbartja natën është përmendur në Kuranin Fisnik. Ndërsa e dyta që përbëhet nga mrekullia e miraxhit është përmendur në hadithet fisnike. Udhëtimi që i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka bërë në fazën e parë shprehet si më poshtë në Kuran:

“I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t’i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.”²

Për shkak se mbartja e të Dërguarit të Allahut (a.s.) nga Mesxhidu’l-Harami, apo thënë ndryshe, nga xhamia Haremi Sherif që e rrethon Qabenë e deri te Mesxhidu’l-Aksa / Bejtu’l-Makdis, është

1. Ragib el-Isfehani, Mufredatu Elfadhi’l-Kur’an, korrektoi Safvan Adnan Davudi, Bejrut, Daru’s-Samije, fq. 557.

2. Isra, 1.

shprehur qartazi në ajetin e mësipërm, është farz të besohet.

Çështja se si ka ndodhur ngjarja e israsë dhe miraxhit dhe se Pejgamberi ka dalë në audiencën hyjnore me shpirt apo me gjithë trup e shpirt, është shpjeguar në libra të ndryshëm të hadithit dhe të literaturës islame. Në vend që të diskutojmë dhe t'i përsërisim edhe një herë tjetër këto, mendoj se duhet të lexojmë shpirtin e miraxhit. Cili është shpirti që miraxhi i ka dhënë umetit? Cilat rregulla i janë dhënë umetit të Muhamedit nëpërmjet të Dërguarit të Allahut (a.s.)? Për këto pyetje mund të kemi shumë përgjigje. Por më i rëndësishmi prej të gjithë këtyre padyshim që është namazi.

Besimtari i cili e këndon Fatihanë në çdo rekat, e përsërit fjalinë: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”**, për t'i shprehur Allahut Teala nënshttrimin dhe besnikërinë. I ndjeri Hamdi Jazëri e komenton këtë ajet në një formë shumë interesante:

“O Zot! Ne të bindemi vetëm Ty duke të pranuar vetëm Ty si Hyjni. Vetëm Ty ta shprehim dobësinë tonë dhe vetëm duke t'u bindur Ty e arrijmë prehjen shpirtërore, sepse Ti je i pari dhe i fundit të cilit mund t'i drejtohem për të gjithë frikën dhe shpresat tona. Nëse Ti nuk na jep frikë, atëherë nuk ka frikë. Nëse Ti nuk na jep shpresë, atëherë nuk ka shpresë. Shpirti është i Yti, materia është e jotja dhe i gjithë trupi është i Yti. Ndjenjat, prirjet, imagjinatat, mendimet, vullneti dhe ndërgjegjja janë mirësi dhe mëshirë e Jotja.”

Sa gjë e madhe është që të arrijmë të themi me gjithë shpirt e zemër:

“Adhurimi ndaj Allahut siguron një sublinitet i cili është mbi çdo lloj lartësimi. Shumë zemra pandehin se lartësimi është i pamundur. Unë në këtë gjithësi nuk ia nënshtroj vullnetin tim askujt përveç Allahut. Vetëm Atij dhe urdhrin të Tij i bindem. Vetëm Atij më pëlqen t'i bindem dhe vetëm Atë e urrej ta kundërshtoj. Rend për të bërë mirë dhe largohem nga e keqja. Kjo ngase e di se Zoti e do mirësinë. Unë nuk i nënshtrohem asnjë gjëje që nuk i bindet urdhrin të Allahut Teala dhe që nuk bëhet për hir të Allahut (xh.xh.). Sepse unë

nuk ekzistoj, ndërsa Ai më solli në ekzistencë, më edukoi dhe më dha liri. Shpirti, ndërgjegjja dhe liria janë amaneti i Atij te unë. Ai që arrin t'i bëjë një herë këto, mund t'i bëjë përgjithmonë. Për këtë arsye, çdo gjë e sakrifikoj në rrugën e Atij. Në rrugën e Atij mund t'i duroj dhimbjet, bëj bamirësi dhe ua vë kraharorin padrejtësive. Nëse nuk mund të duroj dhe t'ua vë kraharorin, atëherë vdes. Në fakt ky është urdhri i Tij. Domethënë, një ditë do të vdes. Nëse do të vdes, atëherë le të vdes me një besim dhe miqësi të tillë. Fillimi im ka qenë dheu. Andaj edhe fundi do të jetë dheu. Kam ardhur nga Allahu dhe do të shkoj te Allahu. Ja pra, unë jam një rob i tillë i Allahut (xh.xh.). Nëse mbështetem te vetja, jam një hiç. Nëse lidhem me Atë, bëhem çdo gjë...” Si mund të ketë lartësim dhe fuqi më të madhe për njeriun se kjo?

Myslimanët e parë të cilët u mblodhën nën flamurin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), duke thënë: **“Vetëm Ty (o Zot) të adhurojmë.”** – dhe të cilët e përhapën dhe e vërtetuan madhësitinë e Allahut Teala për njëzet-tridhjetë vjet në të gjithë tokën, mbartnin plotësisht këto ndjenja. Ata të cilët i humbën këto ndjenja, iu nënshtuan kësaj bote. Padyshim se kjo marrëveshje është një barrë e rëndë, por pozita e lartë që fitohet te Zoti (xh.xh.), nuk është një qëllim që arrihet lehtë.”³

Kur Allahu Teala e krijoi Ademin (a.s.), i urdhëroi engjëjt që t'i bënin sexhde atij. Engjëjt menjëherë i bënë sexhde duke shfaqur nënshttrim ndaj urdhrin të Allahut (xh.sh.). Ndërsa krijesa që quhej Iblis doli kundër urdhrin të sexhdes dhe nuk iu bind Allahut. Vetja iu duk e madhe. Ai e refuzoi sexhden duke u shprehur: **“Unë jam më i mirë se ata.”**⁴ Për këtë arsye u përzë nga mëshira hyjnore.

Sexhdja e cila është njëra prej shtyllave më të rëndësishme të namazit, është forma më e lartë e nënshttrimin ndaj Zotit. Për këtë arsye, namazi është shenja e besnikërisë në shkallën më të lartë ndaj Allahut.

Namazi është një nënshttrim dhe bindje që shfa-

3. Shik. Jazër, Muhammed Hamdi, Hak Dini Kuran Dili, Stamboll, Shtëpia Botuese Eser, 1971, I, 102-104.

4. Sad, 76.

Namazi është praktika e teuhidit. Ai është kalim nga besimi në aksion. Namaz do të thotë që t'i përsërisim parimet themelore të teuhidit me gjuhën, zemrën dhe veprimet tona dhe ta rinovojmë besimin e vendosmërinë tonë.



NAMAZI ËSHTË NJË PARIM I DOMOSDOSHËM I ADHURIMIT. NËSE NUK KA NAMAZ, NUK MUND TË BËHET FJALË PËR NËNSHTRIM NDAJ ALLAHUT TË LARTËSUAR. NAMAZI ËSHTË IBADETI MË I RËNDËSISHËM PAS BESIMIT TË CILIN E KRYEN PERSONI QË ËSHTË LIDHUR ME GJITHË SHPIRT NDAJ ALLAHUT DHE QË DUHET TË VAZHDOJË TA KRYEJË. NËNSHTRIMI QË SHFAQET TE ADHURIMET E TJERA TË CILAT I KA URDHËRUAR ALLAHU TEALA, FILLON ME NAMAZIN, VAZHDON ME NAMAZIN, MBROHET ME NAMAZIN DHE PLOTËSOHET ME NAMAZIN.

get vetëm ndaj Allahut Teala me të gjithë qenien e njeriut e cila përbëhet nga shpirti dhe trupi. Shprehja: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”, e cila përsëritet në çdo rekat të namazit, është deklaratë e nënshtimit ndaj Zotit (xh.sh.). Besimtari, i cili ia dorëzon veten Allahut Teala me këtë pohim, me lutjen dhe përgjërimit: “Na udhëzo në rrugën e drejtë.”, shprehet se Allahut i beson me sinqeritet.

Namazi është një parim i domosdoshëm i adhurimit. Nëse nuk ka namaz, nuk mund të bëhet fjalë për nënshtim ndaj Allahut të Lartësuar. Namazi është ibadeti më i rëndësishëm pas besimit të cilin e kryen personi që është lidhur me gjithë shpirt ndaj Allahut dhe që duhet të vazhdojë ta kryejë. Nënshtimi që shfaqet te adhurimet e tjera të cilat i ka urdhëruar Allahu Teala, fillon me namazin, vazhdon me namazin, mbrohet me namazin dhe plotësohet me namazin.

Për sa i përket nënshtimit ndaj Zotit, nuk mjafton vetëm pohimi me zemër (besimi), por më e pakta duhet edhe pohimi me gjuhë duke e reflektuar atë nga zemra për jashtë. Vepra më e qartë e një njeriu që e reflekton jashtë besimin e tij është namazi. Ata që e shfaqin nënshtimin e tyre kundrejt Allahut Teala me namaz, nuk i nënshtrohen askujt përveç Atij. Ata që shfaqin nënshtim duke e falur namazin në kuptimin e plotë të fjalës, Allahu i Madhëruar nuk i ka lënë në duart e të tjerëve dhe ua ka mbrojtur atyre nderin.

Në namazin që falet siç duhet bëhet fjalë që njeriu t’ia dorëzojë të gjithë qenien e tij dhe çdo gjë që posedon Allahut Teala dhe t’i drejtohet vetëm Atij në një status adhurimi të plotë. Shpirti i

nënshtimit për të cilin flitet në ajetin: “*Kur Zoti i tij i tha: “Përu! ai u përgjigj: “Iu përula Zotit të gjithësisë!”*”⁵, arrihet vetëm me namaz.

Namazi është praktika e teuhidit. Ai është kalim nga besimi në aksion. Namaz do të thotë që t’i përsërisim parimet themelore të teuhidit me gjuhën, zemrën dhe veprimet tona dhe ta rinovojmë besimin e vendosmërinë tonë.⁶

Nisur nga ky komentim, namazi është shprehje e nënshtimit ndaj Allahut me të gjitha veprimet tona. Në ajetin: “*Drejttojuni Atij me pendesë, frikësojuni Atij dhe falni namazin e mos u bëni si ata, që i shoqërojnë Atij diçka tjetër (në adhurim).*”⁷, flitet për t’ju drejtuar Allahut dhe për të falur namaz. Domethënë se veçoria më dalluese e nënshtimit ndaj Allahut (xh.xh.), është respekti ndaj Tij dhe falja e namazit.

Namazi mundëson lartësimin fiziko-shpirtëror të njeriut dhe pjekjen e nefsit. Në sajë të namazit besimtari del në audiencën e Allahut Teala dhe arrin afrimitetin shpirtëror me Të duke iu lutur dhe përgjëruar. Kjo gjendje është një nder i madh për besimtarin. Namazi në të njëjtën kohë është një pasuri shpirtërore.

Allahu Teala urdhrin për faljen e namazit nuk e ka zbritur nëpërmjet engjëllit, por ia ka dhënë vetë Resulullahut, (a.s.), natën e miraxhit. (Shik. Buhari, Salat, 1. Muslim, Iman, 263.) Kjo tregon rëndësinë dhe kuptimin e këtij adhurimi nga aspekti i jetës fetare dhe shpirtërore të besimtarit.

5. Bakara, 131.

6. Abdullah Jëlldëz, Namaz bir tevhid eylemi, Stamboll, 2004, fq. 23.

7. Rum, 31.

DORA E MËSHIRËS QË I ZGJATET NJERIUT

— Ali Byjyqçapar —

Jemi në shekujt kur njeriu është marrë në qendër. Çdo koncept po përkufizohet dhe po vlerësohet sipas njeriut. Edhe vendimet për vlerat po jepen sipas kësaj.

Të shohësh se egoja papritur është nxjerrë në plan të parë dhe se si njeriu po shkatërrohet në humnerat e asgjësë, është shumë e dhimbshme. Vallë, çfarë është mesatare? Si e përkufizon njeriun rruga e mesme?

Sipas Islamit njeriu është një qenie inteligjente, e pajisur me vullnet, përgjegjëse, e pajisur me shpresë, dinamike, e pajisur me aftësinë për të punuar dhe e pajisur me dije, e cila është dërguar në këtë botë për t'u sprovuar. Nefsi dhe shejtani janë armiqtë në këtë rrugë. Andaj lufta ndërmjet të vërtetës dhe të pavërtetës nuk do të marrë fund deri në kiamet. Nga lufta ndërmjet të mirës dhe të keqes, nga vlerësimet e të bukurës dhe të shëmtuarës dhe nga luhatjet ndërmjet të dobishmes dhe të dëmshmes do të dalë në pah energjia e jetës. Edhe njeriu do të shohë manifestimet e emrave të Zotit në këtë rrugë sipas veprave të tij.

Islami nuk e pranon mendimin se njeriu është produkt i natyrës dhe se është vetëm një qenie fizike. Edhe pse ai lind në natyrë, mendimi i tij për të mbinatyrshmen ia hap derën vazhdimisht në formate estetike. Tragjedia që i ka sjellë shekullit tonë materializmi i verbër, na ka privuar nga shteti ynë madhështor. Ndërsa iniciativa për një rigjallërim, na ka mbartur deri në këto ditë me dhimbje të përpshkrueshme në ekzistencën tonë sociale.

Vetëm disa zemra kanë mbetur pa u prishur nga dallga e femohimit që po përjetohet në të gjithë botën. Ndërkohë që u shfaq përsëri e vërteta që jeton në esencën e ekzistencës, shumë shembuj që i përkisnin botës së djeshme u perceptuan ndryshe dhe u harruan.

“Allahu është me robërit e Tij.” (Maide, 12)

Ndërkohë që po komentohet përsëri kjo urtësi hyjnore e Kuranit Fisnik, njerëzimi i cili po kalon nëpër një mijë e një vështirësi, po përjeton emocio-

nin e rigjetjes së kësaj drite që ka rënë në duart e tij. Njerëzimi po përjeton një gëzim të jashtëzakonshëm prej hyrjes në fushën e mëshirës së fesë.

Kur njeriu, i cili mahnitet nga veprat e veta, i ktheu shikimet nga hyjnorja, u gjend ballë për ballë me këtë urtësi. A mund të jetë njeriu i pavlefshëm nëse të gjitha krijesat i shërbejnë atij? Ndërkohë që njerëzve ua dridh zemrat urdhri hyjnor: **“O ju që keni besuar! Kini frikë nga Allahu ashtu siç i takon Atij.”** (Al Imran, 102), edhe ajeti fisnik: **“Padyshim se Ne e kemi krijuar njeriun në formën më të bukur.”** (Tin, 4), e merr njeriun dhe e lartëson.

Asketizëm dhe devotshmëri!

Kur besimtari i dorëzohet Allahut (xh.xh.), me të gjithë qenien e tij, te ai formohet një ndjenjë e thellë sigurie dhe një gjendje e pasur shpirtërore. Kjo e bën atë të punojë në mënyrë të ekuilibruar edhe për këtë botë, edhe për botën e përtejme. Atij ia zvogëlon dhimbjet e vështirësitë e jetës dhe e bën të mos i ndjejë fare ato.



Stofia

e të gjitha veprave të mira

— Xhafer Durmush —

Në suren Ahzab thuhet: **“Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të sinqertët) dhe të drejtat (të sinqertat), duruesit dhe durueset, të përlulurit dhe të përlulurat, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.”** (Ahzab, 35)

Ajeti fisnik njofton se burrat dhe gratë që i posedojnë dhjetë cilësi të cilat radhiten aty, do të arrijnë faljen hyjnore dhe një shpërblim madhështor. Përgëzimi hyjnor në këtë ajet është një mirësi e veçantë për gratë edhe pse ajeti i përfshin edhe burrat, edhe gratë, sepse në përgjithësi Kuranit Fisnik nuk e ka bërë një ndarje të tillë. Ndërsa këtu gratë janë përmendur për çdo cilësi. Njëri prej urtësive të kësaj e gjejmë në transmetimet e ardhura në lidhje me shkakun e zbritjes së ajetit fisnik: Ummu Umare (r.anha), një ditë i tha Resulullahut (a.s.): “O i Dërguari i Allahut! Shoh se në Kuran gjithmonë flitet për burrat dhe se nuk flitet shumë për gratë.” Nisur

nga kjo, zbriti ky ajet fisnik. Sipas një transmetimi tjetër, Ummu Seleme (r.anha), i tha Pejgamberit (a.s.): “O i Dërguari i Allahut! Burrat dalin për luftë, luftojnë dhe bien dëshmorë. Ndërsa ne nuk mund t'i bëjmë këto. Përveç të tjerash, në trashëgimi neve na jepet gjysma e pjesës që u jepet burrave. Ah sikur edhe ne të ishim burra.” Nisur nga kjo, zbriti ky ajet fisnik.¹

Për mendimin tonë, radhitja e dhjetë cilësive të lavdëruara këtu është e rëndësishme dhe interesante. Bazuar në këtë, hyrja në rrugën që i shpie besimtarët te shpërblimi madhështor është e mundur vetëm duke hyrë në rrethin e Islamit. Domethënë, së pari Islami, pastaj besimi. Të besuarit me sinqeritet ndaj bazave të akides të cilat e plotësojnë besimin dhe obligimeve që vijnë bashkë me to. Pastaj vjen vazhdueshmëria me vendosmëri ndaj adhurimeve. Pastaj të qenët i drejtë në të gjitha veprimet dhe të jetuarit me besnikëri siç i ka hije myslimanit. Pastaj zbatimi i urdhrave të fesë që i duken të vështira nefsit dhe shfaqja e durimit për t'u larguar nga gjërat e ndaluara. Pastaj vjen respekti ndaj Allahut (xh.xh.). Pastaj vjen frenimi i ndjenjës për të mbledhur sa më shumë pasuri duke dhënë sipas mundësisë. Pastaj vjen frenimi dhe edukimi i nefsit me agjërime. Pastaj mbajtja e nderit ndërkohë që kryhen këto. Ajo që



i ka hije myslimanit është që të jetojë me nder dhe dinjitet.

Këtu ka edhe një cilësi tjetër e cila i përsos të gjitha këto. Ajo është stolisja me dhikër e të gjitha veprave të mira që janë përmendur apo jo në këtë ajet. Shumë interesant është fakti se cilësia e dhjetë e cila i shpie besimtarët te shpërblimi i madh është shprehur në formën “përkujtuesit e përkujtueset”. Krahas kësaj, kjo cilësi nuk është kufizuar me ndonjë rregull, por është theksuar në formën: “Përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset.”

Po, besimtarët duket t’i posedojnë në kuptim të plotë këto cilësi dhe virtytet e tjera islame që vijnë prej tyre. Gjëja e parë që na thuhet në ajet është kjo. Ndërsa e dyta: Dhikri është një shije dhe stoli që mund t’i shtohet çdo vepre të mirë. Një burrë shkoi te Resulullahu (a.s.) dhe e pyeti: “O i Dërguari i Allahut! Cili xhihad e ka shpërblimin më të madh?” Përgjigja që i dha Pejgamberi (a.s.), ishte: “*Xhihadi i atyre që e përkujtojnë shumë Allahun Teala.*” Kur burri e pyeti përsëri: “Cili agjërim e ka shpërblimin më të madh?”, Profeti i Zotit ia ktheu: “*Agjërimi i atyre që i bëjnë shumë dhikër Allahun Teala.*” Pas këtyre dy pyetjeve, ky person i tha Resulullahut, (a.s.), se cili namaz, zekat, haxh dhe lëmshë e kishte mirësinë më të madhe. Përgjigja që mori ishte: “*I atyre që e përkujtojnë shumë Allahun.*” Pasi Ebu Bekri (r.a.), e dëgjoji këtë përgjigje, i tha Omerit (r.a.): “O Ebu Hafs! Ata që e përkujtojnë shumë Allahun e morën të gjithë shpërblimin.” Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, u drejtua nga ata dhe tha: “*Po, ashtu është.*”

Bazuar në këto që thamë më sipër, besimtari duhet t’ia dijë vlerën kohës dhe jetën duhet ta vlerësojë si një mundësi e cila e shpie te falja hyjnore. Ai duhet

ta vlerësojë kohën me ibadet apo me vepra të dobishme dhe të gjitha punët e tij duhet t’i stolisë me përkujtimin e Allahut (xh.xh.). Përkujtimin e Allahut Teala nuk duhet ta lërë vetëm për në mexhliet e dhikrit, por edhe gjuhën gjithmonë duhet ta preokupojë me shehadetin, salavatet sherife dhe dhikre të tjera të ngjashme me këto. Kur të mos ketë mundësi për t’i thënë këto, atëherë duhet ta bëjë dhikrin me zemër, sepse njeriu në botën e përtejme kështu do të dëshirojë ta kishte kaluar jetën. Ata që nuk veprojnë në këtë mënyrë, do të pendohen shumë.³

E vërteta është kjo se çdo ajet i Kuranit Fisnik posedon mirësinë që mund të na shpie te lumturia e të dyja botëve. Hadithet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), janë shpjegimi më i saktë dhe influencues i Kuranit. Mjafton që t’i lexojmë, t’ua mësojmë edhe të tjerëve dhe t’i zbatojmë në jetë.

■ **REFERENCAT:** 1) Esbabu’ n-Nuzul, fq. 62; Ahmed ibn Hanbel, Musned, VI, 305. 2) Ahmed ibn Hanbel, Musned, III, 438. 3) Ebu Hurejra (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “*Çdo njeri që vdes, pendohet. Nëse është njeri i mirë, do të pendohet se pse nuk ka bërë edhe më shumë vepra të mira. Nëse është njeri i keq, do të pendohet se pse nuk e ka lënë ligësinë.*” (Tirmidhi, Zuhd, 59.)



NEVOJA PËR PREHJE SHPIRTËRORE

Në suren Fet’h thuhet: “*Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t’ua forcuar besimin, krahas besimit që patën. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.*” (Fet’h, 4)

Qetësia që është përmendur në ajetin fisnik shpreh prehjen shpirtërore. Pra, do të thotë që zemra të arrijë prehje shpirtërore për shkak të argumenteve të qartë që i sheh dhe i percepton. Do të thotë që zemra të arrijë prehje të plotë duke u zhveshur nga dyshimet dhe shqetësimet. Dija në zemrën e besimtarit që e arrin këtë pozitë shpreh siguri dhe në këtë mënyrë e mbron mbartësin e saj nga shqetësimet. Kur ky ajet fisnik, të cilin po e shtjellojmë, zbriti përgjatë Marrëveshjes së Hudejbijes, zemrat e besimtarëve u kapluan nga një prehje shpirtërore. Siç shprehet në suren Teube, edhe zemrës së Ebu Bekrit (r.a.), i cili u shqetësua prej ardhjes së politeistëve deri te shpella ku ishin fshehur përgjatë hixhretit, i zbriti prehja shpirtërore kur i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “*Mos u mërzit. Allahu është me ne.*” (Shik. Teube, 40.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), i ka treguar rrugën e duhur umetit të tij. Kjo prehje shpirtërore nuk është e kufizuar vetëm me momentet e vështirësisë dhe shqetësimit, por përkundrazi ajo është një liman qetësie që përfshin të gjithë jetën, sepse Resulullahu (a.s.), na ka njoftuar se “engjëjt i rrethojnë ata njerëz që mblidhen për të përkujtuar Allahun Teala dhe se mëshira hyjnore dhe qetësia zbresin mbi ata”. (Shik. Muslim, Dhikr, 25.)



TË JETUARIT SI MYSLIMAN NË VENDE TË NDRYSHME

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

TENTATIVAT E POLITEISTËVE QË BASHKOHESHIN NË BAZËN “PËR T’I NDALUAR MYSLIMANËT NGA RRUGA E ALLAHUT” PËRGJATË VITEVE TË PARA TË SHOQËRISË ISLAME NË MEKË, VAZHDUAN NË MËNYRË DHE RRUGË ÇNJERËZORE. KRAHAS KËTYRE, MYSLIMANËT VEPRUAN SIPAS ORIENTIMIT TË TYRE ME INSISTIM, SHFAQËN DURIM E REZISTENCË, QËNDRUAN FUQISHËM NË KËMBË DHE U PËRPOQËN QË TË MOS HYNIN NË LUFTË ME MUSHRIKËT.

Temën “të jetosh si mysliman” mund ta shtjellojmë nën dy pika për sa i përket aspektit të mjedisit: Të jetosh si mysliman bashkë me Ummeti Ixhabet (myslimanët) dhe të jetosh si mysliman me Ummeti Davet (jomyslimanët).

1. TË JETUARIT SI MYSLIMAN BASHKË ME UMMETI IXHABET (MYSLIMANËT)

“Të jetuarit si mysliman bashkë me” Ummeti ixhabet, domethënë myslimanët, do të thotë që ta ndash jetën me të tjerët brenda kornizës së vëllazërisë së fesë dhe me vetëdijësimin e të qenët umet. Bashkimi në këtë kontekst është i detyruar të jetë i indeksuar ndaj “besimit Islam”, domethënë, të jetë i lidhur

ndaj bazave dhe vlerave të Kuranit dhe Sunetit. Korniza e vëllazërisë që e formon ajeti: “Besimtarët janë vëllëzër...”¹ dhe shprehja: “Unë jam prej myslimanëve.”², tregojnë bazën dhe vazhdimësinë e vijës së vëllazërisë në besim. Për këtë arsye, reflektimi me këtë cilësi i modelit të jetës së myslimanit për të cilin janë dhënë shembuj nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), brenda kornizës së Kuranit dhe Sunetit, është i nevojshëm edhe në shkallë individ, edhe në shkallë umeti. Duket qartazi se kjo nevojë është e padiskutueshme, absolute dhe mbart një cilësi strukturore për të gjithë popujt dhe shoqëritë islame në çfarëdo vendi të botës që të gjenden.

Te popujt myslimanë përgjatë gjithë procesit historik duke ia nisur që nga fillimi në përgjithësi janë zbatuar bazat sociale, morale e juridike të të jetuarit së bashku dhe praktikata e këtyre. Por nganjëherë për fat të keq janë përjetuar edhe probleme shumë serioze në aspektin e “bashkimit” për shkak të shprehjes së vetes dhe pozicionimit të disa grupeve e shoqërive që u formuan ndërmjet popujve myslimanë. Kjo situatë ka arritur deri aty sa që ndërmjet tyre janë parë dhe po shikohen deklarata, sjellje, veprime, zënka dhe përplasje shoqërore të cilat i vënë në pozitë të vështirë, i prishin dhe i nxjerrin jashtë kornizës së legjitimitetit konceptet si vëllazëria në fe dhe umet. Në përgjithësi veprimet dhe shkaqet që nuk përputhen dhe që e dëmtojnë unitetin e mbështetur te parimi i vëllazërisë në fe, për fat të keq nuk janë fare të pakta. Fatura e parë për popujt myslimanë e këtyre veprimeve dhe sjelljeve³ është dëmtimi në kuptim serioz i ndjenjave dhe praktikave të vëllazërve myslimanë për të qenë bashkë, madje këto ndjenja dhe praktika pothuajse kanë humbur në një masë të madhe edhe pse jo krejtësisht. Ndërsa rezultati është ky: Përhapja dhe influenca e një lloji të shoqërisë që zemrat i ka të ndara⁴ edhe pse pandehet se i ka të bashkuara. Kjo gjendje është

bërë shkak që të shkatërrohen cilësitë dhe virtetet e myslimanëve për të jetuar së bashku sipas Islamit dhe si rrjedhojë pothuajse çdo grup, xhemat apo shoqëri përpiqet për të siguruar epërsi në një mënyrë të çuditshme dhe të pakuptueshme. Emri i një gjendjeje të tillë nuk është “të jetuarit bashkë me të tjerët”, por mund të jetë vetëm “të dukurit sikur jemi duke jetuar bashkë”. Këtë gjendje mund ta quajmë edhe fenomen i një shoqërie që e ka copëtuar në një mijë pjesë fenë dhe besimin e vet. Thënë me një shprehje tjetër, kjo gjendje mund të quhet edhe atmosferë përçarjeje e cila është më e keqe se vrasja.⁵

TEMËN “TË JETOSH SI MYSLIMAN” MUND TA SHITJELLOJMË NËN DY PIKA PËR SA I PËRKET ASPEKTIT TË MJEDISIT: TË JETOSH SI MYSLIMAN BASHKË ME UMMETI IXHABET (MYSLIMANËT) DHE TË JETOSH SI MYSLIMAN ME UMMETI DAVET (JOMYSLIMANËT).



2. TË JETUARIT SI MYSLIMAN ME UMETI DAVET (JOMYSLIMANËT)

Të jetuarit e myslimanëve me grupe që kanë besime të ndryshme është ilustruar me shembuj nga Pejgamberi, (a.s.), në faza të ndryshme.

Të jetuarit si mysliman ndërmjet umeti davetit, domethënë ndërmjet jomyslimanëve, do të ishte e përshtatshme që ta ndanim në dy pjesë të cilat janë: Të jetuarit në Daru’sh-Shirk apo Daru’l-Kufr dhe në Daru’l-Emn.

a. Të jetuarit si mysliman në Daru’sh-Shirk ose në Daru’l-Kufr apo faza “ju keni fenë tuaj, unë kam fenë time”

Këtë periudhë e gjejmë të shpjeguar me shprehjet më të qarta në suren Kefirun e cila ka zbritur në Mekë. Për këtë arsye, këtë sure e

kanë quajtur Ihlasan / dy ihlas ngaqë bashkë me suren Ihlas kanë vendosur në formën më të qartë parimin e tevhidit/njësimit absolut të Allahut (xh. xh.), sepse në këto sure është theksuar në një mënyrë krejt të qartë se besimi e adhurimet islame asnjëherë nuk mund të bashkohen me shirkun dhe se tevhidi e shirku nuk mund ta zënë vendin e njëri-tjetrit. Në vendet ku dominon shirku e kufri, pozita e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe qëndrimi i myslimanëve është i caktuar sipas konceptit: “Ju keni fenë tuaj, unë kam fenë time.” Pra, unë do të

1. Shik. Huxhurat, 10.

2. Shik. Fussilet, 33.

3. Pwr informacion mw tw gjerw shik. Ismail Lutfi Çakan, Ummet Risalesi, fq. 71-140, Stamboll, 2016 (Botimet IFAV).

4. Shik. Hashr, 14.

5. Shik. Bekare, 217.

vazhdoj ta zbatoj dhe ta përhap fenë time. Fenë tuaj nuk do ta pranoj. Në këtë çështje nuk mund të bëjmë pazarllëk.

Tentativat e politeistëve që bashkoheshin në bazën “për t’i ndaluar myslimanët nga rruga e Allahut” përgjatë viteve të para të shoqërisë islame në Mekë, vazhduan në mënyrë dhe rrugë çnjerëzore. Krahas këtyre, myslimanët vepruan sipas orientimit të tyre me insistim, shfaqën durim e rezistencë, qëndruan fuqishëm në këmbë dhe u përpoqën që të mos hynin në luftë me mushrikët.

Kokat e vjetra dhe ato aktuale që dëshirojnë ta shtjellojnë si laicitet/shekullarizëm ajetin fisnik “ju keni fenë tuaj, unë kam fenë time” i cili vërteton dhe formon qëndrimin parimor të kësaj periudhe, kuptohet se nuk e shohin dot apo bëjnë me vetë-dije sikur nuk e shohin vendosmërinë dhe vullnetin për të caktuar pozitën këtu, për ta zbatuar Islamit dhe për të vazhduar me aktivitetin e përhapjes së tij. Ndërkohë në këtë ajet caktohet qëndrimi i myslimanëve i cili shpreh rezistencën dhe të zbatuarit e besimit pa hyrë në konflikt në daru’sh-shirk apo në daru’l-kufr.

Edhe mënyra e jetesës së të Dërguarit të Allahut, (a.s.), duhet të merret parasysh në lidhje me këtë çështje, sepse Pejgamberi (a.s.), ka lindur dhe është rritur në një mjedis politeistësh. Por Resulullahu (a.s.), kaloi një periudhë pa iu bashkuar asnjë veprimi që mbante erë shirku të asaj shoqërie, pa shfaqur ndonjë mangësi morale dhe duke iu bashkangjitur e mbështetur organizatat e atyre si Hilfu’l-Fudul e cila kishte si qëllim mbrojtjen e të drejtës dhe të atyre që ishin në të drejtë.

Përvojat e myslimanëve për të jetuar sipas Islamit dhe së bashku me të tjerët në daru’sh-shirk kanë qenë këto: Durimi për të zbatuar besimin e tyre dhe qëndrimi për të bërë predikim të vërtetë pa kërkuar ndonjë pozitë prej sistemit të shirkut që ishte dominues, pa bërë ndonjë kryengritje kundrejt veprimeve të (jobsimtarëve) dhe pa u kundërpërgjigjur me dhunë kundrejt presioneve që përjetonin.

b. Të jetuarit sipas Islamit në daru’l-enn

Qëndrimi i myslimanëve për të jetuar së bashku në daru’sh-shirk sipas rregullave të Islamit dhe të vazhduarit e këtij qëndrimi, me kalimin e kohës

zgjoi shqetësime serioze të politeistët. Si rrjedhojë, ky qëndrim u bë shkak që myslimanëve t’u bëheshin shtypje shumë të forta. Për shkak të këtyre shtypjeve të padurueshme, i Dërguari i Allahut (a.s.), u dha leje disa myslimanëve që të shkonin në Abisini. Ky vend në botën e asaj kohe konsiderohej si Daru’l-Emn (vend i sigurt). Jeta në Abisini nga aspekti i muhaxhirëve myslimanë filloi fazën e “të jetuarit së bashku” nën një udhëheqje të krishterë, domethënë në një shoqëri jomyslimane. Myslimanët, fal tolerancës që u shfaq kundrejt tyre në këtë vend, u mjaftuan vetëm me përpjekjen për të zbatuar besimin e tyre pa bërë ndonjë lëvizje politike apo shoqërore. Në sajë të mirëkuptimit dhe tolerancës së mbretit të Abisinisë, Nexhashit sikundër veprimeve dhe sjelljeve çnjerëzore të politeistëve të Mekës, myslimanët vazhduan jetën e tyre fetare në një vend më të qetë krahasuar me Mekën duke iu përmbajtur parimit “ju keni fenë tuaj, unë kam fenë time”.

Shkurtimisht, të jetuarit e myslimanëve bashkë me jomyslimanët edhe në daru’l-enn është realizuar (ka ndodhur) vetëm në formën e zbatimit të besimit dhe si rrjedhojë, e predikimit real të këtij të fundit pa pasur ndonjë kërkesë politike, administrative dhe ekonomike.

PËRFUNDIM

Siç u përpoqëm ta përmbledhim, përgjatë procesit historik umeti i Muhamedit, domethënë myslimanët të cilët kanë përvojën dhe parimin e “të jetuarit së bashku” oftoft edhe më njerëzit e besimeve të tjera sipas disa rregullave të caktuara, është shumë e natyrshme që prej tyre të pritët ta përditësojnë në shkallën më të lartë të mundshme këtë parim dhe përvojë ndërmjet tyre brenda kornizës së fesë dhe vëllazërisë në besim. Një situatë e tillë do të thotë që ta zbatojmë si umet urdhrin dhe paralajmërimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili shprehet: “Zbatimi i detyrave fetare në gjendje trazirash dhe kaosi shoqëror është si hixhreti për mua.”⁶ Kjo nuk realizohet duke u dukur sikur jemi të bashkuar, por duke vepruar sipas virtutit për t’i dhënë përparësi vëllazërisë në besim cilido oftoft vendi apo mjedisi. Të tjerat përveç kësaj do ta linin derën hapur për debate të pafundme nga aspekti i të jetuarit sipas Islamit.

6. Muslim, Fiten 130; Tirmidhi, Fiten 31; Ibn Maxhe, Fiten 14; Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 25.

**MËNYRA E JETESËS
SË TË DËRGUARIT
TË ALLAHUT, (A.S.),
DUHET TË MERRET
PARASYSH NË LIDHJE
ME KËTË ÇËSHTJE,
SEPSE PEJGAMBERI
(A.S.), KA LINDUR
DHE ËSHTË RRITUR
NË NJË MJEDIS
POLITEISTËSH.**



ATY KU FILLOI GJITHÇKA

— Merva Capo —

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu të vetëm, e nga ai krijoi bashkëshorten e tij...” (Nisa 1)

Atëbotë, kur Ademi pas gjumit i hapi sytë, pranë vetes e pa Havanë. Ata e filluan jetën në Xhenet dhe pastaj e vazhduan në tokë, ashtu të përmalluar...

Urtësia e krijimit ishte që ajo të jetë prehe për Ademin dhe që të riprodhojë lloji njerëzor.

Një transmetim Profetik na tregon për krijimin e gruas: *“Kujdesuni mirë për gratë, sepse gruaja është krijuar nga briri i lakuar dhe pjesa më e lakuar e bririt është fundi i sipërm. Nëse insiston ta drejtosh atë, do ta thyesh dhe nëse e lë ashtu, do të mbetet i lakuar. Andaj, kujdesuni mirë për gratë”.*¹

Të tentosh ta ndryshosh gruan është e (pa) mundur të përfundojë në divorc. Cilado anë e karakteristikës së saj rëndon më shumë në peshore, nga njëra anë burri duhet të jetë falënderues dhe nga ana tjetër duhet të jetë durimtar, fundja, edhe durimtari edhe mirënjohësi përgëzohen.

Gruas iu është përcaktuar me urtësi hyjnore roli

1. Buhariu dhe Muslimi

i saj në familje, ashtu sikurse i burrit. I është dhënë të drejta dhe po aq edhe detyra. Një jetë bashkëshortore që harmonizohet me të drejta dhe detyra, atëherë nuk ka se si të mos jetë një jetë e lumtur bashkëshortore.

Një ndër cilësitë kryesore që kërkohet nga burri, është po ashtu cilësia e parë që kërkohet edhe nga gruaja, pra devotshmëria. Gruaja më e mirë është “ajo që e dëgjon bashkëshortin kur ai e urdhëron, e gëzon kur e shikon, ia ruan nderin dhe pasurinë”.² Kurse një burrë i devotshëm, nëse e do gruan, sillet me mirësi ndaj saj, por edhe nëse ndodh për ndonjë shkak ta urrejë assesi nuk i bën padrejtësi.

Martesa si qëllimin kryesor e ka ardhjen e gjeneratës së artë. Ajo gjeneratë, e cila, do të dëshmojë me fjalë dhe vepra njëshmërinë e Allahut. Ajo gjeneratë, e cila do të fitojë kënaqësinë e prindërve. Ajo gjeneratë, e cila një ditë i dashuri ynë Muhamedi (alejhi selam) do të krenohet me umetin e tij.

Aty ku gjithçka filloi, shpresojmë të përfundoj po aty, pra në Xhenet.

2. Hadith Profetik, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibën Maxhe, Ahmedi, saktëson shejh Albani.

Edukata

është shpirti i njeriut në trupin e tij

— Filiz Konxha —

Të gjitha virtytet e larta quhen edukatë. Njeri me edukatë është ai njeri që i ka mbledhur te vetja e tij të gjitha cilësitë e mira. Edukata është çelësi i derës së lumturisë. Njeriu i paeducatë mbetet i privuar nga mirësia e Allahut Teala në të dyja botët. Zbatimi i sheriatit dhe përsosmëria në aspektin shpirtëror arrihen vetëm me edukatë. Edukata i hap njeriut rrugën e besimit dhe udhëzimit.

Mevlana Xhelaleddin Rumi thotë:

“I nderuar! Dije se edukata është shpirti i njeriut në trupin e tij.

I nderuar! Edukata është syri dhe zemra e njerëzve të përkushtuar ndaj Allahut.

Njeriu nuk është nga bota e poshtër, por nga bota sublime. Domethënë, kuptoje këtë. Edhe bukuria e rrotullimit të kësaj bote që rrotullohet është prej edukatës.

Nëse dëshiron t’ia shtypësh kokën shejtanit, hapi sytë dhe shiko se vrasësi i shejtanit është edukata.”

Edukata e përsos njeriun. Ai që shfaq nderim dhe respekt ndaj Allahut (xh.xh.), e merr edhe shpërblimin për këtë. Ai që vepron sipas edukatës, do të shpërblehet. Edukata është një miraxh që e shpie njeriun te Allahu (xh.sh.).

Xhelaleddin Rumi (r.a.), thotë:

“Le t’i kërkojmë Zotit që të na japë edukatë, sepse ai që e ka të mangët edukatën nuk e meriton mirësinë e Allahut. Ligësia e të paeducatit nuk prek vetëm atë. Ndoshta shkakton rrëmujë në të gjithë botën dhe i vë zjarrin asaj.

Prej qiellit zbriste sofa pa pasur nevojë për t’u lodhur dhe për të bërë allishverish. Por disa të paeducatë nga populli i Musait (a.s.), kërkuan qepë dhe hudhra. Për shkak të kësaj, buka dhe sofa nuk zbriti më nga qielli. Kështu që atyre u

mbeti lodhja dhe përpjekja për të mbjellë e për të korrë.

Kur Isai (a.s.), iu lut Zotit, mirësia dhe bujaria e Allahut (xh.xh.), zbriti mbi të. Ai iu përgjërua Zotit duke u shprehur: “O Zot! Na zbrit një sofër nga qielli!” Menjëherë sofa iu dërgua nga qielli. Ndërsa të poshtrit shfaqën mungesë edukate dhe kërkuan edhe mbetjet e sofrës.

Isai (a.s.), u tha atyre: “Kjo është sofa e bujarisë. Ajo do të zbresë gjithmonë si mirësi e Zotit.” Paragjykimi dhe lakmia kundrejt saj janë mosmirënjohje ndaj mirësisë së Atij që e jep rrëskun.

Për shkak të përçarjes që shkaktuan këta njerëz të verbuar nga lakmia dhe me karakter prej lypësi, u mbyll dera e mirësisë.

Mosdhënia e zekatit u bë shkak për ndaljen e shiut. Për shkak të imoralitetit, u përhap sëmundja e murtajes.

Andaj, vuajtjet dhe fatkeqësitë vijnë vetëm prej teje. Pra, prej veprave të liga të tuat.

Ai që nuk ka frikë nga Zoti (xh.xh.), ua pret rrugën edhe të tjerëve. Kushdo që bëhet mendjemadh në këtë rrugë, do të mbytet në luginën e pishmanllëkut.

Dije se për shkak të edukatës së gjithësisë edhe engjëjt fytyrë ndritur janë të dëlirë dhe të pastër.

Largimi i shejtanit nga dera (mëshira) e Zotit ndodhi për shkak të ligësisë së tij.”

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), thotë:

“*Mua më ka edukuar Zoti. Sa edukatë të bukur që më ka dhënë!*”

Ruga e miqve të Zotit është përjetimi i edukatës së të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), pra, përjetimi i moralit të lartë të tij.

Mevlana thotë:



**EDUKATA E PËRSOS NJERIUN. AI QË SHFAQ NDERIM
DHE RESPEKT NDAJ ALLAHUT (XH.XH.), E MERR EDHE SHPËRBLIMIN PËR KËTË.
AI QË VEPRON SIPAS EDUKATËS, DO TË SHPËRBLEHET.
EDUKATA ËSHTË NJË MIRAXH QË E SHPIE NJERIUN TE ALLAHU (XH.SH.).**

“Edukata te njerëzit jo të devotshëm është një shtirje, sepse mirësia e Allahut i mbulon fytyrat e brendshme të tyre.

Ndërsa për njerëzit e përsosur edukata është mbrojtje e botës së brendshme dhe zemrës. Ata e dinë se çfarë ndodh në zemrat e tyre. Ndërsa ti je i dhënë pas pozitës. Andaj bëhu si dheu për njerëzit, sepse do të hapesh (gjesh prehje). Nëse e lë edukatën para njerëzve të përsosur, trupi yt shndërrohet në dru për zjarrin e epshit.”

“Ku janë të paedukatët? Ata janë shkak për shkatërrimin e njerëzve.”

“O mysliman! Nëse pyet për edukatën, dije se ajo është që ta durosh të paedukatin dhe të mos flasësh pranë tij.”

Poeti i famshëm Junus Emre thotë:

“Kërkova e kërkova në mexhlinis e njerëzve të urtë,

Ja që dija paska qenë prapa. Ndërsa përparësinë e kishte pasur vetëm edukata.”

Njeriu mund të përparojë jo me dije, por me edukatë. Edhe shejtani i mallkuar kishte shu-

më dije. Por ai kishte mësuar vetëm dije, ndërsa edukatë nuk kishte marrë aspak. Për shkak të mungesës së edukatës u përzu nga mëshira e Zotit (xh.xh.). Ai që bëhet dijetar, por nuk ka edukatë, nuk ka aspak vlerë. Njeriu mund të mos ketë dije, por nëse ka edukatë është i pranueshëm te të gjithë. Për këtë arsye, kanë thënë: “Edukata është pamja e jashtme e mendjes.”

Mevlana Xhelaleddin Rumi ka thënë:

“Nëse njeriu nuk ka edukatë, ai nuk është njeri. Dallimi ndërmjet njeriut dhe kafshës është edukata.” “Allahu e shkatërron të paedukatin.” “Hapi sytë dhe shikoje të gjithë fjalën e Allahut, pra shikoji të gjitha ajetet e Kuranit. Atëherë do të shohësh se i gjithë kuptimi i Kuranit përbëhet nga edukata.” “E pyeta mendjen se çfarë është besimi. Mendja i foli veshit të zemrës dhe i tha: Besimi është edukatë.”

Edukata është kurorë e miqve të Allahut. Për këtë arsye, kanë thënë:

“Edukata paska qenë një kurorë nga Zoti,

Vendose atë kurorë dhe mbrohu nga çdo fat-keqësi.”



“Ata thanë: ‘Mos i lini kurrsesi zotat tuaj!
Mos e lini kurrsesi as Veddin, as Suvain, as Jeguthin,
as Jaukën, as Nesrin!’” (Nuh, 23)

Megjithëse profetët kanë qenë njerëz, ata kishin pozitë të veçantë tek Allahu, ishin të zgjedhur dhe u vinte shpallja prej Tij. Statusi i tyre njerëzor dhe hyjnor, është përcaktuar qartë nga vetë shpalljet e Allahut. Për shembull, Kurani e urdhëron Profetin (a.s.), t’i njoftojë njerëzit se ai është vetëm një njeri si gjithë të tjerët.¹ Përveç kësaj, Kurani e urdhëron Profetin (a.s.), t’ua bëjë të ditur njerëzve, se thesaret e Allahut nuk gjenden në dorën e tij, se ai nuk e di të shkuarën dhe të ardhmen dhe nuk është melek.²

Në këto ajete, Profeti (a.s.), urdhërohet qartë që t’u thotë njerëzve se ai nuk zotëron cilësi të shenja, sepse arabët e kohës së injorancës, nuk besonin se një profet mund të ishte njeri normal.³ Ata dëshironin me patjetër që të shihnin tek ai cilësi të jashtëzakonshme dhe të mrekullueshme.

Në fakt, nëse studiohet historia e feve, do të shihet se në imagjinatën e njerëzve, një prijësi fetar i atribuohet gjithmonë cilësi të jashtëzakonshme. Po ashtu, shihet se në këtë pikë, njeriu i kalon kufijtë dhe u atribuon atyre disa cilësi hyjnore. Dhe pikërisht kjo gjendje është edhe një nga shkaqet më të rëndësishme të shfaqjes së shirkut. Shembulli më i spikatur i këtij fenomeni në aspektin e historisë së profetëve, është Isai (a.s.).

Ai ishte një prej profetëve të mëdhenj dhe natyrisht që ishte dërguar që në radhë të parë t’u predikonte njerëzve teuhidin. Por për fat të keq, pas vdekjes së tij, për shkak të ndodhive që u zhvilluan, ai u shndërrua në një figurë të shenjtë i cili besohet se është biri i Zotit. Madje, ata që i besojnë kësaj feje, shkojnë aq larg sa pretendojnë se Isai (a.s.), është Vetë Zoti.

Ky devijim, nuk është vetëm në lidhje me profetët, por vlen edhe për të mëdhenjtë e fesë siç janë shenjtorët, evliatë, njerëzit e mirë etj. Disa prej tyre

u konsideruan se kishin cilësi mbinjerëzore kur ishin ende në jetë, e disa të tjerë pas vdekjes. Njerëzit u luteshin, u kërkonin ndihmë dhe i merrnin si ndër-mjetës të Allahut.

Gjatë gjithë historisë, gjithmonë ka pasur njerëz të cilët kanë ecur në vijën e drejtë të teuhidit, kanë qenë të devotshëm dhe njerëz të mirë, të cilët ndiqeshin nga njerëz të shumtë. Por për fat të keq, ka pasur edhe prej atyre të cilëve u janë atribuar cilësi mbinjerëzore, duke u shenjtëruar nga ana e ndjekësve të tyre të devotshëm. Kurani bën fjalë për idhujt Vedd, Suva, Jeguth, Jauk dhe Nesr.⁴ Shpjegimet në lidhje me këtë ajet në librat e tefsirëve, janë shumë të rëndësishme për të treguar se si me kalimin e kohës njerëzit e mirë janë shndërruar në idhuj.

Emrat e idhujve që përmenden në ajet, janë emrat e disa njerëzve të mirë që kanë jetuar më parë. Pas vdekjes së këtyre njerëzve, admiruesit e tyre kanë ngritur statuja në shenjë nderi dhe respekti ndaj tyre. Por për fat të keq, me kalimin e një kohe të gjatë, qëllimi i vërtetë i ndërtimit të këtyre statujave u harrua dhe ata filluan të shihen si zota të shenjtë. Po ashtu, Kurani na bën të ditur se edhe hebrenjtë dhe të krishterët i kanë idhujtarizuar të mëdhenjtë e feve të tyre, gjë e cila në fakt përbën një devijim shumë serioz. Ky nuk është vetëm një evidentim, por në të njëjtën kohë, është bërë edhe një paralajmërim i rëndësishëm për ne si përfaqësuesit e fundit të teuhidit/monoteizmit të vërtetë mbi tokë.

Shfaqja e një respekti të tepruar ndaj njerëzve dhe madhërimiti i tyre, është një nga llojet e shirkut. Për rrjedhojë, edhe Profeti (a.s.), nuk e ka aprovuar respektin e tepruar ndaj njeriut, përfshi edhe ndaj vetë atij dhe, lidhur me këtë na ka paralajmëruar: “Mos më lavdëroni në mënyrë të tepruar ashtu siç e lavdërojnë të krishterët Isain birin e Merjemes! Unë jam vetëm rob i Zotit. Prandaj thoni, “Robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij”” (Buhari, Enbija, 48.)

1. shih. Kehf, 110; Fussilet, 6.

2. shih. En’am, 50.

3. shih. Furkan, 7.

4. shih. Nuh, 23.



Ky veprim i Profetit (a.s.), na jep këto kritere: Asnjë njeri nuk është në nivelin e profetëve dhe, përderisa as profetëve nuk mund t'u jepet një status i mbinatyreshëm, atëherë duhet qëndruar larg edhe shenjtërimit të njerëzve të tjerë. Për rrjedhojë, respekti dhe madhërimi që tregohet ndaj Allahut, nuk mund të tregohet për asnjë krijesë tjetër. Lidhur me këtë çështje, ne duhet t'i mbajmë nën kontroll të gjitha mendimet, ndjenjat dhe sjelljet tona. Ashtu siç sillemi me maturi ndaj atyre që jetojnë, ashtu duhet të sillemi edhe ndaj atyre që kanë vdekur. Varret e tyre duhet t'i vizitojmë për të kujtuar vdekjen dhe për të marrë shembull prej jetës së tyre shembullore. Por asnjëherë nuk duhet t'i lutemi atyre duke prituri ndonjë dobi prej tyre, apo duke i bërë ata ndërmjetës të Allahut. Kjo, sepse ne adhurojmë vetëm Allahun dhe vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë. Gjithashtu, duhet theksuar se mendimet e tilla si, "filan elvi ja i di veprat e njerëzve", nuk përputhen aspak me besimin e teuhidit. Ky besim i gabuar, me vetëdije apo pa vetëdije, nënkupton se përveç Allahut ka edhe të tjerë që dinë të fshehtat. Për fat të keq, këto lloj besimesh, pranohen si normale në disa rrethe të caktuara. Por në fakt, ky është një devijim shumë serioz, sepse të fshehtën/gajbin e di vetëm Allahu i Madhëruar. Dija, shikimi dhe dëgjimi i Tij, janë të pakufishëm. Për këtë arsye, besimtarët e dinë mirë se ata ndodhen vetëm nën kontrollin e Tij. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik, urdhërohet: **"...Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni!"** (Hadid, 4)

Përveç këtyre, myslimanët besojnë se vetëm profetët janë të mbrojtur nga gjynahet. Për rrjedhojë, një person mund të jetë shumë i devotshëm dhe i virtytshëm. Njerëzit mund të përfitojnë prej moralit të tij të lartë dhe personalitetit të tij shembullor. Por

të gjitha këto virtyte nuk nënkuptojnë se ai është i ruajtur prej gabimeve dhe gjynaheve. Një besimtar mysliman nuk duhet të veprojë kurrë në mënyrë të atillë, që të tregojë respekt të tepruar ndaj ndokujt apo diçkaje. Ai nuk e konsideron të ruajtur prej gabimeve një person për shkak të mendimeve dhe virtyteve të tij të larta, sepse e di mirë se edhe nëse një person është shumë i devotshëm, ai mund të bëjë gjynahe dhe mund të gabojë në zgjedhje dhe mendime. Për rrjedhojë, myslimani nuk duhet të kërkojë asnjë urtësi pas mendimeve dhe sjelljeve të një personi të tillë.

Gjithashtu, ky person nuk konsiderohet si dikush që nuk mund të kundërshtohet dhe t'i vihen në diskutim mendimet dhe sjelljet. Përndryshe, kjo do të thotë që njeriu të mohojë veten e tij. Nga ana tjetër, përveç sahabëve që janë përgëzuar me Xhenet, askujt nuk i është garantuar shpëtimi i përjetshëm. Mbi të gjitha, a nuk është vetëm Allahu Ai që i njeh robërit e Tij në mënyrën më të përsosur!? Për këtë arsye, besimtari nuk dyshon aspak në këtë të vërtetë.

Nëse besimtari është i sigurt për virtytet e larta të një personi, ai mund të mendojë se ky person mund të jetë prej të dashurve të Allahut. Madje ai ushqen mendime të mira në lidhje me të dhe përpiqet të përfitojë prej jetës së tij shembullore. Por ai kursesi nuk mund t'i aprovojë besimet e gabuara që pretendojnë se Zoti është mishëruar apo është shfaqur tek dikush që pranohet si njeri i mirë. Gjithashtu, besimtari i konsideron si të gabuara edhe besimet që i atribuojnë dikujt cilësi mbinatyrore, saqë po ta thërrasë dikush në ndihmë ai i shkon menjëherë në ndihmë kudo që të ndodhet. Sepse kjo nuk përputhet aspak me besimin në parimin e teuhidit të cilin e përsëritim në çdo rekat të namazit kur themi: **"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!"**



Profeti (a.s.), ka thënë:

“Padyshim se shejtani shëtit
si gjaku në trupin e njeriut!”

(Muslim, Selam, 24)

Ishin ditët e fundit të Ramazanit të Bekuar. Si për çdo vit, i Dërguari i Allahut (a.s.), kishte hyrë në itikaf në xhami dhe i ishte përkushtuar edhe më tepër adhurimit. Një natë i erdhi për vizitë gruaja e tij Safijja (r.anha). Pasi biseduan për një farë kohe, nëna jonë Safijja (r.anha), u ngrit për t’u kthyer në shtëpinë e saj në lagjen e Usame bin Zejdit. Profeti (a.s.) u ngrit bashkë me të për ta përcjellë. Kur arritën tek dera e xhamisë, dy persona që kaluan aty pranë, dhanë selam dhe i shpejtuan hapat e tyre. Mbase kanë menduar që të mos e shqetësojnë Profetin (a.s.), ndërkohë që ishte bashkë me gruan e tij. Mirëpo, i Dërguari i Allahut (a.s.), ndjeu një farë sikleti prej kësaj dhe pasi i thirri dy personat pranë vetes, bëri një shpjegim që ata nuk e prisnin: “*Kjo grua pranë meje, është Safijje binti Hujej (pra është gruaja ime, nuk është e huaj).*”

Të dy personat u habitën jashtë mase dhe thanë me një gojë, “subhanallah, si mund të mendojmë ndryshe për ju o i Dërguar i Allahut!?” Me këtë, ata deshën të tregonin se Profeti (a.s.), nuk kishte pse të bënte një shpjegim të tillë, e mbase edhe u fyen disi. Mirëpo, ky Profet i mëshirshëm, të cilin Allahu e ka lavdëruar për kujdesin e madh që tregon ndaj umetit të vet, dëshironte të pengonte shejtanin që të dëmtonte besimin e tyre me vesveset dhe dyshimet që mund t’u hidhte. Për këtë arsye ai ua shpjegoi këtë veprim me këto fjalë: “*Padyshim se shejtani shëtit si gjaku në trupin e njeriut. Unë u shqetësova se mos shejtani hedh ndonjë dyshim të keq në zemrat tuaja!*” (Muslim, Selam, 24; Buhari, Fardu’l-humus, 4.)

Profeti ynë (a.s.), i cili i është ofruar njerëzimit si shembulli më i bukur i një robi të zgjedhur prej Allahut të Madhëruar, nuk u mbështet as në pozitën e lartë që ka tek Ai dhe as në konsideratën e pashoqe që gëzonte midis sahabëve, të cilët qëndronin përreth tij duke i thënë “të qofshin falë nëna dhe babai ynë!”.

Por edhe pse ishte pajisur me virtytet më të bukura, ai u përpoq t’u tregonte dy sahabëve se nuk po bënte asnjë punë të gabuar. Ky veprim dhe shpjegimi që i bëri ai këtij veprimi, tregon se sa e rëndësishme është kjo çështje.

Në këtë hadith, ku marrëdhënia e shejtanit me njeriun shprehet me fjalët e çuditshme, “*Padyshim se shejtani shëtit si gjaku në trupin e njeriut.*”, tërhiqet vëmendja në faktin se duhet pasur një kujdes i madh ndaj shejtanit, sepse ai vepron në mënyrë tinëzare. Ashtu si gjaku që shëtit gjithë trupin nga koka deri tek këmbët dhe rrjedh në heshtje dhe në mënyrë të vazhdueshme, ashtu edhe shejtani e rrethon njeriun me njëmijenjë hile dhe vesvese, duke e ftuar atë vazhdimisht në të keqe. Kjo, sepse ditën kur ai u mposht nga mendjemadhësia e vet dhe kundërshtoi Allahun e Madhëruar, me ç’rast edhe u dëbua prej pozitës së lartë pranë Tij, u bë armik i hapur i njeriut, të cilin e konsideroi si shkaktarin e mallkimit të vet. Për rrjedhojë, ai u betua se do të përdorte të gjitha mënyrat për ta bërë njeriun të qëndrojë larg mëshirës hyjnore:

“...Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë e do t’u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës!” (A’raf, 16-17)

Nisur nga kjo, shejtani i cili e fton njeriun në gjynahe duke iu qasur në mënyra të ndryshme, përpiket me të gjitha forcat që ta bëjë atë të shkelë kufijtë që ka vendosur Zoti i tij. Ndihmësit më të mëdhenj të tij, janë dëshirat e egos dhe dobësitë e njeriut, sepse në një trup ku egoja egërsohet, dobësitë shtohen dhe ai nuk e dëgjon dot zërin e ndërgjegjes dhe të mendjes, nxitjet e tij nuk vonojnë shumë të kthehen në veprim. Për këtë arsye, nga një anë shejtani e nxit

njeriun të zhytet në dëshirat e kësaj bote si epshi, ngrënia, pirja, etj., ndërsa nga ana tjetër e pengon atë të ndaj mirësitë me të tjerët, të bëjë bamirësi dhe të dhurojë, duke e frikësuar me uri dhe varfëri. Nga një anë ia forcon egon duke e nxitur për mendjemadhësi dhe krenari, ndërsa nga ana tjetër e shtyn atë të mendojë dhe të sillet negativisht ndaj të tjerëve. Ai thotë gjithmonë se thotë të vërtetën dhe ia zbukuron njeriut çdo të keqe që bën.¹ Dhe për më shumë, ai e mashtron njeriun me premtime boshe.² Në këtë mënyrë, ai përpiket që njeriu të shndërrohet në një qenie egoiste, të dhënë pas kësaj bote, të pangopur, koprrac dhe lakmitar nën robërinë e ndjenjave armiqësore si dëshirat e ulëta, urrejtja, zemërimi dhe smira, në vend që ai të jetë një qenie me virtyte morale si dashuria, vëllazëria, durimi, drejtësia, solidariteti, sakrifica dhe vetëmohimi.

Ai nuk kënaqet kurrë prej veprave të mira të robit, si pendimi, dhikri, adhurimet, pastrimit prej gjynaheve dhe afrimit ndaj Zotit. Për këtë arsye, ashtu siç përpiket ta largojë atë prej veprave të mira, ai e shtyn njeriun të tregojë edhe përtaci në detyrat e tij ndaj Zotit të vet. Ndërsa, kur njeriu fillon të kryejë adhurimet, ai ia shton vesveset që synojnë ta largojnë atë nga shpirti i vërtetë i adhurimit. Gjatë faljes së namazit, ai i kujton njeriut gjëra që më parë as që nuk i ka menduar, duke i thënë “kujto këtë, e atë!..”, me qëllim që t’i largojë përqendrimin dhe më në fund ta bëjë që të mos e dijë se sa rekate ka falur gjithsej.³

Gjurmët e shejtanit është e mundur t’i shohësh

1. shih. En’am, 43.

2. shih. Nisa, 120.

3. shih. Buhari, Ezan, 4.

në çdo ngjarje negative që është përjetuar gjatë gjithë historisë, që prej nxjerrjes së Ademit (a.s.), prej xhenetit, vrasjes së Habilit nga vëllai i tij Kabili, pretendimeve të Faraonit për Zot, e deri tek ngjarjet e fitneve midis myslimanëve. Shumë njerëz të pafajshëm që u kapluan prej nxitjeve të tij, u gremisën në gropën e gjynaheve, duke u kthyer në makina gjynahesh dhe duke kryer masakra të tmerrshme. Me pak fjalë, për shkak të farave të fitnes që mbolli ai, u shkatërruan dhe u copëtuan familjet, vendet dhe shtetet. E megjithatë, shejtani nuk ka asnjë fuqi kundra besimtarëve që strehohen tek Zoti dhe mbështeten tek Ai.⁴

Njeriu është i lirë të përdorë vullnetin e tij në të mirë, ose në të keq dhe të ndjekë ose jo shejtanin. Pikërisht për këtë arsye, kur Profeti (a.s.), thotë se shejtani shëtit si gjaku në trupin e njeriut, dëshiron që para së gjithash, të na bëjë të vetëdijshëm se vesveset e shejtanit kundër njeriut janë të pafundme. Kjo vetëdije, do ta bëjë njeriun të jetë i kujdesshëm në fjalë dhe në sjelljet e tij, me qëllim që të mos i japë mundësi nxitjeve të shejtanit, njësoj siç veproi edhe Profeti (a.s.). Në të njëjtën kohë, kjo vetëdije do të parandalojë sjelljen e nxituar në dhënien e gjykimeve ndaj të tjerëve dhe, duke menduar rolin e shejtanit në të këqijat që të bëhen, në vend që të ushqesh urrejtje, do të bëhet më e lehtë t’i falësh njerëzit. Padyshim se njeriu që e fiton këtë vetëdije, duhet të ketë një vullnet të fortë dhe ndihmën hyjnore që të mos e ndjekë shejtanin në rrugën që ai i ofron. Lidhur me këtë, Zoti ynë i Madhëruar na udhëzon: **“Nëse shejtani fillon të të joshë, kërko mbështetje te Allahu!..”** (Fussilet, 36)

4. Nahl, 99.



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- P J E S A X V I I -

LLOGARIA E KAFSHËVE

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka bërë të ditur se edhe kafshët do t'i nënshtrohen llogaridhënies në Ahiret:

“Patjetër që ditën e Kiametit, do t’u jepni të drejtat (që u keni marrë) të zotëve të tyre! Madje, edhe për delet pa brirë¹, do të merret haku prej deleve me brirë që e kanë dëmtuar.” (Muslim, Birr, 60; Tirmidhi, 2/2420.)

Një ditë, pranë të Dërguarit të Allahut, (a.s.), po kullotnin dy dele. Në një moment, njëra prej deleve i ra me brirë tjetrës, duke u bërë shkas që ajo të dështojë qengjin që kishte në bark. Profeti ynë (a.s.), që e dëshmoi këtë ngjarje, buzëqeshi. Kur e pyetën:

“Përse buzëqeshët o i Dërguar i Allahut?”, ai u përgjigj:

“U habita me gjendjen e këtyre kafshëve! Beto-hem në Atë, në dorën e të Cilit gjendet jeta ime, se ditën e Kiametit do të merret hak për këtë ngjarje, duke marrë shpagim prej deles tjetër!” (Ahmed, V, 172.)

Këto deklarata të Profeti tonë (a.s.), tregojnë se veprat do të peshohen vërtet, dhe përbëjnë një këshillë shembullore për ne. Pra, fakti se askujt nuk do t'i mbetet e drejtë pa u marrë, madje se edhe padrejtësitë që ndodhin midis kafshëve do të gjykohen pa asnjë mangësi, na shtyn të mendojmë e të imagjinojmë se sa serioze do të jetë llogaridhënia që na pret.

Ne duhet të nxjerrim mësim prej lajmeve që na kanë ardhur dhe të ruhemi, me aq sa të kemi mundësi, prej shkeljes së të drejtave të robërve dhe të kafshëve. Përveç kësaj, ne duhet t'i shohim krijesat me syrin mëshirues të Krijuesit, duke iu afruar atyre me butësi, mëshirë dhe dashuri të madhe.

Nuk duhet të harrojmë se të gjitha krijesat janë krijuar për t'i shërbyer njeriut, por edhe si mësim për të. Ato ia janë lënë po atij nën kujdes. Prandaj, mëshira dhe ruajtja e të drejtave të tyre, është detyrë morale për njeriun. Ndërsa padrejtësia ndaj kafshëve është një gjynah me të cilin do të përballemi në botën tjetër.

Njëherë, nëna jonë Aisha (r.a.), kishte hipur në një deve pak të egër. Për ta qetësuar devenë, ajo filloi ta lëvizte me forcë para-mbrapa. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha Aishas (r.anha):

“Sillu butë me kafshën, sepse butësia zbukuron, kudo që të gjendet. Një sjellje pa butësi, është e shëmtuar.” (Muslim, Birr, 789, 79.)

Osmanët kanë shfaqur shembuj të shumtë të butësisë ndaj krijesave dhe të respektimit të të drejtave të tyre, prej të cilëve ne duhet të marrim mësim. Për shembull, të parët tanë e kishin ndaluar ngarkimin e tepërt të kafshës. Madje, disa zabitë janë ngarkuar me detyrën e ndjekjes së atyre që e shkelnin këtë ligj, me qëllim që t'i çlodhnin kafshët dhe të gjobitnin pronarët e tyre, duke i bërë të bartin të njëjtën ngarkesë, si dënim për ta.

Fakti që sulltan Sulejman Kanuni- Ligjvënësi, gjatë ndërtimit të xhamisë Sulejmanije, pati nxjerrë një sërë fermanësh/dekretesh mbi kafshët e transportit, është një tregues i kësaj ndjeshmërie! Në kuadër të këtyre dekreteve, është respektuar edhe koha e pushimit dhe kullotjes në lëndina të kuajve, gomarëve dhe mushkave që përdoren për punë, duke treguar kështu përpjekje të jashtëzakonshme në mos shkeljen e të drejtave të krijesave. Fakti që Sulltan Sulejman Kanuni ka treguar një kujdes kaq të madh në ruajtjen e të drejtave të robërve dhe të kafshëve, mbase përbën edhe një prej motiveve kryesore të pozitës së jashtëzakonshme shpirtërore që ka xhamia e famshme Sulejmanije.

Një ditë, sulltan Sulejman Kanuni, me anë të një

1. Këtu aludohet ose në llojin e bagëtisë (si dele, dhi, etj.), ose në racën e veçantë të llojit të deleve me brirë.



dyvargëshi poetik, i kërkoi fetva (vendim juridiko-fetar) Shejhu'l-Islamit Ebu's-Suud Efendit, për të vrarë milingonat që po i thanin drurët e dardhave në kopshtin e pallatit:

Nëse milingonat, pemët frutore dëmtojnë,

A ka ndonjë të keqe nëse ato i shfarojmë?

Kësaj kërkese të padishahut, edhe Shejhu'l-Islamit Ebussuud Efendiu i dha përgjigje poetike me një dyvargësh të tillë:

Nesër para Zotit në gjyq kur të dalë,

Milingonat, nga Sulejmani hakun kanë për të marrë!

Lidhur me ajetin, *“Dhe kur egërsirat të tubohen.”*², Ibn-i Abbas (r.a.), ka thënë:

“Çdo gjë do të ringjallet dhe do të mblidhen në sheshin e Mahsherit. Madje, edhe mizat!” (Ibn-i Kethir, Tefsir, et-Tekuir, 5.)

Pasi të mblidhen të gjitha krijesat në sheshin e Mahsherit, do të fillojë edhe llogaridhënia. Mirëpo, çështjet gjyqësore midis kafshëve do të zgjidhen para atyre të njerëzve. Në fund të këtij gjyqi, të gjitha kafshët do të kthehen përsëri në dhé. Lidhur me këtë, në Kuran urdhërohet:

“Të gjitha kafshët në Tokë e të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju. Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë. Pastaj të gjithë do të tubohen para Zotit të tyre.” (En'am, 38.)

Po ashtu, lidhur me këtë ajet fisnik, Ebu Hurejre (r.a.) shprehet:

“Ditën e Kiametit, të gjitha krijesat do të mblidhen në sheshin e Mahsherit kafshët, insektet, zogjtë dhe çdo gjë tjetër. Aty do të sundojë plo-

tësisht drejtësia e Allahut të Madhëruar. Madje, edhe e drejta e deles pa brirë, do të merret prej deles me brirë që e ka dëmtuar. Më pas, Allahu i Madhëruar do t'i urdhërojë kafshët: **«Bëhuni dhé!»** Pikërisht atëherë, mohuesit që do e shohin këtë, (nga frika e llogaridhënies) do të thonë: **«Ah, sikur të bëhesha dhé (si kafshët)!»** (Hakim, Mustedrek, II, 345/3231. Shih. Hakim, IV, 619/8716.)

Padyshim, ky përshkrim tregon qartë nivelin që do të arrijnë atë ditë, ndjenjat e pendesës, turpit dhe frikës!

Fakti që edhe për kafshët do të vendoset drejtësi në mënyrë të hollësishme, duhet ta ftojë njeriun në një nivel të lartë meditimi!

Një prej Shejhu'l-Islamëve, Osman Kadizade, shprehet:

“Nëse njeriu nuk ka siguruar hallallekun³ në këtë botë, nga të dëmtuarit e ndonjë padrejtësie të tij, në botën tjetër ata do t'ia kërkojnë të drejtën e tyre. Mbi të gjitha, nëse ai të cilit i është bërë padrejtësi është mohues ose kafshë, çështja vështirësohet, sepse mohuesit dhe kafshës nuk mund t'i japen sevape prej të besimtarit...”⁴

LLOGARIDHËNIA E NJERËZVE

Në Mahsher, momenti më i frikshëm për njeriun, është ai kur do të japë llogari për të gjitha veprat që ka kryer, në këtë botë të përkohshme që është edhe vendi i sprovave. Ky bilanc do të përcaktojë njëherë e përgjithmonë drejtimin e jetës së tij. Për këtë arsye, në momentin e llogaridhënies, njeriut i shtohet në maksimum frika dhe shqetësimi.

Një person shkoi tek Aliu (r.a.) dhe e pyeti:

“Të gjitha kafshët në Tokë e të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju. Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë. Pastaj të gjithë do të tubohen para Zotit të tyre.”

(En'am, 38.)

2. Tekuir, 5.

3. Të shprehësh keqardhje dhe kërkosh falje për të keqen që ke bërë.

4. shih. Birgivi Vasiyetnamesi Kadizade erhi, s. 128.

“Si do të pyeten përnjëherësh të gjithë ata që do të jenë në Mahsher?”

Aliu (r.a.) i dha këtë përgjigje shumë të urtë:

“Ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar do t’i pyesë të gjithë përnjëherë, ashtu siç i furnizon (në këtë botë) të gjithë përnjëherë!”⁵

Sipas një transmetimi, llogaritë e përbashkëta do të bëhen para llogarive personale. Pra, në Mahsher njerëzit do të thirren: “O ju që keni bërë këto gjynahe!”, dhe ata menjëherë do të ngrihen në këmbë dhe do të poshtërohen në sytë e të gjithë njerëzve në Mahsher.

Nisur nga kjo, asketi i njohur prej tabiinëve, Ebu Hazm el-A’raxh, bënte shpesh vetllogari me këto fjalë:

“O Ebu Hazm! Ditën e Kiametit do të thirret:

«O ju që keni bërë këtë gjynah!» dhe ti do të ngrihesh së bashku me ata që e kanë vepruar atë gjynah! Më pas do të thirret për një gjynah tjetër, e ti përsëri do të ngrihesh! O A’raxh, mesa duket ti dëshiron të ngrihesh vazhdimisht me gjynahqarët!” (Ebu Nuajm, Hilje, III, 230; Imam Sharani, “Vdekja, Kiameti, Ahireti”, fq. 152-153.)

Pasi të mbarojnë llogaridhëniet e përbashkëta, njerëzit do të merren në llogari një nga një.

Ibni Ebu Mulejke (r.a.) tregon:

Kur Aisha (r.a.), bashkëshortja e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dëgjonte diçka që nuk e kuptonte si duhet, hetonte mbi çështjen derisa të ishte krejt e qartë. Një ditë, Profeti (a.s.) kishte thënë: “Kush llogaritet në mënyrë të hollësishme (në Ditën e Gjykimit), ai ndëshkohet!”

Aisha (r.a.) e kishte pyetur:

“O i Dërguar i Allahut! A nuk thotë Allahu i Madhëruar (në Kuran) : «**Ai, të cilit do t’i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë**»?»⁶

Profeti (a.s.) ishte përgjigjur:

“Në të vërtetë, ajo (për të cilën bëhet fjalë në ajet) është “ard”. Mirëpo, kush llogaritet në më-

nyrë të hollësishme, do të shkatërrohet.” (Buhari, IIm, 36, Rikak, 49; Muslim, Xhennet, 79, 80; Ebu Daud, Xhenaiz, 1/3093.)

Fjala “ard” që përdoret në hadith, shpreh paraqitjen e njerëzve tek Mizani/Peshorja për peshimin e veprave, ose paraqitjen e veprave tek të zotët e tyre. Në Kuranin Fisnik tregohet se për njerëzit e devotshëm, që quhen “As’hab-i Jemin”, llogaria ditën e “ard”-it do të kalojë shumë lehtë.⁷ As’hab-i Jemin, pra ata të cilëve do t’u jepet libri nga e djathta, do të përgëzohen me falje, dhe kur t’u paraqiten veprat e tyre, bashkë me gabimet do të shohin edhe mirësitë që do t’i gëzojnë. Për këtë arsye, ata nuk do të vuajnë shumë gjatë llogaridhënies. Ndërsa llogaridhënia e atyre që nuk do të përgëzohen me falje, do të jetë shumë e vështirë. Gjatë llogaridhënies, personi do të shohë

se shumë vepra që i pandehte të mira, nuk do t’i pranohen, gjë e cila do ta bëjë të vuajë atë njeri.

Ka shumë vepra që pandehen si mirësi, por për shkak se janë bërë me para të pista (haram), ose janë përzier me qëllime jo të pastra, siç është dukja, nuk do të pranohen tek Allahu i Madhëruar. Këto lloj veprash, në Ahiret do të jenë një zhgënjim i madh për të zotin, i cili shpreson të marrë shpërblimin e tyre, dhe do jenë burim i thellë pendimi.

Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Kanë punuar e janë rras-kapitur (po më kot). Ata do të

digjen në zjarr të nxehtë!” (Gashiye, 3-4.)

“Thuaj: «A doni t’ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?»” (Kehf, 103-104.)

Për shembull, një person financon ndërtimin e një xhamie, të një kursi Kurani, apo ndonjë fondacion bamirësie, dhe vendos emrin e tij në to, me qëllim që të tregojë famën e vet. Ky veprim nuk konsiderohet aspak i drejtë, për shkak se i hap derën dukjes, mendjemadhësisë dhe mburrjes; dhe dëshira për vëmendje, -siç shprehet edhe Pro-



5. shih. Birgivi Vasiyetnamesi Kadzade erhi, s. 126.

6. Inshikak,7-8.

7. shih. Uakia, 27-40, 90-91; Muddethir, 39-40.

feti ynë (a.s.)-, “është një shirk i vogël”⁸. Mirëpo, besimi monoteist nuk e toleron aspak ortakërinë/shirkun (në adhurim). Megjithatë, pas vdekjes së bamirësit (që ka financuar vepra të tilla), është e lejuar vendosja e emrit të tij në ato vepra, me qëllim të kujtimit të tij me lutje.

DËSHMITARË TË FORTË

Gjatë llogaridhënies në Ahiret, robi do të ketë pranë edhe dëshmitarë, sepse mohuesit dhe njerëzit e këqij, ashtu si në jetën e dynjasë, do të vazhdojnë mohimin dhe kundërshtimet e tyre edhe gjatë llogaridhënies. Atëherë, Allahu i Madhëruar do t’ua vulosë gojët dhe do të urdhërojë që të flasin gojët e tjera. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë.” (Nur, 24.)

“Sot Ne do t’ua vulosim atyre gojët e do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë.” (JaSin, 65.)

“Kur të vijë afër zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë.” (Fussilet, 20.)

“Ata do t’u thonë lëkurëve të veta:

«Pse dëshmuat kundër nesh?» E ato do të përgjigjen:

«Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni.» (Fussilet, 21.)⁹

Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), lidhur me këtë çështje ka thënë:

“...Ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar do t’i thotë robit të vet:

«A nuk mendove fare se do të takohesh me mua?» Robi do të përgjigjet:

«O Zoti im, unë të kam besuar Ty, librave të Tu dhe të dërguarve të Tu. Kam falur namaz, kam agjëruar dhe kam dhënë lëmoshë!» Më pas do ta lavdërojë Allahun e Madhëruar aq sa ka mundësi. Allahu xhel-le xhelaluhu do t’i thotë:

«Prit atëherë! Tani do të vijë një dëshmitar kundër teje!»

Robi do të mendojë me vete:

«Kush do të jetë ai që do të dëshmojë kundër meje?» Ndërkaq, robit i vuloset goja. Pastaj, këm-

bëve, mishit dhe kockave të tij do t’u thuhet:

«Hajde, flisni!»

Këmbët, mishi dhe kockat e tij do të flasin dhe do të tregojnë gjithçka që ka bërë ai. Ky person është një munafik (hipokrit), dhe do të vuajë zemërimin e Allahut.” (Muslim, Zuhd, 16)

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet:

“Robi thotë:

«O Zoti im! A nuk më ruajte Ti nga padrejtësia?» Allahu i Madhëruar i përgjigjet:

«Po të ruajta!» Për këtë arsye robi thotë:

«Sot, unë nuk dua që dikush tjetër të dëshmojë për mua përveç vetes time!» Allahu i Madhëruar thotë:

«Sot, ty të mjafton vetja si dëshmitar i vetëm dhe Kiramen Katibin¹⁰ si dëshmitarë të shumtë!»

Pastaj atij i vuloset goja dhe organeve të tjera u thuhet:

«Flisni!»

Atëherë, ata tregojnë për veprat e personit. Pastaj atij i jepet leje të flasë dhe ai u drejtohet organeve të veta:

«Turp të keni! Zhdukuni që këtu! Unë për ju po përpiqem!» (Muslim, Zuhd, 17.)

Po ashtu, Allahu i Madhëruar na bën të ditur në Kuranin Fisnik se si dëshmitare do të thirret edhe toka mbi të cilën ka jetuar personi:

“Atë Ditë ajo (toka) do të tregojë lajmet e saj, sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë.” (Zelzele, 4-5.)

Njëherë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), këndoi këtë ajete fisnik dhe i tha sahabëve:

“A e dini se cilat janë lajmet që do të tregojë toka?” Ata thanë:

“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!” Më pas, Profeti (a.s.) sqaroi:

“Lajmet e saj janë dëshmia për veprat që ka bërë mbi tokë çdo rob, femër apo mashkull qoftë, duke thënë: «Në këtë ditë dhe në këtë kohë ke vepruar këtë gjë!». Ja, këto janë lajmet e tokës.” (Tirmidhi, Kiamet, 7/2429; Tefsir, 99/3353; Ahmed, II, 374; Hakim, II, 281/3012.)

Po ashtu, në një hadith tjetër thuhet:

“Ruhuni prej tokës, sepse ajo është nëna juaj! Ajo është vendi në të cilën jetojmë dhe tek e cila do të kthehemi në fund. Ajo do të tregojë për të gjitha veprat e mira apo të këqija që bëhen mbi të!” (Hejthemi, I, 241.)

8. shih. Ahmed, V, 428, 429.

9. Për hadithet lidhur me këtë çështje, shih: Buhari, Tefsir, 41/1, 2, Teuhid, 41; Muslim, Sifatul-Munafikin, 5; Tirmidhi, Tefsir, 41/3248.

10. Kiramen Katibin: Melekët që shkruajnë veprat e njeriut.

Atë ditë, njeriu do të pyes i shastisur: “Çfarë ka kjo tokë!? Si mund të tregojë gjithçka që ka ndodhur?!” e më pas do të ngrihet i tmerruar.

Atë ditë do të ketë dëshmitarë prej melekeve dhe njerëzve. Mirëpo, dëshmitari më i madh, padyshim që është Vetë Allahu i Madhëruar. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Secilit do t’i jepet shpërblimi për atë që ka bërë, sepse Ai e di më së miri se çfarë kanë punuar.” (Zumer, 70.)

Nëse ne arrijmë ta kuptojmë këtë të vërtetë ashtu siç duhet dhe heqim dorë nga çdo e keqe, nuk do të ketë nevojë për asnjë dëshmitar tjetër përveç Allahut të Madhëruar, i Cili është shumë i mëshirshëm me robërit e Tij.

Lidhur me këtë çështje, tregohet se njëherë një vaiz (predikues) ishte duke treguar çështjet e botës tjetër, ndërkohë që midis xhematit ndodhej edhe i nderuari Shejh Shibli.

Vaizi, duke folur për pyetjet që do të bëjë Allahu i Madhëruar në Ditën e Gjykimit, u shpreh:

“Do të pyetesh se ku e ke përdorur diturinë! Do të pyetesh se ku e ke fituar dhe ku e ke shpenzuar pasurinë! Do të pyetesh se si e ke kaluar jetën, adhurimet si i ke pasur! A ke bërë kujdes ndaj haramit dhe hallallit?.. Pas këtyre, do të pyetesh për këto e ato gjera!..”, dhe numëroi edhe disa gjëra të tjera të rëndësishme.

Shejh Shibli, i cili po dëgjonte me vëmendje, me një zë të butë tha:

“O vaiz efendi! Harrove një nga pyetjet më të rëndësishme! Allahu i Madhëruar, shkurt do të pyesë:

«O robi Im! Unë isha me ty, më afër se damari i qafës tënde; po ti me kë ishe?!»

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“...Ai është me ju kudo që të jeni!..” (Hadid, 4.)

“...Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet!” (Kaf, 16.)

“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thujtu se) Unë jam afër...” (Bekare, 186.)

Pra, Allahu i Madhëruar, i Cili nuk ndikohet aspak nga koha dhe hapësira, është çdo çast me ne robërit e Tij! Ai di çdo gjendje tonën dhe dëshmon për çdo vepër që bëjmë... Për rrjedhojë, duke qenë të vetëdijshëm për këtë realitet, si besimtarë që jemi, ne duhet ruhem me shumë kujdes nga veprimet dhe sjelljet që nuk i kanë hije edukatës sonë.

Në atë ditë të madhe llogarie, do të sillet si dëshmitar për popullin e tij, edhe Profeti ynë i dashur (a.s.). Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellin dëshmitarë dhe të të sjellin ty (o Muhamed!) për dëshmitar mbi të gjithë ata?!” (Nisa, 41.)

Është gjithmonë e rëndë llogaridhënia para të dashurve tanë për një faj që kemi bërë. Për rrjedhojë, duhet medituar mbi gjendjen tonë, në kohën e llogaridhënies para profetëve, prijësve dhe dëshmitarëve të tjerë. Për më tepër, gjnahet e bëra në fshehtësi në dynja, në Ahiret do të shfaqen para shumë dëshmitarëve!..

Për këtë arsye, Profeti ynë (a.s.), i cili u dërgua si mëshirë për botën, në Hutben e Lamtumirës na është drejtuar me këto fjalë:

“...Dijeni se unë do të shkoj para dhe do t’ju pres në krye të Hauzit! Do të krenohem me numrin tuaj të shumë krahasuar me atë të ummeteve të tjerë. Prandaj, kujdes, mos ma nxini fytyrën (duke bërë gjynahe)!..”¹¹

Ndërsa në këtë ajet fisnik urdhërohet:

“Atë ditë, ata që nuk kanë besuar dhe që nuk i janë ibndur të Dërguarit, do të dëshironin të rrafshoheshin me tokën, por Allahut nuk mund t’i fshehin asnjë fjalë.” (Nisa, 42.)

Shkurtimisht, nëse sot njeriu jeton larg Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Allahu do të bëjë që ditën e madhe të llogarisë, ai të ndjejë një poshtërim aq të madh, sa të dëshirojë të futet në dhe.

**“Ruhuni
prej tokës, sepse ajo
është nëna juaj! Ajo
është vendi në të cilën
jetojmë dhe tek e cila do të
kthehemi në fund. Ajo do të
tregojë për të gjitha veprat
e mira apo të këqija
që bëhen mbi të!”**

(Hejthemi, I, 241.)



11. shih. Hejthemi, III, 271; Hamidullah, el-Uesaik, fq. 367.

KOKA E SINQERITETIT ËSHTË NËNSHTRIMI I PLOTË NDAJ ALLAHUT

— Sadik Dana —

Çfarëdo që të jetë e nevojshme për ta bërë një njeri, në mënyrë që ta shfrytëzojë kohën siç duhet, patjetër duhet ta bëjë së pari duhet parë aftësitë e tij. Sigurisht se kjo është çështje urtësie. Pastaj ky njeri sipas këtyre duhet ta organizojë jetën. Nëse shëndetin e ka të dobët, prapë se prapë duhet të përpiqet të përparojë në rrugë me atë shëndet të dobët që posedon. Dikush tjetër ka aftësi të madhe për të bërë ibadet. Fizikun e ka të fortë, kështu që bën shumë ibadet. Dikush tjetër ka aftësinë e trimërisë. Kur t'i mbledhim të gjithë, kanë të njëjtin kuptim, por rrugët e tyre janë të ndryshme. Trashëgimtarët janë të njëjtë, por rrugët janë të ndryshme. Allahu i Madhëruar të gjithëve ua ka dhënë këtë mundësi. Edhe një i sëmur madje ka detyrën e tij. I sëmuri nuk duhet të rrijë shtrirë duke menduar vetëm për veten, por edhe nëse nuk ka mundësi për të bërë ndonjë gjë, duhet të mendojë dhe të lutet për umetin e myslimanëve. Çdo rrugë është një rrugë e urtësisë që të shpie te Allahu Teala. Andaj nuk duhet të them që patjetër të jetë kjo apo ajo. Dikush mund të përparojë me namaz. Kështu që vazhdimisht preokupohet me namaz. Dikujt tjetër i pëlqen shumë për të agjëruar. Andaj shpesh herë mban agjërim. Madje ka prej atyre që mund të agjëronin çdo ditë po të ishte e lejuar diçka e tillë. Dikush mund të përparojë më urtësi. Dikush tjetër me botime. Veçanërisht në këtë kohë botimet janë prej shërbimeve më kryesore elhamdulillah. Siç thamë, ndihma financiare është për ata që kanë mundësi. Ndërsa ata që nuk kanë mundësi, nuk mund ta japin një ndihmë të tillë. Andaj nuk bën të dorëzohemi duke thënë se nuk mund të bëjmë ndonjë ndihmë financiare. Në shoqëri të gjithë e kanë një punë që mund ta bëjnë. Allahu i Lartësuar nuk e ka kufizuar këtë. Madje edhe për namazin nuk ka caktuar ndonjë vend. Ne mund ta falim atë kudo që të dëshirojmë. Gjithashtu nuk jemi të detyruar që ta falim në këtë apo atë xhami. Kjo është mirësi e Allahut (xh.xh.). Çdo gjë është e lehtë në Islam.

Ata të cilët janë të zgjuar, me kalimin

e kohës fillojnë të marrin urtësi. Allahu i Madhëruar ua shton urtësinë atyre. Si rrjedhojë e shohin më mirë të vërtetën. Ata e bëjnë më mirë çfarëdo që të jetë e nevojshme. Ata që kanë më pak urtësi, sigurisht që janë më mbrapa.

E gjithë çështja ndaj të cilës duhet të kenë kujdes të gjithë është kërkimi i sinqeritetit nga Allahu Teala. Nëse në një mexhlis ka sinqeritet, do të thotë se aty ka gjithçka. Nëse nuk ka sinqeritet, prapë se prapë është i mangët sado që të lexojë libra, tefsire, etj. Unë robi modest në lutjet e mia gjithmonë shprehem: “O Zot! Ma shto sinqeritetin!” Sinqeriteti është gjëja më e bukur. Atij që ka sinqeritet Allahu (xh.xh.), i jap pa masë.


Koka e sinqeritetit është nënshtimi i plotë ndaj Allahut

Koka e sinqeriteti është nënshtimi i plotë ndaj Allahut. Allahu (xh.sh.), u jep sinqeritet njerëzve që janë në rrugë të drejtë. Të mëdhenjtë tanë kanë folur shumë për sinqeritetin. Fjalët që thuhet lart e poshtë janë fjalë të njerëzve injorantë. Për fat të keq, në ditët e sotme të gjithë rendin pas këtyre duke u shprehur: “Ka këtë mrekulli, ka atë mrekulli. Ka thënë kështu e ka thënë ashtu.” Ndërkohë ata nuk kanë asnjë vlerë. Mrekulli shfaqin edhe ata që janë në rrugë të humbur. Vetëm se ajo nuk quhet mrekulli, por istidraxh.

Të mëdhenjtë kanë frikë të shfaqin mrekulli. Por ka edhe momente kur janë të detyruar të shfaqin mrekulli. Njerëzit e zakonshëm nuk mund ta kuptojnë njeriun e përsosur. Andaj në këtë moment shfaq mrekulli.

Për shkak se sahabët kishin sinqeritet të madh, asnjëherë nuk bënin gjëra të tilla. Gjithmonë hanin, pinin, uleshin, ngriheshin dhe flisnin nëse ishte e nevojshme si njerëz të thjeshtë. Ata ishin njerëz të tillë.

Me kalimin e kohës filloi të shfaqej dobësia në fe. Shumë njerëz patjetër duhej të shihnin diçka. Vetëm atë kohë të mëdhenjtë filluan t'i shfaqnin mrekullitë. Cila gjendje është më e mirë? Sigurisht se gjendja e parë është më e mirë.





HIPOKRIZIA

SËMUNDJA E ZEMRËS MË E FSHEHTË SE ZËRI I HAPAVE TË MILINGONËS

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Ndjenja e të pëlqyerit dhe të vlerësuarit, tek njeriu është një ndjenjë e natyrshme. Mirëpo, ndotja e sinqeritetit në adhurime dhe e pastërtisë së qëllimit në vepra me këtë ndjenjë, quhet hipokrizi. Dyfytërsia apo hipokrizia, është përpjekja e njeriut për të zbukuruar të jashtmen pa i vënë veshin të brendshmes dhe dëshira e zjarrtë për të fituar vlerësimin dhe respektin e njerëzve, duke u dukur më tepër se ç'është në realitet. Shkaku më i fortë i hipokrizisë, është kënaqësia prej lëvdatave dhe frika prej kritikave. Ndërsa ajo që nxit dëshirën për t'u lëvduar, është pëlqimi i vetvetes.

Burimi i hipokrizisë që zë rrënjë në zemër, është fakti se aty nuk kanë zënë vend sinqeriteti dhe qëllimi i pastër. Nëse në zemrën e robit nuk gjenden rrënjët e sinqeritetit dhe pastërtisë së qëllimit, në vendin e tyre zë rrënjë dhe lëshon degë dyfytërsia dhe, në këtë mënyrë robi fillon t'i nënshtrohet tundimeve të shejtanit.

Hipokrizia ndahet në dy lloje. Një e madhe dhe një e vogël. Hipokrizia e madhe, është ajo kur robi zbaton një urdhër të Allahut duke dëshiruar ta shohin të tjerët dhe jo për kënaqësinë e Allahut. Nisur nga kjo, kur Profeti ynë (a.s.), përkufizoi hipokrizinë, tha:

“Hipokrizi është ajo që kur kryen një urdhër të Allahut, e bëjnë atë për sy e faqe të njerëzve.” (Muslim, Zuhd, 46; Musned, II, 301.)

Në këtë çështje na tërheq vëmendjen edhe ky hadith i Profetit (a.s.):

“Në ditën e kijametit, hipokritit do t'i thirret kështu përpara njerëzve: «O hipokrit! O ti që mashtron! Vepra jote shkoi dëm dhe shpërblimi yt u fshi. Shko dhe kërkoje shpërblimin tënd prej atij për të cilin ke punuar!” (Musned, V, 428, 429.)

Lloji i dytë i hipokrizisë, është ajo që për shkak se njerëzit e nënvleftësojnë, quhet hipokrizi e vogël. Ajo është kryerja e adhurimeve edhe për Allahun, edhe për të fituar pëlqimin dhe lëvdatat e njerëzve. Kjo lloj hipokrizie, në shumë hadithe të Profetit tonë (a.s.), është cilësuar si shirk i fshehtë. Për rrjedhojë, Profeti (a.s.), ka thënë:

“Gjëja më e frikshme që kam frikë për ju, është shirku i vogël.” Sahabët e pyetën:

“Çfarë është shirku i vogël?” Profeti (a.s.), tha:

“Hipokrizia!” (Musned, IV, 124.)

Hipokrizia e cila cilësohet si shirk i fshehtë, është një sëmundje tinëzare në thellësi të zemrës. Lidhur me këtë, Profeti (a.s.), ka thënë:

“Shirku është më i fshehtë se zëri i hapave të milingonës së zezë, e cila ecën mbi kodrën e Safa në një natë të errët.” (Taberani, Mu'xhemu'l-eusat, IV/10, hadith nr: 3479; Ebu Nuajm, VII, 112.)

Diçka që është kaq e fshehtë dhe tinëzare, mund të dallohet vetëm me një zemër vigjilente dhe me

intuitë të gjerë. Kënaqësia e Allahut, janë veprat që bëhen duke vënë në planë të parë shqetësimin për botën tjetër dhe larg hipokrizisë dhe dëshirës për t'u dukur. Në udhëtimin e kësaj jete, nuk është e lehtë të bësh vepra pa ndjenjë hipokrizie. Veprat e sinqerta janë shkaqe që e ngrënë njeriun në pozita të larta në këtë botë dhe në tjetrën dhe e afrojnë tek Allahu.

Sëmundjet e zemrës, si pëlqimi i vetes dhe hipokrizia, i zhvlerësojnë veprat dhe, këto lloj veprash, në ditën e kijametit do t'i përplasen njeriut në fytyrë si paçavure. Në botën tjetër, kur të hapen librat e punëve dhe t'i tregohen të zotit, njeriu do të përballet me surpriza të mëdha. Ai do të shohë me hidhërim se ato që ka vepruar, kanë qenë nën robërinë e hipokrizisë dhe dëshirës për t'u dukur. Po ashtu, ai do të shohë se shumë prej veprave të cilat pandehte se po i bënte me sinqeritet, janë të ndotura me hipokrizi dhe shirk të fshehtë. Kështu, ai do të pësoj disfatë për shkak të pakicës së veprave që do t'ia zbardhnin fytyrën.

Në botën tjetër, njeriu do t'i kuptojë veprat e sinqerta dhe ato të përziera me hipokrizi, ashtu siç e kupton argjendari arin e vërtetë nga ai i rremi. Mirëpo, në atë moment, atij nuk do t'i bëjnë dobi shikimet majtas e djathtas, duke kërkuar ndihmë prej njerëzve përreth, sepse shumica do të jenë në një pozitë të tillë, që për shkak të gjynaheve të veta, nuk do të jenë në gjendje as të dalin para Zotit me fytyrat e tyre të nxira dhe as të shohin të tjerët. Kjo është një disfatë. Dhe, për të mos u përballur me këtë disfatë, është e domosdoshme të ruhesh nga shirku i fshehtë dhe të bësh një jetë shpirtërore me cilësi të lartë.

Mënyra e shpëtimit prej hipokrizisë, është të mos e mbash mendjen tek krijesat gjatë adhurimit të Allahut, të tregosh respekt ndaj sunetit në veprat e bëra për hir të Allahut dhe të ndjesh ëmbëlsi në shërbimin që bëhet në emër të Allahut. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar, në Kur'anin fisnik, urdhëron:

“Ata qenë urdhëruar vetëm të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër...” (Bejjine, 5.)

Rruga më e shkurtër për të shpëtuar prej sëmundjes së hipokrizisë, është të vigjilosh mbi hipokrizinë me frikë dhe shqetësim, ta diagnostikosh në kohë me urtësi dhe dije dhe të rishikosh përkushtimin ndaj fesë. “Çfarë kam bërë sot për Allahun? Sa prej atyre që kam bërë janë për Allahun, e sa për veten time? Sa janë përzierë punët e mia me shirk të fshehtë apo me mendimin “të shohin të tjerët”?

Nëse njeriu e llogarit veten në këtë mënyrë dhe i kontrollon sjelljet e tij, kjo mund të bëhet shkak që ai të shpëtojë nga hipokrizia, që është shirk i fshehtë. Nëse njeriu nuk e kontrollon dhe nuk e

llogarit veten, karakteri i tij dobësohet dhe ai mund të bëhet me personalitet të dubluar. Dhe, treguesit e parë të kësaj gjendjeje, fillojnë në formën e gënjeshtërs dhe hipokrizisë.

Thyerja e dëshirave dhe pasioneve të egos, prerja e shpresave prej njerëzve dhe orientimi drejt botës tjetër me gjithë shpirt, është një mënyrë tjetër e rëndësishme e shpëtimit prej hipokrizisë. Nëse nuk bëhet kjo, ndonjëherë edhe veprat që duken të sinqerta mund të përzihen me hipokrizi dhe brenda tyre mund të futen edhe interesa të kësaj bote. Lidhur me këtë, tregohet një ndodhi:

Një njeri, për vite me radhë kishte falur namazin në safin e parë. Një ditë, për shkak të një pengese të rëndomtë, ishte detyruar ta falte namazin në safin e dytë. Më pas, ky njeri u largua për një kohë nga xhemati dhe xhamia. Kur e pyetën për shkakun, ai tha: “Unë pandehja se namazet që kam falur gjithë këto vite me radhë, kanë qenë të sinqerta. Por kur e fala namazin vetëm njëherë në safin e dytë, u mërzita aq shumë, sa që kuptova se gjatë gjithë jetës e kisha falur namazin për t'u dukur. Për këtë arsye, u mbylla në shtëpi për të falur përsëri namazet e kaluara.”

Kurimi i hipokrizisë, arrihet me përpjekjet për t'u bërë i sinqertë, sepse sinqeriteti, është një mburojë që e ruan robin nga hipokrizia. Ashtu sikur është e mundur të ndryshohet padurimi me durim, harresa me dhikër, mosmirënjohja me falënderim, rebelimi me bindje, koprancia me bujari, gabimet me teube, gënjeshtria me të vërtetën dhe indiferenca me meditim, ashtu edhe hipokrizia mund të ndryshohet sinqeritet. Vetëm në këtë mënyrë mund të përparohet në jetën shpirtërore. Përveç këtyre, kurimi i hipokrizisë, arrihet me vetëdijen se Allahu nuk sheh kallëpet tona, por zemrat dhe se gradët tona në botën tjetër, shtohen dhe pakësohen në bazë të ndjenjave në zemër.

Shpëtimi prej hipokrizisë dhe dëshirës për t'u dukur, arrihet duke u ngjitur në majat e devotshmërisë hap pas hapi. Në këtë rrugë, përdorimi me sinqeritet i vullnetit njerëzor, është shumë i rëndësishëm. Po aq e rëndësishme, është edhe kërkimi i mirësisë dhe i bujarisë prej Allahut të Madhëruar.

Shpëtimi prej shirkut të fshehtë dhe hipokrizisë dhe arritja e një devotshmërie të sinqertë, nuk është diçka që arrihet lehtë dhe përnjëherësh, sepse në këtë rrugë ka shumë pengesa. Rruga më e sigurt në këtë çështje, është të bëhesh rob i Allahut, duke nënshtruar egon. Në këtë mënyrë, është e mundur të bëhet një jetë e devotshme larg hipokrizisë dhe të shkosh në botën tjetër me një libër veprash të bukur dhe të pastër. Lutja jonë ndaj Allahut, është që të na mbrojë nga hipokrizia dhe të na bëjë të sinqertë.

Heshtja

si virtut

— Ebu Hamid El-Gazali —

Gjuha përbën rrezikshmëri të lartë. Njeriu shpëton prej saj vetëm duke heshtur. Ndaj dhe feja jonë e bukur ka lavdëruar dhe nxitur heshtjen.

Hadithet lidhur me këtë çështje janë:

“Ai që hesht, shpëton (nga rreziku).”¹

Në një tjetër hadith tjetër ai shprehet kështu:

“Të heshtësh është urtësi, por sa pak që e praktikojnë!”²

Abdullah b. Sufjan (r.a.), thuhet se ka dëgjuar të atin të thoshte:

Iu drejtova Resulullahut (a.s.), duke i thënë: “O i Dërguar i Allahut! Tregomë diçka që nga Islami, që kur ta bëj atë të më mjaftojë dhe të mos ndiej nevojën për të pyetur dikë tjetër pas jush.” Resulullahu (a.s.), më dha këtë përgjigje:

“Thuaj që i ke besuar Allahut dhe ji i drejtë!”

I ati i Abdullahut, Sufjan es-Sekafiu ka thënë:

“O i Dërguar i Allahut! Nga cila gjë duhet të ruhem më shumë?”

Ndërkohë, Resulullahu më tregoi me shenjë tek gjuha.³

Ukbe b. Amir (r.a.), tregon:

Pyeta Resulullahun: “O i Dërguar i Allahut! Çfarë është shpëtimi?” Resulullahu m’u përgjigj kështu:

“Ruaje gjuhën. Sado të gjerë ta kesh shtëpinë, mos

dil nga shtëpia, vetëm në raste të domosdoshëm dhe qaj për gabimet që ke bërë.”⁴

Sehl b. Sa’d es-Sisi, transmeton se Resulullahu (a.s.), të ketë thënë në këtë mënyrë:

“Mund të bëhem dorëzanë për të hyrë në Xhenet për atë që më premtan se do të ruajë atë që gjendet mes dy nofullave dhe mes dy këmbëve.”⁵

Pejgamberi (a.s.), ka thënë kështu:

“Ai që ruhet nga rreziku i stomakut, organit gjenital dhe gjuhës, ruhet nga të gjitha të këqijat.”⁶

Shumica e njerëzve shkatërrohen për arsye të dëshirës së epshme të këtyre tre organeve. Pejgamberi (a.s.), u pyet një ditë:

- O i Dërguar i Allahut! Cila është vepra që më së shumti çon njeriun në Xhenet?

I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj:

- *Frika ndaj Allahut dhe edukata e mirë.*

Pastaj u pyet, se cila është vepra që e çon në Xhehenem dhe Pejgamberi (a.s.), u përgjigj:

- *Dy gjëra që janë të zbrazëta nga brenda, pra goja dhe organi gjenital.⁷*

Qëllimi me gojën është ose gjuha ose barku, sepse goja është vendi ku është gjuha. Goja është gjithashtu vendi përmes së cilit ushqehet barku yt.

Kur Muadh bin Xhebeli (r.a.), e pyeti Resulullahun

(a.s.), “O i Dërguar i Allahut! A do të kemi përgjegjësi për ato çfarë themi?”, Resulullahu (a.s.), qe përgjigjur:

“Allahu të dhëntë të mira, o Ibn Xhebel! Çfarë mund të ketë tjetër gjë, përveç gjuhës që bën njeriun të zvarritet me fytyrë përdhe drejt e në Xhehenem?”⁸

Abdullah es-Sekafi (r.a.), tregon:

Iu drejtova Resulullahut (a.s.): “O i Dërguar i Allahut! Tregomë një punë të atillë, që kur ta veprojmë atë, të më mjaftojë.” Resulullahu (a.s.), m’u përgjigji duke kapur me dorë gjuhën:

“Kjo është!”⁹

Kur Muadhi (r.a.), e pyeti të Dërguarin e Alahut (a.s.), se cila është vepra më e virtytshme, ai nxori gjuhën e tij të begatë dhe e preku me gisht dhe tha:

“Të mund ta ruash këtë!”¹⁰

Sipas asaj çfarë transmeton Enes b. Maliku (r.a.), Resulullahu (a.s.), ka thënë:

“Përsa kohë që një njeri nuk e ka zemrën në rrugë të drejtë, s’ka si ta ketë imanin të rregullt. Pa pasur të rregullt gjuhën, nuk ka si të ketë zemrën në rrugë të drejtë. Nuk mund të hyjë në Xhenet një njeri, përsa kohë që fqinji i tij nuk është i sigurt prej tij.”¹¹

Resulullahu (a.s.), ka thënë gjithashtu:

“Ai që do që të jetë gjithnjë i lumtur, le të mos ndërpresë heshtjen!”¹²

Në hadithe të tjera, Resulullahu (a.s.), ka thënë kështu:

“Kur njeriu mbërrin agimin, të gjithë organet shprehen njëzëri duke iu drejtuar gjuhës: Ki frikë nga Zoti! Vërtet, nëse ti do të ishe në rrugë të drejtë, edhe ne do të ishim në rrugë të drejtë. Nëse ti devijon nga e sakta, atëherë edhe ne devijojmë.”¹³

Sipas asaj çfarë transmetohet, kur Omeri (r.a.), pau që Ebu Bekri (r.a.), po tërhiqte me dorë gjuhën e vet, e pyeti me habi:

- Çfarë po bën kështu, o mëkëmbësi i Resulullahut?

Ebu Bekr es-Siddiku (r.a.), u përgjigj:

- Kjo është ajo që më ka hedhur në situata të vështira! Resulullahu (a.s.), ka thënë kështu:

“Të gjithë organet e trupit ankohen tek Allahu mbi rrezikun e gjuhës.”¹⁴

Ibni Mesudi, një ditë ishte ngjitur në kodrën Sefa dhe po thoshte: “Lebbejk, Allahumme lebbejk!..” dhe pastaj tha kështu:

“O gjuhë! Para se të pendohesh, fol gjëra të duhura, që të dalësh e fituar. Nëse do të shpëtosh, kurrë mos thuaj gjëra të këqija.”

Pas kësaj, ai u pyet:

“O Ebu Abdurrahman! Këto po i thua ti apo i ke dëgjuar nga Resulullahu?”

Ndërkohë, Ibn Mesudi (r.a.), tha:

- Po, unë kam dëgjuar Resulullahun tek thoshte: “Vërtet shumica e gabimeve të njeriut burojnë nga gjuha e tij.”¹⁵

Ibni Omeri (r.a.), tregon: Resulullahu (a.s.), ka thënë kështu:

“Ai që e ruan gjuhën nga të këqijat e saj, Allahu ia mbulon të metat. Ai që kontrollon zemërimin e vet, Allahu i Madhëruar e mbron nga dënimi i Tij. Ai që i përgjërohet Allahut duke ia bërë të ditur gabimin, Allahu i Madhëruar ia fal gabimin.”¹⁶

Muadh bin Xhebeli (r.a.), i qe lutur Resulullahut (a.s.), që ai ta këshillonte për diçka dhe Pejgamberi (a.s.), i pati thënë:

“Bëj ibadet sikur të sheh Allahun e Madhëruar. Konsideroje veten prej të vdekurve. Nëse ke dëshirë, mund të të them edhe më shumë sesa kaq, që duhet të kesh.” Pas kësaj i bëri me shenjë nga gjuha.”¹⁷

Sipas transmetimit të Safvan bin Sulejmit (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“A t’ju tregoj për ibadetin më të kollajtë dhe që trupit i vjen më lehtë? Ajo është heshtja dhe edukata e mirë.”¹⁸

Sipas një transmetimit të Ebu Hurejres (r.a.), Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Ai që i beson Allahut dhe Ditës së Ahiretit, le të flasë siç duhet ose të heshtë!”¹⁹

Hasan Basriu (r.a.), thotë që: “Neve na është thënë se Resulullahu (a.s.), ka thënë:

“Allahu e mëshiroftë atë njeri që kur flet fiton dhe kur hesht shpëton.”²⁰

Isait (a.s.), i është kërkuar: “Na trego ndonjë vepër, që nëse e bëjmë hyjmë në Xhenet.” Isai (a.s.), ka thënë:

- Mos flisni kurrë!

- Po nuk mund të mos flasim kurrë. – i thanë të pranishmit.

- Atëherë, flisni vetëm gjëra të mira.²¹

Davudi (a.s.), ka thënë: “Nëse të flasësh është argjënd, të heshtësh është flori.”²²


Bera bin Adhib (r.a.), tregon:

Një ditë erdhi një njeri që jetonte në shkretëtirë dhe i tha Resulullahut:

- Tregomë një vepër që t’më bëjë të hyj në Xhenet.

Resulullahu (a.s.), i tha:

“Jepi të hajë atij që është i uritur. Jepi ujë atij që ka etje. Urdhëroji për mirë. Pengoji që të mos bëjë në keq. Nëse nuk mund të bësh asnjë nga këto që



“Përsa kohë që një njeri nuk e ka zemrën në rrugë të drejtë, s’ka si ta ketë imanin të rregullt. Pa pasur të rregullt gjuhën, nuk ka si të ketë zemrën në rrugë të drejtë.

Nuk mund të hyjë në Xhenet një njeri, përsa kohë që fqinji i tij nuk është i sigurt prej tij.”

thashë, atëherë, kontrolloje gjuhën, fol vetëm gjëra të mira.”²³

Resulullahu (a.s.), ka thënë kështu:

“Mbaje gjuhën, thuaj vetëm të mira; sepse vetëm kështu mund të mundësh shejtanin.”²⁴

Një tjetër hadith i Pejgamberit (a.s.), është kështu:

“Allahu i Madhëruar është pranë gjuhës së çdo-njërit që flet.”²⁵ Atëherë, le t’i frikësohet Allahut ai që di çfarë thotë!”²⁶

Resulullahu (a.s.), ka thënë:

“Nëse shikoni ndonjë njeri që shumicën e kohës rri i heshtur dhe që është njeri me dinjitet, afrohuni atij, sepse atij i është dhënë urtësia.”²⁷

Ibni Mesudi (r.a.), tregon: Resulullahu ka thënë:

“Njerëzit ndahen në tri klasa. Ata që janë fitimtarë, ata që shpëtojnë dhe ata që janë gjynahqarë. Ata

që janë fitimtarë janë ata që i bëjnë dhikër Allahut të Madhëruar. Ata që kanë shpëtuar janë ata që heshtin. Kurse ata që janë gjynahqarë janë ata që zhyten në punë pavlera dhe të kota.”²⁸

Resulullahu (a.s.), ka thënë:

“Gjuha e besimtarit është pas zemrës së tij. Kur ai do që të flasë diçka, pikësëpari e mendon me zemër atë. Pastaj e derdh në fjalë. Gjuha e hipokritit është para zemrës së tij. Kur do të shprehë diçka fillimisht e derdh në fjalë, pastaj mendon.”²⁹

Isai (a.s.), ka thënë: “Ibadeti është dhjetë pjesësh. Nëntë prej tyre janë tek heshtja. Kurse njëra është tek ikja prej njerëzve.”

Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Ai që flet shumë, ka edhe gabime shumë. Ai që ka gabime shumë, ka edhe gjynahe shumë. Ai që ka shumë gjynahe, Xhehenemi është më i merituar për të.”³⁰

■ **REFERENCAT:** 1) Tirmidhiu, Kijame, 50; Ahmed, Musned, 2/159; Ibn Ebu’d-Dunja, Kitabus-samt, nr. 10. 2) Dejemiu, Firdevsul-akbar, nr. 3667; Bejhakui, Shuabul-iman, nr. 5027. 3) Muslimi, Iman, 62; Tirmidhiu, Zuhd, 61; Ibni Maxhe, Fiten, 12; Ahmed, Musned, 3/413; Ibni Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 1. 4) Timridhiu, Zuhd, 61; Ahmed, Musned, 4/148; Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 1653; Abdullah b. Mubarek, Zuhd, nr. 134; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 2. 5) Buhariu, Rikak, 23; Tirmidhiu, Zuhd, 61; Ahmed, Musned, 5/333; Ibni Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 3. 6) Shih. Zebidi, It’haf, 9/132. 7) Buhariu, Edebul-mufred, nr. 289, 294; Tirmidhiu, Birr, 62; Ibn Maxhe, Zuhd, 29; Ahmed, Musned, 2/291; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 4. 8) Tirmidhiu, Iman, 8; Ibn Maxhe, Fiten, 12; Hakim, el-Mustedrek, 4/286 – 287; Ahmed, Musned, 5/231; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 6. 9) Ahmed, Musned, 3/413; Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 6143; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 7. 10) Taberani, el-Muxhemul-kebir, 8/1539; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 8. 11) Ahmed, Musned, 3/198; Hejthemiu, Mexhmauz-zevaid, 1/53; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 9; Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 9964. 12) Bjehekui, Shuabul-iman, 2/91; Hejthemiu, Mexhmauz-zevaid, 10/297, 298; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 11; Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 8746. 13) Tirmidhiu, Zuhd, 60; Ahmed, Musned, 3/95, 96; Bjehekui, Shuabul-iman, 2/92; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 12; Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 454. 14) Ahmed, Kitabuz-zuhd, nr. 112; Ebu Ja’la, Musned, 1/17; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 13; Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 7605. 15) Bejhakui, Shuabul-iman, 2/91; ; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 18; Hejthemiu, Mexhmauz-zevaid, 10/299-300. 16) Abdullah b. Mubarek, Zuhd, nr. 745; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 21; Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 8998. 17) Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 1131 1133; Ahmed, Musned, 2/24; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 22. 18) Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 2759; Sujtiti, ed-Durrul-mensur, 2/75; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 27. 19) Buhariu, Edebul-mufred, nr. 103; Muslimi, Iman, 77; Ahmed, Musned, 4/31; Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 8979; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 40. 20) Sujtiti, Xhamius-sagir, nr. 4425, 4426, 4427; Ahmed, Kitabuz-zuhd, f. 277; Abdullah b. Mubarek, Zuhd, 380; Dejemiu, Firdevsul-ahbar, nr. 3204; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 41. 21) Dhebidi, it’haf, 9/138; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 46. 22) Axhluni, Keshful-khafa, 1/260; Dhebidi, it’haf, 9/139; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 47. 23) Ahmed, Musned, 3/72; Darekutni, Sunen, 2/135; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 67. 24) Ahmed, Musned, 3/72; Ebu Ja’la, Musned, nr. 1000; Hejthemiu, Mexhmauz-zevaid, 4/215. 25) Al-lame Dhebidi e komenton kështu: “Allahu i Madhëruar e di përmes dijes së Tij të folurën e secilit që flet. Përndryshe, këtu nuk bëhet fjalë që t’i atribuohet hapësirë Allahut.” Kurse Mutarrizi e ka sqaruar në këtë mënyrë këtë thënie: “Kjo shprehje është alegorike. Kuptimi i saj është: Allahu i Madhëruar është në dijeni të gjithçkaje çfarë në flasin” (Dhebidi, it’haf, 9/139). 26) Ebu Nuajm, Hiljetul-evlija, 8/170; Abdullahu b. Mubarek, Zuhd, 125; Ibn Ebu Shejbe, Musanef, 13/234; Sujtiti, ed-Durrul-mensur, 6/105. 27) Ibni Maxhe, Zuhd, 1; Ebu Nuajm, Hiljetul-evlija, 10/405; Bejhakui, Shuabul-iman, nr. 10524; Ebu Ja’la, Musned, nr. 6803. 28) Taberani, el-Mexhmul-kebir, 17/303; Hejthemiu, Mexhmauz-zevaid, 1/129. 29) Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 425 (nga Hasan el-Basri) 30) Ebu Nuajm, Hiljetul-evlija, 3/74; Ibn Ebud-Dunja, Kitabus-samt, nr. 90-91; Dhebidi, It’haf, 9/142.

*Qiellit me sy
Durim
Lidhje
Ajo tokë e errët si ëndrra
Asgjë jashtë me korbin
Dallëndyshja nuk njih xhelozi
Çdo gjë për mungesën
Frikë që ushqen luks
Ajo tokë prej mjalti, pa hile
Nën atë qiell pa hije*

Qiell

— Edison Çeraj —

Secili ka qiellin e vet. Askush nuk e sheh dot qiellin e tjetrit. Megjithëse dy veta mund të jenë bashkë, ngjitur njëri me tjetrin, duke parë të njëjtin qiell, ndryshe i flet njërit e ndryshe tjetrit. Aq sa çka njerëz mbi tokë, me po aq gjuhë komunikon qielli me secilin prej tyre. Qielli është një kujtesë e posaçme për çdokënd, një mall që përvëlton në çdo frymë, një frymë që mban ndezur misterin e fatit. Fati është e vetmja pamundësi që bëhet e mundshme me ne.

Qielli është çatia jonë e përbashkët, ku ka vend për të gjithë, edhe për atë që e ka harruar, përderisa i rri në çdo çast mbi krye. Qielli është gjendje pamore ku ndiehesh aq i vogël dhe në të njëjtën kohë plot shpresë; i çliruar nga preokupimet dhe i mbërthyer nga thellësia e misterit dhe pritjes.

Qielli është e vetmja dashuri që të përfshin pa kushte; që të jepet pa asnjë përpjekje, pa asnjë kërkesë për të qenë një tjetër. Qielli është frika dhe shpresa jonë e domosdoshme për t'u ruajtur nga ligështimi dhe moskokëçarja. Qielli është dehje, që në gjuhën e tij nënkupton krejt të kundërtën: kthjellje në çdo qelizë. Qielli i lejon sytë tanë që të vizatojnë ëndrra mbi lëkurën e tij të paanë. Qielli

është pengu jonë i mundshëm, vullneti ynë i rrezikuar nga ëndrra e shndërrimit në hiç; dëshirë e gatuar me mekje e zjarr për të rikthyer në qenien tonë gjendjen e kryehershme.

Toka është vetëm një pore në lëkurën e qiellit, e megjithatë ai na fal ndjesinë sikur jemi qendra e mbretërisë së tij; nuk ndiehem të lënë mënjane, përkundrazi: çdo shenjë që ai na jep e marrim si lajmëtare në shërbimin tonë. Qielli flet me ne në çdo pikë shiu që bie, nëpërmjet çdo ylli që shfaqet në pëlhurën e natës dhe me vesën e bekuar të agut që heq prej nesh mendimet e ngjitura nga errësira. Qielli është thelbi i çdo estetike dhe etike. Qielli fsheh të shkuarën tonë dhe zbulon të ardhmen. Qielli t'i merr mendtë, por të rizgjon zemrën.

Qielli është një çati ku ka vend për çdokënd, edhe për ata që kërkojnë për ndonjë të çarë në të.

Qielli është i mbushur plot me fara që presin të mbillen në tokë. Qielli është lindja dhe perëndimi, dita dhe nata, dielli dhe hëna.

Qielli është një pritje e patjetërsueshme, joshje, sfidë dhe kujtesë për të mos rënë pre e gravitetit.

Qielli është emri i fshehur i dashurisë.

SPROVA HYJNORE PËR TË GJITHË NE KOHA PËR T'U BËRË ENSARË

— M. Ali Eshmeli —

Historia është e mbushur plot me ngjarje të shpërnguljeve. Disa shpërngulje kanë ndodhur për shkak të katastrofave të mëdha, thatësirave të tmerrshme dhe epidemive të rënda. Disa shpërngulje të tjera kanë ndodhur për shkak të kushteve dhe mjediseve të pajetueshme, si rezultat i zullumeve të madhe që u janë bërë njerëzve për arsye të besimit të tyre. Po ashtu, ka edhe shpërngulje dhe emigrime që janë bërë për shkak të luftërave barbare dhe spastrimeve etnike. Edhe dje ka ndodhur kështu, edhe sot po ndodh e njëjta gjë. Shpërngulje të panumërta. Në lidhje me këtë çështje, Turqia sot është shndërruar në një qendër shpërnguljesh të detyrueshme. Që prej dyqind vitesh po përjetohen shpërngulje të vazhdueshme drejt qendrës nga vendet që përbënin perandorinë madhështore osmane. Një zinxhir shpërnguljesh, i mbushur plot e përplot me gjendje

që s'kanë rrugëzgjdhje. Shpërngulja e jetimëve të gjyshërve tanë. Shkaku i të gjithëve është i njëjtë:

Padrejtësitë dhe vrasjet. Shndërrimi i vendit të tyre në një gjendje të pajetueshme dhe të mjerueshme.

Që prej dyqind vitesh, detyra e tokave tona si qendër dhe e jona është që t'i ndihmojmë, si ensarët me gjithë zemër, vëllezërit që janë jetimët e gjyshërve tanë. Veçanërisht kundrejt vëllezërve tanë që vijnë nga Siria në këto ditët e sotme, është shumë e rëndësishme që ta perceptojmë të qenët ensarë nga aspekti i mënjanimit të pikëpamjeve të mangëta dhe i kryerjes së përgjegjësisë dhe detyrave që na takon t'i kryejmë. Meditimi më i saktë është i lidhur me vëllazërinë që u realizua në epokën e lumturisë (në kohën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), të historisë



së Islamit dhe me të kuptuarit e shfaqjeve të asaj vëllazërie, sepse në atë periudhë u bë rregull deklarimi i ajetit fisnik në të cilin thuhej:

“Ata që, pasi vuajtën të shtypur, u shpërngulën për hir të Allahut, Ne do t’i vendosim në vendbanime të mira në këtë botë. Natyrisht, shpërblimi që i pret në botën tjetër (Xheneti), është edhe më i madh. Ah! Sikur ta dinin ata!” (Nahl, 41)

Muhaxhirët mekas lanë çdo gjë pas dhe u shpërngulën për në Medine. Aty u përjetuan mirësi brenda kornizës: **“Ata që besojnë, mërgojnë e luftojnë për çështjen e Allahut dhe ata që u japin strehim atyre e i ndihmojnë, pa dyshim, janë besimtarë të vërtetë; për ta ka falje dhe shpërblim bujar.”** (Enfal, 74)

Ensarët medinas i pritën me një dashuri të papërkufizueshme dhe i trajtuan me një nderim të madh muhaxhirët mekas. Ata dëshironin me gjithë shpirt që t’i merrnin për mysafirë në shtëpitë e tyre. Ndërmjet ensarëve filloi gara e sakrificës. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i cili u gëzua pa masë prej kësaj gjendjeje, i bëri vëllazër muhaxhirët dhe ensarët. Çdo familje muhaxhire u vendos pranë një familjeje prej ensarëve. Atë kohë po realizohej shfaqja e një vëllazërie të veçantë dhe të pashoqe që nuk ishte parë ndonjëherë në histori. Ensarët po ndanin çdo gjë të tyre me muhaxhirët. Ensarët po ndanin në dysh shtëpitë, bahçet, vreshtat dhe çdo gjë që kishin. Në këtë mënyrë, gjysmën ua jepnin muhaxhirëve. Kjo situatë shkoi deri aty sa që një sahab i bekuar, i cili gjendej në pikën kulmore të sakrificës dhe nderimit, erdhi te i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe i parashtrroi këtë kërkesë:

“O i Dërguari i Allahut! Ndaji edhe vreshtat e hurmave tona ndërmjet nesh dhe vëllazërve tanë muhaxhirë!” I Dërguari i Allahut (s.a.s.), nuk e pa të përshtatshme këtë dhe tha: “Jo, kjo nuk bën.” Për shkak të kësaj, ensarët e ndryshuan propozimin për muhaxhirët. Ensarët thanë: “Nëse e merrni përsipër ju përkujdesjen dhe vaditjen e pemëve, do ta ndajmë bashkë prodhimin.” Pasi këtë e pranoi edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.), të dyja palët thanë: “Dëgjuam dhe u bindëm!” (Buhari, Hars, 5.)

Me të vërtetë e zbatuan diçka të tillë. Gjithashtu u dëshmuar edhe sakrifica të papara dhe paralele me propozimin e parë, sepse, kur ensarët i vilnin hurmat, i ndanin në dysh. Në njëren anë vendosnin shumë dhe në anën tjetër vendosnin pak hurma. Anën e hurmave që kishte pak e mbushnin me degë hurmash që të dukej sikur kishte edhe më shumë.

Pastaj u thoshin muhaxhirëve: “Cilin grumbull dëshironi?” Muhaxhirët zgjidhnin grumbullin që dukej pak dhe ua linin ensarëve grumbullin që dukej sikur kishte më shumë. Në këtë mënyrë, shumica e hurmave i binte muhaxhirëve edhe pse ata nuk e kuptonin dot. Si rezultat, ensarët mbanin grumbullin që kishte pak hurma.” (Hejthemi, X, 40.)

Kjo ishte një cilësi dhe ndjeshmëri e një vëllazërie krejt tjetër. Ensarët, si rezultat i begatisë së edukimit nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.), edhe nëse kishin vetë nevojë, gjenin diçka për t’ua dhënë vëllazërve të tyre.

Një herë, një person që ishte kapluar nga dobësia për shkak të urisë, shkoi te i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe i kërkoi ndihmë. Pejgamberi ynë i nderuar pyeti: “Kush dëshiron ta marrë për mysafir këtë vëllain tuaj?” Ebu Talha (r.a.), i cili ishte prej ensarëve, tha: “O i Dërguari i Allahut! Mund ta marr unë për mysafir.” Pastaj e mori të varfrin dhe e çoi te shtëpia e tij. Bashkëshorten e pyeti: “Sonte do të ushqejmë mysafirin e të Dërguarit të Allahut. A ka ndonjë gjë për të ngrënë në shtëpi?” Bashkëshortja iu përgjigj: “Jo. Por ka vetëm diçka sa për fëmijët.” Ebu Talha i tha bashkëshortes së tij: “Atëherë ti habiti fëmijët! Nëse dëshirojnë të ulen në sofër, vëri të flenë gjumë! Kur të vijë mysafiri, gjej një pretekst dhe errësoj llambën! Pastaj edhe ne të dy le të bëjmë sikur hamë në sofër.” Burrë e grua vepruan në këtë mënyrë. Mysafiri u ngop, ndërsa ata ranë për të fjetur të uritur.

Të nesërmen në mëngjes, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha Ebu Talhës, (r.a.): “Allahu Teala është kënaqur me atë që i keni bërë mysafirit mbrëmë.” (Buhari, Tefsir, 59/6; Muslim, Eshribe, 172-173.) Allahu Teala e shprehu me këtë ajet fisnik kënaqësinë e tij ndaj këtyre dy bashkëshortëve ensarë:

“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.” (Hashr, 9)

Ensarët gjithmonë ishin të gatshëm që ta sistemonin dhe t’i jepnin drejtim jetës së tyre sipas këtyre udhëzimeve dhe përskrimeve hyjnore. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e ka lavdëruar dhe vlerësuar në mënyrë të veçantë këtë sjellje të tyre: “Shikoj se ju shtoheni dhe

mblidheni kur thirreni për të luftuar në rrugë të Allahut dhe për t'i ndihmuar të varfrit. Ndërsa jeni të pakët dhe zgjidhni të mjaftoheni me atë që keni kur thirreni për t'ju dhënë prej gjërave të kësaj bote.” (Ali el-Muttaki, XIV, 66.)

Ndërsa muhaxhirët kanë thënë në lidhje me ensarët: “O i Dërguari i Allahut! Ne nuk kemi parë njerëz kaq dorëlibër dhe bujarë sa këta njerëz të cilët kemi emigruar. Ata që kanë shumë mundësi, po shfaqin mjaft bujari. Ndërsa ata që kanë pak mundësi, na ndihmojnë duke sakrifikuar për ne. Ata nuk na kanë lënë të përjetojmë vështirësitë e emigrimit. Na kanë bërë ortakë në pasuritë e tyre. Për këtë arsye, të gjithë sevapin dhe shpërblimin do ta fitojnë ata!”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: “Jo, edhe ju (do ta arrini atë sevap. Sigurisht se) *përderisa t'i luteni Allahut për ata dhe t'i falënderoni për ato që ju kanë dhënë...*” (Tirmidhi, Kijamet, 44/2487.)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), përsëri ka thënë: “(Por dijeni edhe këtë se) *muhaxhirët do të hyjnë në Xhenet shtatëdhjetë vjet para njerëzve dhe do të përfitojnë prej mirësive të tij. Ndërkohë njerëzit e tjerë do të lihen në pritje për të dhënë llogari.*” (Hejthemi, X, 15.) Sepse, siç shprehet edhe Allahu i Madhëruar: “*...Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrata e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t'ua mbuloj veprat e këqija dhe do t'i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu.*” (Al Imran, 195) Sepse muhaxhirët nuk emigruan për ndonjë interes të kësaj bote. Shpërngulja e tyre ishte vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut Teala. Shpërngulja e tyre ishte vetëm për ta zbatuar fenë e Allahut Teala. Shpërngulja e tyre ishte vetëm për t'iu bindur urdhrimit të Allahut (xh.sh.). Muhaxhirët, edhe para se të shpërnguleshin për në Medinë, duruan me të njëjtin qëllim dhe shfaqën qëndrueshmëri në besimin e tyre edhe pse iu bënë shumë tortura, keqtrajtime dhe padrejtësi të panumërta në vendin e tyre.

Nisur nga ky aspekt, ata gjithmonë kishin përparësi për sa i përkiste ndihmës. Ngaqë u privuan prej çdo gjëje të tyre për shkak të shpërnguljes, gjithmonë ishin në krye të rendit. Allahu i Madhëruar urdhëroi që atyre t'u ndahej një pjesë pak më e madhe se e të tjerëve prej plaçkave të luftës duke u shprehur: “*Një pjesë e plaçkës i takon edhe mërgimtarëve të varfër, të cilët u përzunë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Allahut dhe duke ndihmuar*

Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e singjertë.” (Hashr, 8)

Edhe për zbatimin e urdhrimit të këtij ajeti fisnik ensarët përsëri shfaqën një vullnet të veçantë.

Toka e Bahrejnit do të ndahej pjesë-pjesë dhe do t'u jepej sahabëve. I Dërguari i Allahut, (a.s.), së pari thirri ensarët. Ndërsa ensarët hoqën dorë nga e drejta e tyre dhe thanë: “O i Dërguari i Allahut! Mos na jepni gjë ne pa u dhënë vëllezërve tanë muhaxhirë një herë më shumë se kjo!” (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 8.) Kjo tablo madhështore ishte shfaqja e një vëllazërie prej të cilës mahnitej edhe sakrifica. Një vëllazëri e bekuar dhe me një cilësi që u jepte përparësi vëllezërve ndaj vetes. Një vëllazëri aq e madhe dhe e shtrenjtë saqë shpërblimi i vërtetë mund t'i jepet vetëm në Ahiret. Për shkak se shpërblimi i kësaj vëllazërie nuk mund të jepet në këtë botë, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, shprehet kështu për mirësitë e saj:

“*O ensarë! Duroni derisa të më takoni mua te burimi i Keutherit!*” (Shik. Buhari, Menakibu'l-Ensar, 8.) Përveç të tjerash, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), u ka dhënë këtë këshillë sahabëve: “*Ju këshilloj që të silleni mirë me ensarët. Ata janë xhemati, shokët dhe besnikët e mi. Ata i kanë kryer siç duhet detyrat që u kanë takuar. Ndërsa kundërvlera e shërbimeve të tyre akoma nuk është paguar. (Në Ahiret do të shpërblehen shumë për to.) Për këtë arsye, silluni me mirësi kundrejt të mirëve prej tyre dhe falini ata që mund të gabojnë prej tyre.*” (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 11.) Po ashtu, Pejgamberi ynë i nderuar ka thënë: “*Kushdo që i beson Allahut dhe Ditës së Gjyqimit, të mos i urrejë ensarët!*” (Tirmidhi, Menakib, 25/3906.) “*Ata (ensarët) i duan besimtarët dhe i urrejnë vetëm hipokritët. Atë që do ensarët, e do edhe Allahu. Atë që i urren ensarët, e urren edhe Allahu.*” (Tirmidhi, Menakib, 25/3900.) “*Po të mos ishte hixhreti, unë do të bëhesha njëri prej ensarëve.*” (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 2.) Sepse ensarët e realizonin në shkallën më të lartë detyrën e ndihmës që u takonte në vëllazëri. Në fakt, esenca e vëllazërisë që u formua ndërmjet muhaxhirëve dhe ensarëve ishte ndihma reciproke. Pra, ishte mbështetja ndaj njëri-tjetrit nga çdo aspekt qoftë material apo qoftë shpirtëror.

Hixhreti madhështor, i cili është fillimi i kalendarit të myslimanëve, u bë vula e një periudhe të re në sajë të kësaj dashurie, sepse kjo vëllazëri ndante çdo lloj vetmie dhe halli. Kjo vëllazëri i shpëtonte njerëzit nga të qenët klasa më e ulët në vatanin e

tyre dhe i shpinte në vatanin e civilizimit të udhëzimit, mëshirës dhe prehjes shpirtërore. Kjo vëllazëri, sikundër vështirësive të hixhretit, i bënte njerëzit të përjetonin begatinë dhe mirësitë e tij të pafundme. Kjo vëllazëri bëhej pasqyra e shfaqjes së bujarisë në një shkallë të paparë ndonjëherë. Kjo vëllazëri shfaqte vlerën e miqësisimit dhe bashkimit në rrugën e Allahut Teala dhe Pejgamberit tonë të nderuar. Kjo vëllazëri ishte një sinqeritet, një dashuri hyjnore dhe një përqaftim sublim në të cilin nuk u përzi shtirja dhe egoizmi në asnjë mënyrë.

Fiset që më parë derdhnin gjakun e njëri-tjetrit vazhdimisht për shkak të çifutëve ngatërrestarë në Medinë, u shndërruan në fatlumë që garonin në sakrificë për njëri-tjetrin në sajë të lidhjeve të kësaj vëllazërie. Zënkata, grindjet, kontradiktat dhe divergjencat që kishin ndërmjet tyre, në sajë të kësaj vëllazërie, u shndërruan në miqësi, bashkim, aleancë dhe solidaritet të pashoq. Ata u zgjuan në çdo aspekt nga shkujdesja që i bënte ushqim për gojë e armiqve që u thoshin: “Ju hani njëri-tjetrin! Pastaj edhe ne ju hamë ju!” Si simbol i besimit, nëpër zemrat e tyre u ngritën peshoret e sjelljes vetëm me butësi e mëshirë kundrejt vëllezërve besimtarë. Vetëm se u vendosën edhe rregullat e ashpërsisë kundrejt qafirëve. Si rezultat i kësaj vëllazërie, u formua një shoqëri që do të ndërtonte epokën e lumturisë.

Në të vërtetë, edhe pse ata ishin njerëz që kishin ndryshime të skajshme nga aspekti i strukturës, ndërmjet sahabëve u formua një bashkim i tillë që të gjithë u bënë të njëjtë me njëri-tjetrin si shembulli i pikave të ujit në det, sepse ata u kyçën rreth një boshti. Ata gjithmonë u sollën rreth të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Qëndruan dhe u bënë një me atë. Në këtë mënyrë, edhe muhaxhirët, edhe ensarët, pra, që të dyja palët, vepruan sipas kënaqësisë hyjnore dhe fituan lavdërimin e Allahut të Lartësuar në kuptim të veçantë:

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!” (Teube, 100)

E gjithë çështja është të jetuarit sipas orientimit që të shpie te shpëtimi i madh, sepse, përderisa besimtarët t’i hedhin hapat e tyre sipas këtij orientimi dhe të rezistojnë me qëndrueshmëri, edhe ata që

nuk u premtan jeta për ta arritur rezultatin do të marrin shumë shpërblime hyjnore. Kjo është mjaft e qartë në këtë deklaratë hyjnore:

“Kush mërgon për çështjen e Allahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në tokë. Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t’i vijë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë. Se Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” (Nisa, 100) Nisur nga ky ajet, esenca e përpjekjeve të besimtarëve është hixhreti / mërgimi për çështjen e Allahut dhe të Pejgamberit (s.a.s.). Ndërsa esenca e kësaj është solidariteti dhe sakrifica e mbushur plot e përplot me mirësi rreth boshtit të vëllazërisë. Esenca e që të dyjave këtyre që thamë është përpjekja për fenë. Atëherë, rezultati që do të arrihet shprehet qartazi në këtë të vërtetë kuranore:

“...Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon fenë e Atij. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm.” (Haxh, 40) Mesazhi është mjaft i qartë: Allahu i Lartësuar, i Cili është poseduesi i vetëm i fuqisë absolute, nuk ka nevojë për ndihmë në asnjë mënyrë, ndërsa ne kemi nevojë për ndihmë. Dome thënë, në të vërtetë Ai do të na ndihmojë ne dhe si rezultat i kësaj ndihme që do të na japë, kërkon që



ta ndihmojmë fenë e tij. Ai dëshiron të shohë përpjekjet tona në rrugën e fesë dhe të bëhemi robër të përshtatshëm e meritore të ndihmës së Tij. Përveç të tjerash thotë:

“O ju që keni besuar! Bëhuni ndihmësit e Allahut, ashtu siç u tha dishepujve Isai, i biri i Merjemes: “Kush janë ndihmësit e mi për çështjen e Allahut?” Dishepujt u përgjigjën: “Ne jemi ndihmësit e Allahut!” Kështu, një pjesë nga bijtë e Izraelit e besoi, kurse pjesa tjetër e mohoi. Prandaj Ne i forcua besimtarët kundër armikut të tyre dhe ata dolën ngadhënjimtarë.” (Saff, 14)

Sigurisht se Allahu Teala është Ai që i ndihmon robërit e Tij, vetëm se Ai këtë e realizon në sajë të veprave. Për këtë arsye, kuptimi i ajetit fisnik nga një aspekt është: “O ju që keni besuar! Përpiquni edhe ju që të merrni pjesë nga ndihma që do t’u jap robërve të mi! Këtë bëjeni, në mënyrë që edhe ju t’ju rrethojë ndonjë pjesë e mëshirës sime. Kjo le të jetë mundësia juaj për shpëtimin e përhershëm!” – sepse kjo botë është e mbushur plot me mundësi të tilla.

Siç dihet, fuqia e vetme që e mban në jetë çdo gjallesë është Allahu Teala. Por Ai e ka bërë ujin një mundësi, e ka bërë ushqimin një mundësi, e ka bërë ajrin një mundësi... Pra, ka krijuar shumë mundësi dhe e ka mbushur jetën me to. Për këtë arsye, secila krijesë ka vlerë sipas kapacitetit të saj. Përse është i nderuar uji? Sepse është damari jetik i njeriut. Atëherë si mund të bëhet njeriu më i nderuar se uji i bekuar dhe se të gjitha krijesat e tjera? Sigurisht se duke kryer detyra më të vlefshme dhe duke dhënë rezultate më të mira se krijesat e tjera. Ja, shprehja më kulmore e kësaj është: “Ndhima ndaj Allahut Teala!” Por Ai nuk ka nevojë për asgjë! Prandaj qëllimi këtu është që të bëhemi shkak për ndihmën që dëshiron Ai. Kjo theksohet plotësisht qartë në ajetin fisnik të mëposhtëm:

“O ju që keni besuar! Nëse e ndihmoni Allahun (nëse e zbatoni fenë e Allahut dhe përpiqeni për ta përhapur atë; përveç të tjerash, nëse i ndihmoni nevojtarët, të varfrit dhe emigruesit), **edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në**

këmbët tuaja.” (Muhamed, 7)

Për ta arritur këtë, duhet të bëhemi si shembulli i ensarëve qoftë në përpjekjet për ta përhapur fenë e vërtetë dhe qoftë në ndihmën materiale ndaj të varfërve dhe njerëzve në nevojë, sepse Allahu i Madhëruar e konsideron si ndihmë ndaj Tij çdo ndihmë që i jepet fesë së Tij. Gjithashtu, edhe ndihmën që u jepet të varfërve, të vetmuarve, skamnorëve dhe emigruesve e konsideron si ndihmë të bërë ndaj Tij. Kjo na bën të mendojmë se, kush është poseduesi i vërtetë i fesë? Kush është ai që i mbron në të vërtetë të varfrit, skamnorët dhe ata që bëjnë hixhret? Sigurisht që Zoti i Lartësuar. Për këtë arsye, Mevlana na paralajmëron veçanërisht në lidhje me çështjen e bujarisë kundrejt të varfërve duke thënë:

“Njeriu i varfër është pasqyrë e bujarisë. Prandaj mos e njollos pasqyrën duke i thënë atij fjalë që ia thyejnë zemrën! Fakti që ka robër të varfër në caktimin e Allahut Teala është një bujari tjetër e ndryshme e Zotit (xh.xh.). Allahu i Lartësuar i bën ata të varfrit që të shkojnë te bujarët dhe t’u tregojnë për hallet e tyre. Në sajë të kësaj, përgatiten rrugët e humanizmit dhe mirësisë për të pasurit që e duan mirësinë. Edhe një tjetër bujari e ndryshme e Allahut Teala është e vërteta se ngjall në zemër të të pasurve ndjenjat e mëshirës dhe dashurisë ndaj të varfërve dhe ua mundëson atyre që t’i ndihmojnë. Ja, për këtë arsye, njerëzit e varfër në të vërtetë janë pasqyrat e bujarisë së Allahut të Madhëruar.”

E gjithë çështja është që të arrijmë ta kuptojmë bujarinë dhe ta përjetojmë si ensarët. Njerëzit e tillë janë shumë të paktë. Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e ka shprehur këtë duke thënë: “O njerëz! Njerëzit po shtohen, por ensarët po pakësohen. Madje, do të pakësohen aq sa kripa në ushqim...” (Buhari, Menakibu’l-Ensar, 11.)

Shprehje shumë e rrallë dhe e pashoqe: Nga njëra anë deklarohet se ensarët do të pakësohen nga aspekti i prejardhjes dhe nga ana tjetër, nisur nga aspekti i bujarisë së ensarëve, shpjegohet se do të pakësohen njerëzit që do të marrin përsipër detyrën e bujarisë siç e morën përsipër ensarët. Me të vërtetë

“O NJERËZ!
ZJARRI I PAFIKSHËM
PËR TË CILIN PO FLISNI
ËSHTË NJË SHENJË HYJNORE.
DIJENI MIRË SE AI ËSHTË NJË
TRAGJEDI E SHKAKTUAR NGA
KOPRRACIA QË KENI BRENDA. PËRSËRI
DIJENI MIRË SE ZJARRI I KOPRRACISË
NUK FIKET ME UJË, POR SHUHET VETËM
ME NDIHMË NDAJ TË VARFËRVE DHE
SKAMNORËVE. AI ZJARR SHUHET DUKE U
DALË PËR ZOT NJERËZVE NË NEVOJË.
AI ZJARR SHUHET DUKE U ZGJATUR
DORËN NJERËZVE TË DOBËT. AI ZJARR
SHUHET DUKE I NDIHMUAR PËR HIR
TË ALLAHUT SI SHEMBULLI I
ENSARËVE MYSLIMANËT
QË KANË EMIGRUAR
PËR TE NE.”

një shprehje e pashoqe: Ata do të jenë të paktë sa kripa në gjellë, por krahas kësaj, shija e ushqimit është e lidhur krejtësisht me ata. Jo vetëm shija e ushqimit, por edhe shërimi i dhimbjeve drithëruese të përhapura në të gjithë botën është i lidhur krejtësisht me ata. Gjithashtu, edhe shuarja e zjarreve të halleve që s' dinë të marrin fund prej shumë vitesh në Egjipt, Siri, Irak, Palestinë dhe në shumë vende të tjera islame, është e lidhur krejtësisht me ata.

Një herë ishte një udhëheqës i drejtë dhe largpamës. Kjo ishte periudha e Umerit. Në vendin ku jetonte, një ditë ra një zjarr i tmerrshëm. Zjarri digjte gjithçka dhe e shndërronte në hi. Madje i digjte edhe gurët sikur të ishin dru. Zogjve që kalonin mbi flakët e këtij zjarri, u digjeshin krahet. Gjysma e shtëpive që gjendeshin në këtë qytet të madh u ishin dorëzuar flakëve. Ata nuk po arrinin ta merrnin nën kontroll dhe ta shuanin zjarrin. Edhe uji nuk po e shuante dot atë zjarr. Edhe uji më i freskët shndërrohej në një flakë tjetër. Njerëzit u habitën dhe shkuan me vrap drejt e te udhëheqësi i tyre. Të shqetësuar e pyetën:

“O udhëheqës largpamës! Këtë zjarr të tmerrshëm nuk po e shuan dot as uji. Kemi ngelur pa asnjë zgjidhje. Çfarë të bëjmë?” Udhëheqësi me përvojë dhe largpamësi u dha një përgjigje tjetër që ata nuk e prisnin aspak: “O njerëz! Zjarri i pafikshëm për të cilin po flisni është një shenjë hyjnore. Dijeni mirë se ai është një tragjedi e shkaktuar nga koprracia që keni brenda. Përsëri dijeni mirë se zjarri i koprracisë nuk fiket me ujë, por shuhet vetëm me ndihmë ndaj të varfërve dhe skamnorëve. Ai zjarr shuhet duke u dalë për zot njerëzve në nevojë. Ai zjarr shuhet duke u zgjatur dorën njerëzve të dobët. Ai zjarr shuhet duke u ndihmuar për hir të Allahut si shembulli i ensarëve myslimanët që kanë emigruar për te ne.”

Atij i thanë: “O udhëheqësi i udhëheqësve! Ne në të vërtetë jemi njerëz humanë. Po ashtu, bëjmë mirësi të pafundme. Kështu që nuk e kuptuam atë që deshët të thoshit!” Përgjigja që u dha udhëheqësi përsëri ishte e jashtëzakonshme dhe largpamëse:

“Po, ju bëni mirësi, por në një kafshatë që jepni ka shumë shtirje. Në një mirësi tuajën ka shumë mburrje, mendjemadhësi dhe përçmim. Ju i bëni mirësitë tuaja vetëm për zakon. Çdo gjë bëhet për shtirje. Ndërsa në aspektin shpirtëror janë plotësisht koprraci. Ja, për këtë arsye nuk shuhet zjarri që ka rënë në qytet. Nëse me të vërtetë dëshironi ta shuanit atë zjarr, shfaqni një bujari në formë adhurimi duke

i qëndruar larg mburrjes, mendjemadhësisë dhe shtirjes! Jepni edhe ju shumë siç u ka dhënë Allahu shumë. Vetëm se kur ta bëni këtë, bëjeni për hir të Allahut. Pra, veproni pikërisht siç kanë vepruar ensarët e nderuar! Mos jepni vetëm prej mundësive tuaja materiale, por jepni edhe prej zemrës dhe shpirtit! Jepeni edhe dijen, edhe urtësinë tuaj! Çdo gjë që ta jepni, jepeni me pjekuri dhe mirësi! Jepni jo duke pritur falënderim nga tjetri, por përkundrazi, duke e falënderuar ju atë! Domethënë, jepuni fukarenjve duke u nisur nga konteksti i detyrës dhe jepini Allahut duke u nisur nga natyra e saj! Dorëzohani Atij atë që është e Atij!”

Nëse e shikoni çështjen nga një kornizë e tillë, do të vini re se ka të varfër shpirtëror që presin bujari të veçantë ndërkohë që ka edhe të varfër që presin bujari nga aspekti material në çdo vend të botës. Edhe të varfrit e udhëzimit, të varfrit e moralit dhe të varfrit e humanizmit veçanërisht presin zemrat bujare të mbushura plot me mëshirë që mund t'ua shtrijnë atyre dorën e ndihmës. Për sa i përket çështjes së dhënies në rrugë të Allahut, duhet të zëmë vend dhe të japim pikërisht si ato zemra.

Ja, pikërisht atëherë do të shuhet ai zjarri i tmerrshëm. Pastaj do të shuhet edhe shumë zjarre të tjera! Ejani, nxitoni dhe vraponi për të ndihmuar para se flakët të marrin përmasa edhe më gjigande! Koha nuk pret. Tani është koha për t'u bërë ensarë...

Tani, krahas durimit dhe rezistencës që duhet të shfaqin vëllezërit tanë që janë detyruar të shpërngulen nga vendet e tyre për shkak të zjarreve të pafundme të kësaj kohe, ka edhe një të vërtetë që duhet të mos e harrojnë asnjëherë. Kjo e vërtetë është fjala e parë që u pati thënë i Dërguari i Allahut, (a.s.), muhaxhirëve: “O muhaxhirë! Unë jam prej *jush*.” (Hejthemi, X, 14.)

Ndërsa një e vërtetë tjetër që asnjëherë nuk duhet ta harrojmë edhe ne si ndihmues të vëllezërve tanë muhaxhirë që kanë ardhur më parë apo tani prej vendeve të ndryshme është përsëri kjo fjala e parë që i Dërguari i Allahut (s.a.s.), u pati thënë ensarëve: “O ensarë! Unë jam *vëllai juaj!*” (Hejthemi, X, 14.)

Lum për atë që është prej të Dërguarit të Allahut!

Lum për atë që është vëlla me të Dërguarin e Allahut!

Lum për ata që janë muhaxhirë dhe ensarë të vërtetë!



Hutbe
të zgjedhura

SI DUHET TË REAGUJMË NDAJ PROVOKIMEVE?

— Naim Drijaj —

Të gjithë ne jemi dëshmitarë, se çfarë shkruhet në gazetat e përditshme për ne, për gjithë myslimanët, e dimë se çfarë flitet në televizionet tona. Të gjithëve na dhemb zemra për situatën në të cilën ndodhemi. Por ne duhet t'i lutemi Allahut që ta përmirësojë gjendjen tone. O Zot bashkoji zemrat tona, o Zot mos fut përçarje në zemrat tona, o Zot përmirësojë gjendjen tonë”.

Çdo besimtarë ndihet keq, kur shikon se e keqja po triumfon dhe e drejta nuk duket askund. Nuk është habi ta ndjesh diçka të tillë, sepse këtë e kanë ndjerë njerëz më të mirë se ne, e kanë ndjerë profetët e Zotit bashkë me besimtarët.

Aq ngushtë e kanë parë veten saqë kanë thënë:

“O Zot kur do të vijë ndihma Jote!” Allahu (xh.sh.) thotë: **“Ndihma e Zotit është shumë afër”**.¹ dhe pastaj ka ardhur ndihma e Zotit.

Ky umet nuk mund të zhduket kurrë. Ai mund të dobësohet dhe të pasojë disfata, por përsëri forcohet dhe kthehet edhe më i fortë se ç'ishte më parë. Kjo pasi ky umet mban në tokë fjalën e fundit të Allahut, Kuranin. Allahu (xh.sh.) thotë: **“Vërtet, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe Ne do ta ruajmë atë me siguri”**.² **“Ne do t'i ndihmojmë të dërguarit Tanë dhe besimtarët”**.³ Pejgamberi (a.s.) ka thënë: **“Gjithsesi kjo fe do të arrijë aty ku ka arritur nata dhe dita.”**

Feja islame ka kaluar shumë kriza qysh nga lindja e saj, por pas çdo krize ka dalë edhe më e fortë se ç'ishte më parë. Këtë na e dëshmon vetë historia. Me vdekjen e Hatixhes dhe Ebu Talibit, dy njerëzit të cilët e përkrahnin dhe e mbrojnë më tepër Pejgamberin (a.s.) torturat dhe përndjekjet ndaj myslimanëve u shtuan edhe më shumë. Por, në këtë kohë Allahu i madhëruar i urdhëroi myslimanët të emigronin për në Medine, ku shpëtuan nga politeistët e Mekës.



Në ditët e sotme ajo që na gëzon shumë neve si myslimanë është rizgjimi i rinisë islame, të cilën e shohim në çdo vend.

SI DUHET TË REAGJIMË NDAJ PROVOKIMEVE? REAGIMI YNË MË I MIRË ËSHTË REAGIMI QË NA KA MËSUAR ALLAHU (XH.SH.) NË SUREN EL-ASR E CILA KA ZBRITUR NË MEKE DHE KA TRE AJETE.

1- Pasha kohën! Koha-ky thesar kaq i çmuar që shumëkush nuk ia di vlerën është problemi më i madh që duhet të preokupojë çdo mysliman në ditët e sotme.

2- Me të vërtetë, njeriu është në humbje

3- Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.⁴

Një nga dijetarët e islamit ka thënë: “Sikur myslimanët të meditnin dhe të thelloheshin në kuptimin e kësaj sureje do ju mjaftonte atyre”.

Imam Shafiu ka thënë: “Sikur njerëzve mos t’u kishte zbritur sure tjetër përveç kësaj sureje do ju mjaftonte atyre”.

1. Reagimi ynë më i mirë është duke njohur, mësuar dhe kuptuar fenë tonë siç duhet. Myslimani duhet të pajiset me dituri të saktë nga e cila rrjedh edhe besimi i saktë. Hapi i parë i reagimit është me dituri fetare dhe shkencore.

2. Duhet të punojmë me diturinë sepse dituria pa punë nuk ka vlerë. Duhet të bëhemi shembull në çdo punë. Duhet që ta ringjallim praktikisht jetën e Pejgamberit (a.s.) në moral, sjellje, ko-

munikim durim etj. Ky do të ishte reagimi ynë më i mirë i mundshëm.

3. Duhet ti ftojme njerëzit në fenë e Allahut duke i këshilluar të vërtetën. Atëherë do të ndryshojë gjendja jonë. Energjinë dhe pasurinë që kemi duhet ta përdorim në rrugë të Allahut.

Tek Imam Maliku (r.a.) ka ardhur një delegacion nga Iraku dhe i kanë thënë: “O Imam! në vendin ku ne jetojmë janë përhapur shumë besëtytni dhe shumë gjëra që janë në kundërshtim me islamit” Si të veprojmë? Imam Maliku (r.a.) nuk u ka thënë atyre merruni me ata mos i lini pa përgjigje por u ka thënë: Përhapeni sunetin e Profetit (a.s.) se ata do të dështojnë.

Allahu i Lartësuar për Profetët thotë: “*Ata shpejtonin në vepra të mira*”.⁵ Dhe duke folur për cilësitë e robërve të Tij të devotshëm Allahu (xh.sh) thotë: “*Ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët*”.⁶

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kush thërret për në udhëzim, ai do të ketë shpërblimin e të gjithë atyre që do ta ndjekin, duke mos u pakësuar atyre asgjë nga shpërblimet që meritojnë. E ai që thërret për në humbje, ai do të ketë gjynahet e të gjithë atyre që do ta ndjekin, duke mos u pakësuar atyre asgjë nga gjynahet që meritojnë”.⁷

4. Duhet të bëjmë durim në të gjitha aspektet si p.sh ndaj akuzave që na bëhen etj.

Allahu (xh.sh) thotë: “*Përfundimi (i mirë) është për (të devotshmit) ato që ruhen nga të këqijat*”.⁸

■ **REFERENCAT:** 1) Bekare, 214. 2) Hixhr, 9. 3) Gafir, 51. 4) Sa më shumë që koha kalon, aq më tepër njeriu i afrohet humbjes, nëse nuk plotëson katër kushte që kanë të bëjnë me përsosjen e tij personale dhe përsosjen e të tjerëve: besimi tek Allahu dhe te gjithçka që Ai ka urdhëruar të besohet, kryerja e veprave të mira, qofshin këto vepra fizike apo shpirtërore, këshillimi i të tjerëve me këtë të vërtetë dhe këshillimi i tyre që të durojnë në përpjekjen e tyre për t’iu përmbajtur urdhrave të Allahut dhe për të duruar sprovat e dhembshme dhe të vështira që mund të ketë paracaktuar Ai. 5) Enbija, 90. 6) Mu’minun, 61. 7) Muslimi. 8) Kasas, 83.

Lakmia dhe sakrifica...

— Ahmet Zizlan —

Paraja është edhe mirësi, edhe bela. Pasuria është edhe mirësi, edhe fatkeqësi... Këtë e shkaktojnë shumë shkaqe të ndryshme. Njëri prej këtyre shkaqeve janë njerëzit e shumtë që kanë lakmi. Me këtë po deshët nënkuptoni ata që kanë smirë e zili, apo po deshët nënkuptoni ata që me të vërtetë u nxihen sytë për shkak të nijetit të keq. Prandaj pasuria nganjëherë mund të shndërrohet edhe në fatkeqësi. Për këtë arsye, njerëzit që kanë mundësi ekonomike duhet të kenë shumë kujdes ndaj njerëzve që i rrethojnë. Ata nuk duhet ta shfaqin veten të fuqishëm.

Përpjekja për t'u shfaqur më i pasur dhe më i fuqishëm seç je, mund t'i shkaktojë probleme njeriut. Por për fat të keq, njerëzve u mësohet plotësisht e kundërta e kësaj.

Në Kazakistan kam pasur një të njohur turk. Ndërsa po bisedonim një ditë, i thashë: "Paraqitja jote duket më e madhe seç je." "Për shembull?" – më pyeti. Unë iu përgjigja: "Ti je te dhjeta nga aspekti i pasurisë dhe fuqisë, por pamja jote tregon sikur je te pesëdhjeta." Ai ma ktheu: "Atëherë do të thotë se paskam mangësi! Unë duhet të shfaqem një-



qind, sepse kjo kohë u jep vlerë të pasurve dhe të fuqishmëve.” Por në ajetin fisnik thuhet kështu: “...*Jini të drejtë!*..” (Hud, 112; Shura, 15.) Pra, të jemi të devotshëm dhe të veprojmë sipas urdhrave të Zotit (xh.sh.). Të vërtetën nuk duhet ta shprehim vetëm me gjuhë, por atë duhet ta reflektojmë edhe me gjendjen tonë... A nuk do të ishte devijim nga rruga e drejtë përpjekja për t’u shfaqur i ndryshëm nga seç je? A nuk do të ishte mashtrim i njerëzve kjo gjë? Çfarë thotë Hazreti Mevlana: “Ose duke siç je, ose ji siç dukesh!”

Për fat të keq, në kohën tonë po përballemi me gjëra mjaft shqetësuese. Biseda që zhvillohen me plot mendjemadhësi, shfaqjet e tepërta të mburrjes, lavdërimet duke u veshur me rroba firmato dhe shtirjet duke bërë shpenzime kolosale. Këto janë veprime që e kalojnë cakun...

Në të kaluarën nuk ka qenë kështu. Atëherë ka pasur rregulla të mrekullueshme. Për shembull: Nëse një njeri do të merrte disa kilogram mish, ato nuk i merrte prej kasapit kur aty gjendeshin edhe njerëz të tjerë, por priste derisa të largoheshin ata. Nëse blinte fruta, perime e gjëra të tjera të ngjashme me to, i fuste në shportë duke i mbuluar me ndonjë copë, në mënyrë që të mos i shikonin të tjerët. Këtë e bënte që të tjerëve të mos u ngelnin sytë te ato që kishte blerë. Kur njerëzit gatuanin në shtëpitë e tyre, tregonin kujdes që aroma e ushqimit të mos përhapej. Ata bënin kujdes në këtë çështje, në mënyrë që të mos i shkonte mendja edhe fqinjët. Por edhe nëse gatuanin ushqime që përhapnin aromë të këndshme, patjetër u çonin edhe fqinjëve.

Tani le të tregojmë dy histori të përjetuara/të vërteta në lidhje me ato që mund t’i ndodhin njeriut nëse shfaqet më i madh seç është. Këto dy histori le të gdhenden mirë në mendjet tona:

Pas luftës së çlirimit, në një fshat ishte vrarë një person. Për këtë vrasje kishin kapur një burrë që s’kishte lidhje me të dhe e dënuan me burg duke i thënë: “Ti e ke vrarë atë.” Edhe pse burri u kishte thënë: “Unë nuk e kam vrarë.” – gjykata e kishte dhënë verdiktin e saj dhe faji i kishte ngelur atij. Pasi kishte vuajtur për vite me radhë në atë burg, ngjarja ishte zbardhur dhe ishte gjetur vrasësi i vërtetë. E nxorën nga burgu burrin që kishte me vite aty brenda. Të turpëruar e kishin pyetur:

“Ti ke qëndruar në burg për kaq shumë vite ndërkohë që ke qenë i pafajshëm. Por asnjëherë nuk të kemi dëgjuar të bërtasësh me të madhe. Asnjëherë nuk the duke bërtitur: Unë jam i pafajshëm. Përse po më fusni në burg?” Burri e kishte ulur kokën dhe ishte përgjigjur: “Unë jam fajtor.” Ata e pyetën: “Si qenke fajtor? Fajtori i vërtetë doli në pah.” Burri u tha: “Unë nuk jam fajtor për ngjarjen e asaj vrasjes,

por jam fajtor për një vrasje tjetër!..” “Ashtu?!” – i thanë ata. Burri kishte filluar të tregonte historinë e tij të zezë:

“Kur u lirova nga ushtria dhe po kthehesha në shtëpi, në rrugë u takova me një ushtar tjetër. Edhe ai ishte liruar nga ushtria dhe po kthehej në vendlindjen e tij. Të dy bashkë morëm rrugën për një kohë të gjatë. Përgjatë gjithë rrugës më thoshte: “Atje ku shkova fitova dhe mblodha kaq para. Kur të kthehem në vendlindje, do të marr këtë e atë.” Duke ecur, arritëm te një pus. Morëm ujë nga pusi, pimë, lamë duart e fytyrën dhe morëm abdest. Për shkak të atyre që më tregoi, shejtani më hyri në zemër dhe ma tërboi nefsën. Me vete thashë: “Ky duhet të ketë shumë para!” Prandaj vendosa ta vrisja dhe t’i merrja paratë.

Filluam të falnim namazin. Atë e nxora imam. Kur ra në sexhde, iu binda shejtanit dhe ia ngula thikën në kurriz. Ai vdiq. Menjëherë i kontrollova të gjithë xhepat dhe trupin, por nuk kishte asgjë! Ai nuk kishte as para dhe as florinj! Madje, nuk kishte asnjë qindarkë. Për fat të keq, ai më ishte mburrur përgjatë gjithë rrugës. Ai ia përgatiti fundin vetes me gjuhën e tij. Unë pastaj u pendova shumë, sepse u bëra vrasës për asgjë. Atë e varrosa dhe askujt nuk i thashë gjë për të. Arrita në fshat. Askush nuk më kërkoi dhe nuk më pyeti për atë vrasje, sepse askush nuk e dinte se unë isha takuar me atë. As të afërmit e tij nuk më njihnin mua, as unë nuk i njihja të afërmit e tij. Çështja do të mbyllej dhe do të harrohej, por pa kaluar shumë kohë, në fshat u vra një burrë. Për vrasjen më akuzuan mua. Unë nuk kundërshtova ngaqë e mbaja mend krimin që kisha bërë më parë. Për këtë arsye, iu nënshtrova fatit. Unë e meritoja këtë ndëshkim.”

Mesazhi që mund të nxjerrim nga historia: “Drejtesia e gjen vendin e saj!”

Pasuria, paratë... Njeriu asnjëherë nuk duhet të lavdërohet me këto. Veçanërisht duhet të dijë t’i fshehtë sekretet tregtare dhe financiare. Tamahu ndaj parasë dhe pasurisë është një katastrofë në të cilën mund të bjerë njeriu. Për këtë arsye, nuk duhet të shfaqim tamah ndaj askujt. Përveç të tjerash, duhet të ruhem i qetë nga syri i keq, smira dhe nijeti i keq...

Historia tjetër:

Dy burra endacakë po ecnin bashkë. Gjatë rrugës panë një burrë tjetër që ishte shtrirë duke fjetur nën hijen e një peme. Njëri prej këtyre endacakëve e kishte nxitur atë tjetrin duke i thënë: “Shiko, ky i paska këpucët e reja. A t’ia vjedh këpucët?” Endacaku tjetër e kishte pyetur: “Si mund t’ia marrësh? Ai i paska vënë ato nën kokë...” Ai ia ktheu: “Shiko se si do t’ia vjedh! Eja me mua!..”

Ata të dy kaluan në anën tjetër të pemës. Morën diçka në dorë dhe filluan të gërmonin dheun. Burri që po flinte u zgjua kur i dëgjoi zërat. Ai u zgjua, por ngaqë nuk i njihte se kush ishin ata dy endacakët, vazhdoi të bënte sikur po flinte. Të dy shokët endacakë hapën një gropë dhe pastaj e mbyllën. Gjithashtu bënë edhe një bisedë ndërmjet tyre si kurth për burrin që po flinte. Pastaj filluan të flisnin me zë të ulët gjoja sikur tani e panë atë që po flinte:

-Ore, ne paratë i groposëm këtu, por ky njeri qenka shtrirë e po fle pikërisht këtu. Po nëse ky njeri na ka parë apo na ka dëgjuar? Po nëse ngrihet dhe i merr paratë pasi të ikim ne?

-Jo, jo, a nuk e shikon? Ai është zhytur në një gjumë të thellë.

-Nuk i dihet. Le ta provojmë një herë dhe të shohim nëse po fle apo jo...

-Si do ta provojmë?

-Le t'ia tërheqim dalë nga dalë këpucët që i ka te koka. Nëse lëviz, do të thotë se ka qenë zgjuar. Nëse ka qenë zgjuar, duhet t'i marrim paratë. Nëse nuk bën zë, atëherë do të thotë se është në gjumë të thellë. Nëse është në gjumë, nuk ka ndonjë problem."

Burri që po bënte sikur po flinte, u mashtrua nga ky kurth. Endacakët shkuan dhe ia tërhoqën këpucët që kishte nën kokë. Burri vazhdonte të bënte sikur po flinte, sepse pandehte se do të merrte paratë që kishin groposur ata. Ai mendoi: "Çfarë problemi ka nëse ikin këpucët? Sidoqoftë do të marr gjithë ato para."

Të dy hajdutët ia morën këpucët dhe u larguan. Kur burri që po flinte u sigurua se ata u larguan, menjëherë u ngrit dhe e hapi gropën që e kishin mbuluar ata. Por sado që gërmoi, nuk gjeti asnjë gjë.

Në këtë mënyrë, të dy endacakët ia morën këpucët burrit që po flinte para syve të tij. Si arritën t'ia merrnin? Me karrem... Gjuetia në shumicën e rasteve bëhet me karrem. Në majën e grepit gjithmonë vendoset një karrem. Po të mos vendosej karremi cili peshk do të shkonte dhe ta kapte grepin me gojë? Pra, karremi është kamuflazhi i kurthit.

Edhe disa prej mashtruesve janë të tillë. Ata hedhin një karrem që njeriu mund ta lakmojë shumë. Në këtë mënyrë, ndërkohë që njeriu mendon se do të vendos një dhe do të fitojë tre, humbet edhe atë që ka.

A të gjithë njerëzit janë të këqij? Le të mos biem në pesimizëm, por asnjëherë të mos e harrojmë edhe ekzistencën e të keqes dhe të keqit. Sugjerimi ynë

nuk është që të fshihemi apo ngujohemi, por të mos mburremi dhe të mos lavdërohemi, sepse shfaqjet e tilla tërheqin vëmendjen e njerëzve.

Njerëzit në përgjithësi përpiqen të matin fuqinë e njëri-tjetrit, sepse, është e lehtë që t'ia marrësh më lirë mallin dikujt që ka rënë në gjendje të vështirë. Për këtë arsye, njeriu nuk duhet ta shfaqë vështirësinë ekonomike nëse ka rënë në një gjendje të tillë. Edhe kjo histori është një shembull domethënës për këtë:

Kërogllusë (gjykatësit) i kishin sjellë një çështje gjyqësore. Një djalë i ri kishte marrë vajzën e një burri pa dëshirën e këtij të fundit. Më së fundi e kishin kapur të riun dhe e kishin sjellë. Babai i vajzës ishte i nxehur dhe thoshte: "E akuzoj atë për marrjen e vajzës sime. E akuzoj."

Kërogllu ishte kthyer nga djali i ri dhe e kishte pyetur: "Përse e more vajzën ti?" I riu ia ktheu: "Ja kërkova dorën e vajzës, por ai nuk ma dha. Unë e desha atë vajzë, prandaj edhe e mora." Pastaj Kërogllu ishte kthyer nga babai i vajzës dhe i kishte thënë: "Mirë, po ti përse nuk e dhe vajzën?" Babai i vajzës ishte përgjigjur: "Pa shikoje një herë gjendjen e tij! Për çfarë t'ia jap vajzën atij? Ai nuk ka as rroba për të veshur. Nuk ka as shpi e as katandi. Ai nuk mund të ngopë me bukë as veten. Atëherë si mund të përkujdeset për bashkëshorten?"

Kërogllu në ato momente kishte bërë një manovër. Ishte kthyer nga djali, kishte bërë sikur i ishte nxehur dhe i kishte thënë: "Bir, përse nuk i ke thënë babait të vajzës se ti ke njëqind dele dhe dy lopë ndërmjet kafshëve tona?.." Babait të vajzës i ishin hapur sytë dhe kishte pyetur: "Me të vërtetë ky djalë i ri ka njëqind dele dhe dy lopë?" Kërogllu i ishte përgjigjur: "Po, i ka..." Në ato momente, babai i zemëruar ishte shndërruar në një engjell dhe ishte shprehur: "Përse nuk më ke thënë more bir? Meqë qenka kështu..." Kërogllu menjëherë kishte thënë:

"Atëherë nuk ngeli më gjë për t'u sqaruar. Puthe bir dorën e babait!.." Kërogllu e kishte rregulluar këtë çështje duke dhënë pak prej pasurisë së tij. Pasuria i pajton njerëzit. Edhe neve na ka ndodhur që të bëjmë pajtime pikërisht si të Kërogllusë:

Kemi pasur një të afërmin tonë. Kjo ka ndodhur para shumë vitesh. Një ditë shkova për ta vizituar. Kur e pyeta për gjendjen, ma ktheu: "Po vdesim dhe po ngjallemi përsëri." Unë e pyeta: "Çfarë do të thotë kjo?" Ai mu përgjigj: "Bijtë e mi patën punuar si dy vëllezër ortakë. Pastaj u ndanë. Kur u ndanë, lindën kontradikta ndërmjet tyre. Njëri thotë: 'Unë kam tetë milion për të marrë prej teje.' Tjetri i thotë: 'Nuk ke asgjë për të marrë prej meje!' Vëllai i vogël

i thotë se ka një dokument që e vërteton se ka për të marrë tetë milion nga vëllai më i madh. Ai tjetri i thotë se nuk ka asgjë për të marrë prej tij.

Ndërkohë që grindeshin për çështjen e parave, arritën deri në atë gjendje saqë djali i madh në praninë tonë mori hanxharin në dorë dhe deshi ta vriste vëllain e vogël. E ndoqi nga pas duke i rënë katër herë rreth e rrotull oborrit. Po ta kishte zënë, do ta kishte vvarë. Ata nuk dëgjojnë as fjalën e këshillën e nënës së tyre, as timen. Njëri prej tyre iku dhe u largua. Ata do ta gjejnë përsëri njëri-tjetrin dhe do të zihen. Nëse do të zihen përsëri, do ta vrasin njëri-tjetrin. Si mund ta durojë prindi këtë situatë! Nuk dimë çfarë të bëjmë. Bir, të lutem na ndihmo! Gjeji ata dhe këshilloji! Bëj ndonjë gjë dhe gjeje një rrugëzgjidhje!”

Pa mendoni: Edhe ai që ikte, edhe ai që e ndiqte me hanxhar ishin bijtë e tij! Pa mendoni për vuajtjen dhe dëshpërimin e atij. Njeriu tmerrohet nga kjo gjendje.

Njërin prej vëllezërve e gjeta dhe i thashë: “A nuk ju erdhi turp të ziheni para prindërve tuaj për para? A nuk e keni frikë Allahun?” Ai mu përgjigj: “Unë nuk jam zënë. Unë thjeshtë kam kërkuar të drejtën time. I thashë që kam edhe dokument që e vërteton të drejtën time. Prandaj do t’i marr ato para. Përse të mos i marr në fund të fundit? Edhe më nxjerrin jashtë, edhe nuk ma japin hakun tim.” Pasi u shpreh me këto fjalë, unë i thashë:

“Lëreni zënkën! Hiq dorë nga ato para! Të paktën hiq dorë nga gjysma e tyre! Gjeni një pikë të mesme dhe pajtohuni!” Ai ma ktheu: “Nuk bën aspak! Unë do t’i marr paratë e mia.” Pastaj shkova te vëllai i më i madh dhe i thashë: “Ju qenkeni zënë në prani të prindërve tuaj. A aspak nuk keni frikë nga Allahu? Përse i mërzisni ata? Le të gjejmë një pikë të mesme! T’i jepi gjysmat e parave, pastaj ai të heqë dorë nga gjysma tjetër e tyre! Në këtë mënyrë le të marrë fund kjo çështje. Si thua?” Ai mu përgjigj:

“Unë kam të drejtë. Madje jam viktimë e kësaj çështjeje. Edhe nëse vdes, nuk i jap gjysmat e atyre parave. Madje, as pesë qindarka nuk i jap. Ai po më bën padrejtësi. Ndërsa ju e mbroni atë!”

Pra, njëri thoshte se kishte dokument që mund t’ia jepte gjykatës dhe ta merrte hakun e tij, ndërsa tjetri thoshte se nuk jap as pesë qindarka edhe nëse vdes. Që të dy ishin të vendosur në këmbënguljen dhe inatin e tyre. Këshilla nuk u bënte dobi asnjërit prej të dy vëllezërve. Shkaku i kësaj ishte edhe varfëria... Të urtët kanë thënë: “Pasuria të pajton, varfëria të fut në grindje, ndërsa sakrifica të qetëson.”

Ata kishin edhe një vëlla tjetër në Stamboll. Ai nuk e kishte gjendjen e keqe. Vëllezërve të zemëruar

u thashë: “Me sa duket ju nuk do të hiqni dorë nga inati juaj. Prandaj këto para do t’i marr nga vëllai juaj në Stamboll. Ato para do t’ia jap atij që i kërkon. Ndërsa ai që nuk i jep, nuk do të paguajë gjë prej xhepit të tij. Të paktën këtë mos e kundërshtoni, në mënyrë që të marrë fund kjo zënkë.”

Pastaj veprova ashtu siç u thashë vëllezërve të zemëruar. Shkova te vëllai i tyre në Stamboll dhe bisedova me të. Atij i thashë: “Gjendja është kështu e kështu... Që të dy i ke vëllezër. Ata i kanë hipur kalit të shejtanit. Nëse ti i jep paratë për zgjidhjen e kësaj çështjeje, ai që i kërkon do t’i marrë paratë e tij dhe ai që nuk pranon, nuk do të paguajë gjë nga xhepi i vet. Në këtë mënyrë, do të zgjidhet çështja dhe do të marrin fund vuajtjet e prindërve tuaj.”

Ai ma ktheu: “A për ata i kam fituar paratë unë!.. Le të bëjnë çfarë të duan!..” Me sa kuptova, kjo çështje nuk do të zgjidhej. Për këtë arsye, i thashë: “Nëse ti e pranon këtë propozim, gjysmën e parave do ta jap unë. Atyre nuk do t’u tregoj se e kam dhënë unë gjysmën e parave. Nëse u tregoj, nuk do të pranojnë. Ndërsa ti je vëllai i tyre. Nëse i jep ti, ata do të pranojnë. Prandaj, paratë do t’ua japësh ti atyre. Ndërsa për mua nuk do të dinë asgjë.” Vëllai i tyre u mendua dhe mu përgjigj: “Në rregull atëherë!” Ne vepruam siç vendosëm dhe çështja u mbyll. Paraja nuk njeh as vëlla, as të afërm. Paraja është edhe mik, edhe armik.

Siç shohim çdo ditë, ka zënka dhe zemërimë të panumërta ndërmjet vëllezërve e motrave, ortakëve, të afërmeve, fqinjëve dhe së fundi ndërmjet besimtarëve... Një pjesë e tyre buron nga trashëgimia, një pjesë nga inati dhe një pjesë nga përçarja. Ndërkohë që themi: “Unë e di! Unë kam të drejtë!”, na nxisin edhe nefsi e shejtani dhe dalin në pah këto grindje e zënka të padëshiruara. Të gjithë do të shpërngulemi nga kjo botë e përkohshme. Prandaj, a ia vlejnjë këto grindje? Po të sakrifikojmë pak, çdo gjë rregullohet. Së fundi, gjithmonë fiton ai që sakrifikon.

Sido që ta quajmë pasurinë, para, pronë, mall apo diçka tjetër, ajo është një sprovë e madhe. Nëse atë nuk e mbajmë si mjet, menjëherë fillon dhe na fut në përçarje. Si rezultat dalin zënkat “unë kam të drejtë, ti ke të drejtë”. Në këtë mënyrë, nuk na ngelet as ëmbëlsi në gojë dhe as prehe në shpirt.

Ata që e dinë se pasuria është mjet i përkohshëm për sprovën në këtë botë dhe që pranojnë të heqin dorë prej saj apo ta sakrifikojnë, do të gjejnë prehe në të dy botët. Allahu i Lartësuar na ruajt nga e keqja e shejtanit, nga e keqja e nefsit, nga e keqja e përçarjes së hipokritit, nga e keqja e armikut, nga e keqja e pasurisë dhe varfërisë dhe nga e keqja e ephshit! Amin!..

Kafe Turke

PËR NJË JETË TË GJATË?

Çdo ditë, amvisat shqiptare përballen me mëdyshje, sfida dhe punë. Përpara se të përballen me këto sfida, tradita e kërkon një filxhan me kafe turke.

Shkencëtarët kanë kryer disa studime në lidhje me jetëgjatësinë e njerëzve në zonën e Ballkanit dhe të Mesdheut në përgjithësi të cilët pinë kafe turke ose siç njihet ndryshe kafeja e bluar imët.

KAFEJA TURKE: NJË HISTORI INTRIGASH POLITIKE DHE DASHURIE

Kafeja ka origjinën në Kaffa të Etiopisë, megjithatë emri i saj vjen nga Arabishtja. “Qahëa” përkthehet “Verë”.

Kafeja e parë është prodhuar në Jemen, ku shumë besimtarë pinin kokrrat e kafesë të tretura në ujë, për të qëndruar zgjuar gjatë lutjeve.

Nga Jemeni, në vitin 1517 kafeja rrugëtoi në Stamboll. Asokohe, Turqit zbuluan se me kokrrat e kafesë ata mund të përgatishin një pije të shijshme, të athët dhe me ngjyrë të zezë, me anë të së cilës mund të merrnin shumë energji dhe të shuanin urinë.

Kafeja u bë e preferuara e Sulejmanit të Madhërrishëm dhe Sulltaneshave. Sulltan Sulejmani u marros pas kafesë dhe i dha ‘pijes së zezë’ vulën perandorake.

Turqit shpikën metodën e përgatitjes së kafesë me zhezve. Ata i bluan kokrrat e kafesë shumë hollë

dhe i zien në ujë. Fisnikët e Oborrit të Sulltanit e kishin kafënë si kriter në përzgjedhjen e nuseve.

Nëse kafeja që një grua shërbente ishte e bluar dhe bërë mirë, atëherë ajo do të ishte një grua e shkëlqyer, thotë legjenda. Kafeja u kthye në një instrument edhe për vetë gratë.

Legjenda thotë se nëse ato servirnin një kafe të ëmbël atëherë do të thotë që ishin të lumtura me zgjedhjen e bashkëshortit. Nëse kafeja ishte e hidhur, bashkëshorti nuk u pëlqente.

Asokohe, sipas të dhënave, një grua e martuar kishte të drejtën të ndahej nga bashkëshorti, nëse ai nuk sillte kafe në shtëpi.

Shumë shpejt në të gjithë perandorinë Otomane u përhapën kafenetë e para të cilat vite më vonë u shpallën të paligjshme, sepse njerëzit qëndronin shumë gjatë në këto vende ku sipas spiunëve të oborrit thureshin kurthe dhe plane për vrasjen e sulltanit.

Në vitin 1656, ndëshkimi për këdo që kapej duke bluar kafe ishte kamzhiku dhe mbyrtja në det.

KAFEJA TURKE DHE JETËGJATËSIA

Në ishullin Ikaria të Greqisë, të gjithë banorët e nisin ditën me një kafe turke. Ky ishull gjithashtu njihet të ketë popullsinë më jetëgjatë në të gjithë vendin.



Kjo frymëzoi disa shkencëtarë të studionin efektin e kafesë dhe mënyrës së jetesës tek jetëgjatësia e njerëzve. 142 njerëz të grupmohave të ndryshme morën pjesë në studim.

Shkencëtarët morën në konsideratë edhe faktorë të tjerë si, gjinia, pesha, gjatësia, pirja e duhanit, sëmundjet e zemrës dhe hipertensioni.

Rezultatet e studimit treguan qelizat endoteliale tek njerëzit që pinin më shumë kafe turke, kishin një performancë më të mirë.

Këto qeliza kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në enët e gjakut.

Nëse ato nuk funksionojnë mirë, me kalimin e

kohës mund të shkaktojnë bllokimin e kapilarëve dhe enëve të gjakut, madje mund të shkaktojnë edhe vdekje të parakohshme.

Krahasimi mes grupmohave në studim tregoi se konsumi në rritje i kafesë turke ka një ndikim pozitiv në elasticitetin e arterieve. Kjo pakëson shanset e shfaqjes së tensionit të lartë të gjakut.

Kafeja turke përmban dy substanca të rëndësishme. Ato njihen si kafestol dhe kaheol, të cilat kanë vlera të mira kundër inflamacionit por edhe shërbejnë si antioksidantë.

Ju këshillojmë të mos e teproni me sasinë, pasi si çdo gjë, kur tepronet kthehet në dëm të shëndetit.

Hudhër, Limon dhe Mjaltë KOMBINIMI IDEAL

Të gjithë e dimë që nuk ka një kurë të mirëfilltë ndaj të ftohtit. Të dhënat shkencore tregojnë se në botë janë mbi 200 lloje virusesh të ndryshme që lenë si pasojë ftohjen.

Duke qenë se në kemi të bëjmë me shumë viruse, shpesh antibiotikët nuk kanë asnjë ndikim.

Të gjitha medikamentet që ne marrim kundër të ftohtit kanë si objektiv të luftojnë sëmundjet dhe jo shkakun.

Shumica e njerëzve arrijnë të shërohen vetë pa medikamente në një afat kohor prej 10 ditësh.

Ndonëse mjekësia ka debate mbi efikasitetin e kurave natyrale kundrejt antibiotikëve, këto të fundit janë shumë efektive. Ato e ndihmojnë organizmin të rimëkëmbet lehtë dhe shpejt.

Kura më efikase kundër të ftohtit që AgroWeb.org sugjeron si alternativë, është e bazuar në këshillat e ekspertëve më në zë të fushës.

MJALTË + LIMON + HUDHËR

Kjo recetë përfshin tre përbërës kryesorë: hudh-

rën, mjaltin dhe limonin. Hudhra duhet të jetë e freskët. Hudhra e vjetër humbet alicinën, që është edhe substanca më e vlefshme që i jep asaj aromën karakteristike. Sa më e fortë aroma, aq më mirë.

Limonët mund t'i gjeni në treg, por zgjidhni organikë. Mund të përdorni lëngun duke qenë se lëkura shpesh është e ndotur me kimikate.

Mjalti duhet të jetë organik pra puro. Këtë kurë mund ta përdorni për mbrojtje të fuqishme kundër infeksioneve dhe për të forcuar mbrojtjen e imunitetit.

Për këtë kurë ju nevojiten:

5-6 thelbinj hudhër

2-3 limonë, mundësisht duke përfshirë edhe pak lëkurë të grirë

5-6 lugë çaji me mjaltë.

Përziejini të gjithë përbërësit në një mikser deri sa lëngu të jetë i njëtrajtshëm. Ruajeni në frigorifer në enë qelqi.

Të rriturit, por edhe fëmijët mund të konsumojnë një lugë çaji, të paktën 2 herë në ditë.



ORA E ZGJUAR PA EKRAN

Të gjitha ata që mbajnë orë dore, e kanë shprehur që të shikojnë orën shumë shpesh, madje edhe pa nevojë. Derisa shumica, e harrojnë se sa është ora, vetëm pak sekonda pasi ta kenë shikuar. Për këtë arsye, është krijuar ora e zgjuar që nuk ka ndonjë mekanizëm lëvizës, as numra apo akrepa dhe në të nuk shfaqet asgjë. Nuk ka as ndonjë lidhje me Bluetooth apo Wifi, sepse nuk ka ekran. Vetëm mjafton të mbahet sipërfaqja e orës Prompt dhe nëpërmjet dridhjeve, mësohet se sa është ora.

Me një dridhje, nënkuptohet se janë 15 minutat e para të orës, me dy dridhje tregohet për të dy 15 minutat e dyta dhe kështu me radhë. Dritat që e rrethojnë orën, ndizen në atë mënyrë, që të tregojnë se cila orë është, me më shumë saktësi. Prompt është krijuar për ata që duan ta përjetojnë momentin dhe jo të masin gjithçka me orë apo minuta, derisa as nuk duken të pasjellshëm duke e shikuar gjithnjë orën. Në këtë formë, përdoruesit e Prompt konsiderohet se janë të dashur dhe gjithnjë me kohë.

REALITET TË ZMADHUAR: PAJISJA QË NDIHMON ZJARRFIKËSIT

Qwake Technologies e ka zhvilluar pajisjen që vendoset në sy të quajtur C-Thru, që iu mundëson zjarrfikësve të shohin edhe nëpër tym të dendur, derisa janë duke kryer intervenime.

Ky sistem punon me “realitetin e zmadhuar” dhe imazhet termale, duke i ndihmuar personit që është duke e bartur, të shohë edhe në tym të dendur dhe errësirë, transmeton Telegrafi.

Me C-Thru ilustrohen siluetat e objekteve, që i ka mbuluar tymi, duke i lënë të pa para.

Sistemi i C-Thru mundëson që zjarrfikësit, të zgjerojnë sa më shumë pamjen e tyre natyrale, nëpërmjet sensorëve të “realitetit të zmadhuar”.

Helmata që e kanë në kokë, është gjithashtu e lidhur me këtë sistem dhe bartë të dhënat e zjarrfikësit të parë të tjerët, duke e bërë komunikimin më të shpejtë dhe efektiv edhe në momentet më kritike.

Konsiderohet se C-Thru, mund të jetë mjeti i domosdoshëm i njësiteve të zjarrfikësve dhe njësiteve tjera për shpëtim, që do të ndihmojë për të shpëtuar jetë.






OBJEKTE 3D SHUMË TË DETAJUARA BRENDA VETËM DISA SEKONDAVE

Brenda vetëm disa sekonda, nëpërmjet një teknike 3D mund të prodhohen objekte shumë të detajuara. Hulumtuesit e Ecole Polytechnique Federale de Louissane, e kanë krijuar këtë teknikë që shfrytëzon një metodë, nëpërmjet së cilës, brenda 30 sekonda mund të prodhohet një objekt të ri të kualitetit të lartë.

Procesi fillon me përdorimin e një lëngu të tejudukshëm, që më pas vendoset në formë. Materiali i

përbërë nga rrjeti i qelizave, i ndihmon si strukturë në formë skelash, që të krijohet forma e caktuar, derisa zhvillohet në produktin e caktuar. Ky proces, i punon objektet shumë më të fuqishme dhe të dendura, s'ka objektet e krijuara në proceset e zakonshme të printimeve 3D, që krijohen shtresë pas shtrese. Nëpërmjet kësaj teknike, mund të krijohen objekte shumë të rëndësishme në të ardhmen, që do të ndihmonin në shëndetësi dhe bioprintime.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE NDIHMON NË ZBULIMIN E ANTIBIOTIKËVE TË FUQISHËM



Shkencëtarët kanë përdorur inteligjencën artificiale për të zbuluar një lloj të ri të antibiotikut që mund të vras disa nga bakteret më të rrezikshme në botë, rezistentë ndaj ilaçeve.

Një ekip nga Instituti i Teknologjisë në Masaçusets (MIT) thonë se algoritmi i tyre ishte në gjendje të identifikonte një strukturë të fuqishme antibiotike, e cila nuk zhvilloi asnjë rezistencë gjatë një periudhe trajtimi 30-ditësh tek minjtë.

Shkencëtarët pretendojnë se teknologjia AI është në gjendje të funksionojë më shpejt dhe me më shumë efikasitet sesa përpjekjet ekzistuese, sepse kontrollon më shumë se 100 milionë kamponime kimike brenda disa ditësh për të zgjedhur antibiotikët e mundshëm që shkatërrojnë bakteret.

Është trajnuar posaçërisht për të gjetur molekulat e mundshme të antibiotikëve të njohur për efektivitet kundër rritjes së E.coli. Molekula, e quajtur halicin, doli efektive kundër E.coli dhe skuadra shpreson ta studiojë atë më tej me shpresën për ta zhvilluar atë për përdorim te njerëzit. Përdorimi i makinerive që mund të trajnohen për të zhvilluar përdorimin e ilaçeve mund të zvogëlojë koston e antibiotikëve në të ardhmen dhe të hapë tregje të reja që synojnë sëmundje të pa-tatueshme.



Souvenir Albania



*tregton me shumicë dhe pakicë
punime artizanale të cilësisë së lartë.*





"LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orndive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëplaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesuarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mvëshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress te balloreve me folje te pvc-se në dimensione të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin –qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina te persosur kualitet dhe cilësi te lart.






VILA DANTE
RESTORANT

 ADRESA: TUSHEMISHT, POGRADEÇ

SHOPPING HOUSE


ADRESA:
RRUGA QEMAL DRAÇINI
TEK SAHATI, SHKODËR

ÇAPA[®] musluk



REYHAN

Kosovë për herë të parë
me 5 vjet garanci

N.T.SH. REYHAN
Distributor për KOSOVË

Të gjitha llojet e baterive, rubinetave të CAPA mund
t'i gjeni tek firma N.T.Sh. REYHAN - Prizren.
Si dhe mund të gjeni edhe nëpër lokale të tjera
në KOSOVË

**ELEGANCË, BUKURI, CILËSI
DHE 5 VJET GARANCI
ME ÇMIME TË VOLITSHME**



ISO 9001



5 ★★★★★
Yil Garanti

www.capamusluk.com.tr

www.reyhan-ran.com

Armatürde Dünyaya Uurulan Marka

Rr:UCK, Pn Tel: + 381 29 225 555
Prizren - KOSOVË Mob: + 377 44 115 238

Shitje me shumicë mund të kontaktoni
përmes telefonave dhe web faqes.



Ju ofron:
Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër
+355 67 47 39389

- 1 Staf arsimor cilësor
- 2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta
- 3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive
- 4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar
- 5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)

1
NGA KLASA E 1-RË
DERI NË KLASËN E 5-TË

“Për shkak të veprave
(të këqija) të njerëzve
janë shfaqur në tokë
e në det të zeza
(bela, skamje, katastrofa,
humbje e bereqetit etj.),
e për ta përjetuar
ata një pjesë të asaj
të keqeje që e bënë,
ashtu që të tërhiqen
(nga të këqijat).”

(Rum, 41)